FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 64

Tiranë – E premte, 14 prill 2023

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 24/2023, datë 23.3.2023	Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme.....	7077
Dekret i Presidentit nr. 56, datë 11.4.2023	Për shpallje ligji.....	7093
Ligj nr. 25/2023, datë 23.3.2023	Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për Programin Kombëtar të Modernizimit të Sektorit të Ujësjellës-Kanalizimeve në Shqipëri.....	7093
Dekret i Presidentit nr. 52, datë 6.4.2023	Për shpallje ligji.....	7102
Ligj nr. 26/2023, datë 23.3.2023	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Forcave Shumëkombëshe dhe Vëzhguesve për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Shqipërisë në Forcat Shumëkombëshe dhe Vëzhguesve në Sinai.....	7102
Dekret i Presidentit nr. 53, datë 6.4.2023	Për shpallje ligji.....	7107
Ligj nr. 27/2023, datë 23.3.2023	Për kontrollin e tregtimit të produkteve që mund të përdoren për dënime me vdekje, torturë ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese.....	7107
Dekret i Presidentit nr. 54, datë 11.4.2023	Për shpallje ligji.....	7120
Ligj nr. 28/2023, datë 23.3.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 48/2014, "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare", të ndryshuar.....	7120
Dekret i Presidentit nr. 55, datë 11.4.2023	Për shpallje ligji.....	7121

Udhëzim i përbashkët i ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 1, datë 17.3.2023	Për diagnostikimin dhe mjekimin pranë Qendrës Spitalore Universitare dhe institucioneve spitalore rajonale, si dhe përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe funksionimin e skemës së sigurimeve shëndetësore për personat e burgosur.....	7121
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 196, datë 11.4.2023	Për miratimin e kritereve të vlerësimit të kandidatëve për drejtues të shërbimit në strukturat shëndetësore universitare.....	7123
Udhëzim i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 164, datë 20.3.2023	Për metodologjinë e llogaritjes së kostove të shërbimeve spitalore....	7123
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, datë 13.3.2023	Çështja Sevdari kundër Shqipërisë *(kërkesa nr. 40662/19)*.....	7125
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 10, datë 7.3.2023	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 00-2022-738, datë 26.4.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë; nr. 965, datë 12.5.2015, të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 1125, datë 20.3.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dhënia e pensionit të pleqërisë dhe e pensionit suplementar si ushtarak në përputhje me legjislacionin e kohës.....	7150
Vendim i Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit nr. 3, datë 6.4.2023	Bibliografia e Informacionit të Deklasifikuar në AIDSSH.....	7159

LIGJ
Nr. 24/2023

PËR NXITJEN E PËRDORIMIT TË ENERGJISË NGA BURIMET E RINOVUESHME[1]

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është:

a) të nxitë rritjen e përdorimit të energjisë prej burimeve të rinovueshme për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të këtij sektori në Republikën e Shqipërisë dhe të jetë në përputhje me detyrimet në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë;

b) të zvogëlojë importin e lëndëve djegëse fosile, emetimin e gazeve me efekt serrë dhe të mbrojë mjedisin në përputhje me detyrimet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë në kuadër të marrëveshjeve dhe traktateve ndërkombëtare;

c) të nxitë zhvillimin e energjisë elektrike të rinovueshme dhe integrimin rajonal të saj, si dhe të lehtësojë pjesëmarrjen e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme;

ç) të rritë diversifikimin e burimeve të energjisë dhe sigurinë e furnizimit me energji në Republikën e Shqipërisë;

d) të nxitë zhvillimin e zonave rurale dhe të izoluara duke përmirësuar furnizimin e tyre me energji.

Neni 2
Fusha e veprimit

Ky ligj përcakton:

a) kuadrin ligjor për nxitjen e përdorimit të energjisë së prodhuar nga burimet e rinovueshme;

b) objektivat kombëtarë detyrues dhe detyrimet raportuese për kontributin e energjisë nga burimet e rinovueshme në konsumin përfundimtar bruto të energjisë;

c) rregullat për informacionin, certifikimin dhe statistikat;

ç) rregullat për mekanizmat e bashkëpunimit;

d) rregullat për mbështetjen e prodhimit të energjisë nga burimet e rinovueshme;

dh) rregullat për aksesin dhe funksionimin e rrjeteve për burimet e energjive të rinovueshme dhe lidhjen e tyre me rrjetin e energjisë elektrike në territorin e Republikës së Shqipërisë;

e) rregullat për dhënien, transferimin dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë e prodhuar nga burimet e rinovueshme;

ë) kuadrin ligjor për përdorimin e energjisë nga burimet e rinovueshme të energjisë në sektorët e ngrohjes, ftohjes dhe transportit;

f) rregullat për integrimin e vetëprodhuesve nga energjia e rinovueshme dhe komuniteteve të energjisë në sektorin e energjisë elektrike.

Neni 3
Përkufizimet

Në kuptim të këtij ligji me termat e mëposhtëm nënkuptohet:

1. "Agregator" është një pjesëmarrës tregu që ushtron aktivitete agregimi.

2. "Agregim" është aktiviteti i ushtruar nga një person fizik apo juridik, që kombinon ngarkesa të shumta klientësh ose energji të prodhuar për shitje, blerje ose tregtim në çdo treg energjie.

3. "Biomasa" është pjesa e biodegradueshme e produkteve, mbeturinave dhe mbetjeve me origjinë biologjike nga bujqësia (përfshirë substancat bimore dhe shtazore), pylltaria dhe industritë e ndërlidhura, përfshirë peshkimin dhe akuakulturën, si dhe pjesët e biodegradueshme të mbeturinave, përfshirë mbeturinat industriale dhe urbane me origjinë biologjike.

4. "Biomasa bujqësore" është biomasa e prodhuar nga bujqësia.

[1] *Ky ligj është përafruar pjesërisht me direktivën (BE) 2018/2001 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 11 dhjetor 2018, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", e ndryshuar". Numri CELEX 32018L2001, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 328, datë 21.12.2018, f. 82–209.*

5. "Biomasa pyjore" është biomasa e prodhuar nga pylltaria.

6. "Çmimi i garantuar" është çmimi fitues i arritur në një proces konkurrues me të cilin prodhuesi me përparësi do të shesë energjinë elektrike sipas skemës së mbështetjes ose diferenca e të cilit me çmimin referencë do të mbulohet financiarisht.

7. "Çmimi i referencës" është çmimi i vendosur në lidhje me tregun shqiptar të ditës në avancë që operohet nga Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike sipas përcaktimeve të skemës së mbështetjes. Llogaritja e çmimit të referencës dhe rregullat për trajtimin e çmimeve negative do të përcaktohen në dokumentet për çdo proces konkurrues dhe në kontratat e mbështetjes sipas neneve 12, 13 dhe 14 të këtij ligji. Në rast se çmimi i referencës është negativ, ai do të konsiderohet zero për qëllimin e rregullimit të CfD-së.

8. "Detyrimi për energjinë e rinovueshme" është një tarifë fikse që aplikohet për klientët përfundimtarë për të mbuluar kostot e Operatorit të Energjisë së Rinovueshme në përputhje me sasinë përkatëse të energjisë elektrike të matur dhe të lëvruar nga furnizuesit e tyre përkatës, e llogaritur në përputhje me parimet e përcaktuara në këtë ligj dhe metodologjinë që do të miratojë ERE.

9. "Energjia e ambientit" është energjia termike e natyrshme dhe energjia e akumuluar në mjedis brenda kufijve të caktuar, e cila mund të ruhet në ajrin e ambientit, me përjashtim të ajrit shkarkues, ose në ujërat sipërfaqësore ose në ujërat e zeza.

10. "Energjia nga burimet e rinovueshme" është energjia e prodhuar nga burimet e rinovueshme jofosile, konkretisht era, dielli (diellore termike dhe diellore fotovoltaike), gjeotermale, energjia e ambientit, baticat, valët dhe energji të tjera të oqeanit, hidrocentralet, biomasa, gazi i impiantit të trajtimit të ujërave të zeza, gazi i landfillit dhe biogazi.

11. "ERE" është Enti Rregullator i Energjisë.

12. "Fondi mbështetës i burimeve të rinovueshme" është një fond i krijuar nga detyrimi për energjinë e rinovueshme për të mbuluar koston e skemave mbështetëse të përcaktuara me këtë ligj.

13. "Garancia e origjinës" është një dokument elektronik, i cili ka funksion të vetëm që t'i provojë konsumatorit përfundimtar se një pjesë ose e gjithë sasia e dhënë e energjisë është prodhuar prej burimeve të rinovueshme.

14. "Kapaciteti i funksionimit të domosdoshëm" është sasia e prodhimit të gjeneratorëve që, për arsyet që lidhen me funksionimin e sigurt të sistemit, duhet të lidhen me rrjetin e transmetimit/shpërndarjes.

15. "Komuniteti i Energjisë së Rinovueshme" është një entitet juridik:

a) që bazohet në pjesëmarrjen e hapur dhe vullnetare, është i pavarur dhe kontrollohet efektivisht nga aksionarët ose anëtarët që ndodhen në afërsi të projekteve të energjisë së rinovueshme, të cilat janë në pronësi dhe janë zhvilluar nga ai entitet juridik;

b) në të cilin aksionarët ose anëtarët janë persona, NVM, autoritete lokale, duke përfshirë bashkitë;

c) qëllimi kryesor i të cilit është të sigurojë përfitime mjedisore, ekonomike ose sociale për aksionarët, anëtarët e tij ose për zonat lokale ku operon, në vend të fitimeve financiare;

16. "Konsumi përfundimtar bruto i energjisë" është e gjithë sasia e energjisë, e lëvruar në territorin e Republikës së Shqipërisë për qëllime industriale, të transportit, për sektorin familjar, për shërbime të ndryshme, përshirë shërbimet publike e private, bujqësinë, pyjet e peshkimin, përfshirë konsumin e energjisë elektrike dhe të nxehtësisë për ngrohje dhe prodhim të karburantit për transport, konsumin e energjisë elektrike dhe nxehtësisë për prodhimin e energjisë elektrike, si dhe humbjet e energjisë elektrike e të ngrohjes në sistemin e transmetimit e të shpërndarjes.

17. "Kontratë për diferencën" (CfD) është një kontratë për mbështetje e rregulluar financiarisht ku Operatori i Energjisë së Rinovueshme i paguan prodhuesit me përparësi diferencën midis çmimit të garantuar dhe çmimit të referencës kur çmimi i referencës është më i ulët se çmimi i garantuar dhe prodhuesi me përparësi i paguan diferencën Operatorit të Energjisë së Rinovueshme kur çmimi i referencës është më i lartë se çmimi i garantuar.

18. "Kontratë për mbështetje" është kontratë përmes së cilës prodhuesit me përparësi i jepet mbështetje sipas këtij ligji.

19. "Kontratë për prim" është një lloj kontrate për mbështetje ku paguhet një prim fiks (që mund të jetë pozitiv ose negativ në varësi të rezultatit të procesit konkurrues) ose një prim rrëshqitës (si diferencë midis çmimit të garantuar dhe çmimit të referencës) nga Operatori i Energjisë së

Rinovueshme për prodhuesit me përparësi mbi çmimin e tregut.

20. "Konvertimi CfD" është konvertimi i një MBE në një CfD në përputhje me nenin 30 të këtij ligji;

21. "Lëndët djegëse nga biomasa" janë karburantet e gazta, të lëngëta dhe të ngurta të prodhuara nga biomasa.

22. "Marrëveshja e blerjes së energjisë (MBE)" është një lloj marrëveshje për mbështetje, ku një blerës i caktuar garanton blerjen fizike të detyrueshme të energjisë elektrike të gjeneruar nga prodhuesit për një çmim fiks.

23. "Marrëveshje për blerje energjie të rinovueshme" është një kontratë me anë të së cilës një person fizik apo juridik bie dakord për blerje energjie të rinovueshme nga një prodhues energjie.

24. "Marrëveshje ekzistuese për blerje energjie " është një marrëveshje për blerjen e energjisë elektrike e lidhur me një prodhues ekzistues me përparësi.

25. "Mbetje" janë substanca që nuk janë produkti përfundimtar që një proces prodhimi kërkon të prodhojë drejtpërdrejt; nuk është qëllimi kryesor i procesit të prodhimit dhe procesi nuk është modifikuar qëllimisht për ta prodhuar atë.

26. "Ministër" është ministri përgjegjës për energjinë.

27. "Ministria" është ministria përgjegjëse për energjinë.

28. "Ndarja e energjisë" është transferimi brenda një komuniteti të energjisë së rinovueshme i energjisë së rinovueshme që prodhohet nga njësitë prodhuese në pronësi të atij komuniteti të energjisë së rinovueshme.

29. "Ndërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme" janë ndërmarrjet mikro, të vogla ose të mesme sipas përkufizimit të ligjit në fuqi për zhvillimin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme.

30. "Njësi gjenerimi" është çdo objekt, i cili transformon energjinë e prodhuar nga burimet e rinovueshme në energji elektrike ose për ngrohje.

31. "Operator i Energjisë së Rinovueshme (OER)" është subjekti i përcaktuar në nenin 16 të këtij ligji.

32. "Përzierje e energjisë së mbetur" është përzierja e energjisë totale vjetore duke përjashtuar pjesën e mbuluar nga garancitë e anuluara të origjinës.

33. "PKEK" është Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës sipas pikës 4 të nenit 14 të ligjit nr. 155/2020, "Për ndryshimet klimatike".

34. "Proces konkurrues" është një procedurë e hapur, transparente, jodiskriminuese dhe konkurruese, që mundëson pjesëmarrjen e një numri të mjaftueshëm ofertuesish për të përcaktuar nivelin e mbështetjes dhe përfituesve.

35. "Prodhues demonstrues" është një prodhues që prodhon energji nga një burim inovativ apo për qëllime studimore.

36. "Prodhues me përparësi" është çdo prodhues i energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë që përfiton nga një skemë mbështetëse sipas dispozitave të këtij ligji.

37. "Prodhues ekzistues me përparësi" është një prodhues me përparësi që në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji ka nënshkruar një kontratë për zhvillim projekti me ministrinë ose është pajisur me miratim paraprak për ndërtimin e kapacitetit prodhues fotovoltaik deri në 2 mw, eolik deri në 3 mw dhe për hidrocentrale me kapacitet të instaluar deri 15 mw.

38. "Projekt demonstrues" është një projekt që demonstron një teknologji si të parën e këtij lloji në Bashkimin Evropian ose Komunitetin e Energjisë dhe që përfaqëson një inovacion të rëndësishëm që është përtej teknologjisë moderne.

39. "Rrjetet inteligjente" janë rrjetet e energjisë që mund të monitorojnë automatikisht flukset e energjisë dhe të përshtaten me ndryshimet në furnizimin dhe kërkesën për energji në përputhje me rrethanat.

40. "Sisteme diellore fotovoltaike" është një sistem i përbërë nga njësi gjeneruese fotovoltaike që përdoret për të transformuar energjinë diellore në energji elektrike, e cila transformohet brenda këtij impianti për t'u futur në rrjetet e energjisë elektrike.

41. "Skemë mbështetëse" është çdo instrument, skemë ose mekanizëm i aplikuar, që nxit përdorimin e energjisë nga burimet e rinovueshme duke ulur koston e asaj energjie, duke rritur çmimin me të cilin mund të shitet ose duke rritur volumin e kësaj energjie të blerë, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në ndihmë për investime, përjashtime ose reduktime tatimore, rimbursime tatimore ose skema të mbështetjes direkte të çmimeve.

42. "Tarifa nxitëse" është çmimi fiks që i paguhet për energjinë elektrike një prodhuesi me përparësi.

43. "Teknologji neutrale" është çdo teknologji për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë.

44. "Tregtia mes pjesëmarrësve" e energjisë së rinovueshme është shitja dhe blerja e energjisë së rinovueshme midis pjesëmarrësve të tregut me anë të një kontrate me kushte të paracaktuara që rregullojnë ekzekutimin dhe shlyerjen e automatizuar të transaksionit, qoftë drejtpërdrejt ndërmjet pjesëmarrësve të tregut ose në mënyrë indirekte nëpërmjet një pale të tretë të certifikuar që është pjesëmarrëse në treg. E drejta për të kryer tregtim "mes pjesëmarrësve" nuk duhet të cenojë të drejtat dhe detyrimet e palëve të përfshira si konsumator përfundimtar, prodhues, furnizues ose agregator.

45. "Vend i tretë' është çdo vend që nuk është shtet anëtar i Bashkimit Evropian dhe as palë kontraktuese e Komunitetit të Energjisë.

46. "Vetëprodhuesi i burimeve të rinovueshme" është një konsumator përfundimtar që prodhon energji elektrike të rinovueshme për konsumin e vet dhe që mund të depozitojë ose të shesë energji elektrike të rinovueshme të vetëprodhuar, me kusht që për vetëprodhuesin e burimeve të rinovueshme këto aktivitete nuk përbëjnë veprimtarinë kryesore komerciale ose profesionale.

47. "Vetëprodhuesit e burimeve të rinovueshme me veprim të përbashkët" është një grup prej të paktën dy vetëprodhuesish të burimeve të rinovueshme që veprojnë së bashku, të cilët ndodhen në të njëjtën ndërtesë ose bllok me shumë apartamente.

48. "Faturimi neto" është fatura mujore që Operatori i Sistemit të Shpërndarjes i jep vetëprodhuesit për diferencën ndërmjet faturës për sasinë e energjisë elektrike të konsumuar, sasinë e energjisë elektrike të vetëprodhuar dhe të vetëkonsumuar, kundrejt faturës për sasinë e energjisë elektrike të hedhur në një rrjet për periudhën e faturimit.

Neni 4
Terma përkufizimesh në ligje të tjera

Çdo term tjetër i përdorur në këtë ligj ka të njëjtin kuptim me përkufizimet e përcaktuara në ligjin nr. 43, datë 30.4.2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar dhe në ligjin nr. 124, datë 12.11.2015, "Për eficiencën e energjisë", të ndryshuar.

Neni 5
Agjencia përgjegjëse për energjinë e rinovueshme

1. Agjencia përgjegjëse për energjinë e rinovueshme është institucion në varësi të ministrit, që ka këto detyra dhe përgjegjësi kryesore:

a) krijimin, regjistrimin, përditësimin dhe publikimin e regjistrit të prodhuesve me përparësi;

b) regjistrimin e energjisë elektrike të prodhuar në baza mujore nga secili prodhues me përparësi;

c) monitorimin e kontratave koncesionare dhe jo objekt koncesioni për ndërtimin e burimeve të reja prodhuese të energjisë elektrike, përmbushjen e detyrimeve kontraktuale, përllogaritjen dhe aplikimin e penaliteteve të shoqërisë për mospërmbushje detyrimesh, testimin e impianteve prodhuese dhe lëshimin e certifikatës së përfundimit të impiantit sipas kontratës së nënshkruar, vlerësimin dhe certifikimin e investimit të kryer.

ç) dhënien e kontributit në hartimin dhe rishikimet periodike, në bashkëpunim me ministrinë, të PKEK-së brenda afateve të përcaktuara me ligj;

d) monitorimin e zbatimit të PKEK-së;

dh) krijimin dhe paraqitjen pranë ministrisë dhe ERE-s deri më 1 qershor të çdo viti të një vlerësimi të pjesës së energjisë së prodhuar nga burimet e rinovueshme në krahasim me konsumin final bruto të energjisë për vitin paraardhës;

e) zhvillimin e të gjitha dokumenteve të kërkuara dhe dorëzimin e tyre për miratim në ministrinë përgjegjëse për energjinë, siç parashihet në nenet 6 dhe 8 të këtij ligji.

2. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, cakton institucionin, i cili do të ushtrojë detyrat e agjencisë përgjegjëse për energjinë e rinovueshme.

KREU II
OBJEKTIVAT KOMBËTARË PËR PËRDORIM TË ENERGJISË NGA BURIMET E RINOVUESHME DHE RAPORTIMET

Neni 6
Objektivat kombëtarë

1. Objektivat kombëtarë për pjesën e energjisë nga burimet e rinovueshme në konsumin final bruto të energjisë përcaktohen në Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës, i cili miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit. Pjesa e energjisë nga burimet e rinovueshme në konsumin final bruto të energjisë në vitin 2030 do të jetë 54.4%.

2. Pjesa e energjisë nga burimet e rinovueshme llogaritet si konsumi përfundimtar bruto i energjisë nga burimet e rinovueshme, përpjesëtuar me konsumin përfundimtar bruto të energjisë nga të gjitha burimet e energjisë në përputhje me metodologjinë e miratuar nga Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit.

3. Republika e Shqipërisë ka të drejtë të zbatojë masa bashkëpunimi me palë të tjera kontraktuese të komunitetit të energjisë ose shtete anëtare të BE-së, me qëllim arritjen e objektivave të Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës.

Neni 7
Raportimi i integruar për Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës

1. Ministria raporton në Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë për statusin e zbatimit të Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës me anë të raportit kombëtar të integruar të energjisë dhe klimës.

2. Raporti kombëtar i integruar i energjisë dhe klimës përfshin elemente si më poshtë:

a) informacion për progresin drejt arritjes së objektivave, përfshirë progresin drejt objektivit të Komunitetit të Energjisë për neutralitetin klimatik, objektivat dhe kontributet e përcaktuara në këtë ligj dhe Planin Kombëtar të Energjisë dhe Klimës dhe drejt financimit e zbatimit të politikave dhe masave të nevojshme për të përmbushur ato, duke përfshirë një rishikim të investimit aktual kundrejt supozimeve të investimit fillestar;

b) informacion për politikat dhe masat e miratuara ose që synohen të miratohen dhe të zbatohen për të adresuar rekomandimet e nxjerra nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë në drejtim të përmbushjes së objektivave, caqeve dhe kontributeve të Shqipërisë, pikave të referencës së saj për energjinë e rinovueshme ose në zbatimin e politikave dhe masave të përcaktuara në PKEK;

c) informacion për zbatimin e trajektoreve dhe objektivave të mëposhtëm:

i. trajektorja treguese kombëtare për pjesën e përgjithshme të energjisë së rinovueshme në konsumin përfundimtar bruto të energjisë nga viti 2025 deri në vitin 2030;

ii. trajektoret e vlerësuara të përcaktuara në PKEK për pjesën sektoriale të energjisë së rinovueshme në konsumin përfundimtar të energjisë nga viti 2025 deri në vitin 2030 në sektorin e energjisë elektrike, ngrohjes dhe ftohjes dhe transportit;

iii. trajektoret e vlerësuara për teknologji të energjisë së rinovueshme për të arritur trajektoret e përgjithshme dhe sektoriale për energjinë e rinovueshme nga viti 2025 deri në vitin 2030, duke përfshirë konsumin final bruto të pritshëm të energjisë për teknologji dhe sektor në MTOE dhe kapacitetin total të instaluar, të planifikuar për teknologji dhe sektor në mw.

iv. trajektoret për kërkesën për bioenergji, të ndara ndërmjet ngrohjes, energjisë elektrike dhe transportit dhe për furnizimin me biomasë sipas lëndës së parë dhe origjinës (duke bërë dallimin midis prodhimit vendas dhe importeve). Për biomasën pyjore, një vlerësim i burimit dhe ndikimit të saj në uljen e LULUCF;

ç) nëse përcaktohen në PKEK ose në ligjin në fuqi trajektoret dhe objektivat e tjerë kombëtarë, duke përfshirë ata që janë afatgjatë dhe sektorialë (si p.sh. pjesa e energjisë elektrike e prodhuar nga biomasa pa përdorimin e nxehtësisë, pjesa e energjisë së rinovueshme në ngrohjen qendrore, përdorimi i energjisë së rinovueshme në ndërtesa, energjia e rinovueshme e prodhuar nga qytetet, komunitetet e energjisë së rinovueshme dhe vetë konsumatorët e burimeve të rinovueshme), energjia e rikuperuar nga llumi i marrë nga trajtimi i ujërave të zeza;

d) për zbatimin e politikave dhe masave të mëposhtme:

i. politikat dhe masat e zbatuara, të miratuara dhe të planifikuara për arritjen e objektivit kombëtar për energjinë e rinovueshme, duke përfshirë masat specifike për sektorin dhe teknologjinë me një rishikim specifik të zbatimit të masave të përcaktuara në kreun V të këtij ligji;

ii. kur mund të jetë e zbatueshme, masat specifike për bashkëpunimin rajonal ndërmjet dy ose më shumë palëve kontraktuese të komunitetit të energjisë dhe/ose shteteve anëtare të BE-së të angazhuara në një partneritet që mbulon një ose më shumë nga pesë dimensionet e Komunitetit të Energjisë;

iii. masat specifike për mbështetjen financiare për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme në energji elektrike, ngrohje dhe ftohje dhe transport, pa cenuar ndalimin e marrëveshjeve antikonkurruese;

iv. kur mund të jetë e zbatueshme, vlerësimin e mbështetjes për energjinë elektrike nga burimet e rinovueshme që Republika e Shqipërisë do të kryejë në zbatim të nenit 31, pika 2, të këtij ligji;

v. masat specifike lidhur me procedurat administrative, dhënien e lejeve dhe njoftimin për lidhje në rrjet dhe trajnim;

vi. kur mund të jetë e zbatueshme, masa specifike për të vlerësuar, bërë transparente dhe reduktuar nevojën për kapacitet të detyrueshëm që mund të çojë në reduktimin e energjisë nga burimet e rinovueshme;

vii. informacion të politikave dhe masave të vendosura për të nxitur dhe lehtësuar zhvillimin e komuniteteve të vetëprodhimit të burimeve të rinovueshme dhe të energjisë së rinovueshme;

viii. masat për promovimin e përdorimit të energjisë nga biomasa, veçanërisht për mobilizimin e ri të biomasës, duke përfshirë disponueshmërinë e qëndrueshme të biomasës, si dhe masat për qëndrueshmërinë e biomasës së prodhuar dhe të përdorur;

ix. masat e vendosura për të rritur pjesën e energjisë së rinovueshme në sektorin e ngrohjes, ftohjes dhe transportit;

x. politikat dhe masat që lehtësojnë konkludimin e kontratave për mbështetje të përcaktuara me këtë ligj;

dh) informatat shtesë, siç përcaktohen në nenin 25 të këtij ligji.

Neni 8

Mospërmbushja e treguesve kombëtarë

1. Ministria merr masa shtesë në rastet kur pika e referencës e trajektores treguese të Republikës së Shqipërisë në vitin 2027 nuk është përmbushur.

2. Disa nga masat shtesë që merren për të arritur pikën e referencës së trajektores treguese kombëtare janë si më poshtë:

a) rritja e sasisë së energjisë së rinovueshme në vend;

b) rishikimi i energjisë së rinovueshme në sektorin e ngrohjes dhe ftohjes, të përcaktuar në kreun V të këtij ligji;

c) rishikimi i energjisë së rinovueshme në sektorin e transportit të përcaktuar në kreun V të këtij ligji;

ç) aplikimi i një pagese financiare vullnetare për mekanizmin e financimit të Komuniteteve të Energjisë së Rinovueshme, duke kontribuar në projektet e energjisë së rinovueshme;

d) duke përdorur mekanizmat e bashkëpunimit të përcaktuar në nenin 6, pika 3, të këtij ligji;

dh) çdo masë tjetër që rekomandohet nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë.

Neni 9

Informatat, certifikimi dhe statistikat

1. Ministria vendos në dispozicion informatat për përfitimet dhe kostot e zhvillimit dhe përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme, si dhe për masat mbështetëse për të gjitha palët e interesuara.

2. Në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për energjinë publikohet informacion i përditësuar mbi përfitimet neto, koston dhe eficiencën energjetike të pajisjeve dhe sistemeve për shfrytëzimin e ngrohjes, ftohjes dhe energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme.

3. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit, miraton kritere për skemat e kualifikimit ekuivalente për instaluesit e kaldajave dhe stufave të biomasës me shkallë të vogël, sistemeve diellore fotovoltaike dhe termike diellore, sistemeve të cekëta gjeotermale dhe pompave të nxehtësisë. Certifikatat e dhëna nga palët e tjera të komunitetit të energjisë në përputhje me këto kritere do të njihen si ekuivalente me certifikatat e lëshuara nga ministria.

4. Ministria zhvillon programe të përshtatshme informacioni, ndërgjegjësimi, udhëzimi ose trajnimi për të informuar qytetarët në ushtrimin e të drejtave të tyre si konsumatorë aktivë, si dhe për përfitimet dhe praktikat më të mira, duke përfshirë aspektet teknike dhe financiare të zhvillimit dhe përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme, duke përfshirë vetëprodhimin nga burimet e rinovueshme ose në kuadrin e komuniteteve të energjisë së rinovueshme.

5. Të gjitha subjektet që prodhojnë energji nga burimet e rinovueshme janë të detyruara të dorëzojnë pranë agjencisë përgjegjëse për energjinë e rinovueshme të dhëna mbi prodhimin vjetor të energjisë, të dhëna mbi pagesën e detyrimeve financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara nga agjencia jo më vonë se data 31 mars e çdo viti. Agjencia bashkëpunon edhe me operatorët e rrjetit për zbatimin e këtij detyrimi.

KREU III
NXITJA E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA BURIMET E RINOVUESHME TË ENERGJISË

Neni 10
Masat mbështetëse për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme

1. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit, miraton masat mbështetëse, rregullat dhe procedurat për përfitimin e këtyre masave, për të nxitur arritjen e objektivit kombëtar për burimet e rinovueshme të energjisë. Në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave, ministri me udhëzim përcakton rregulla të detajuara për zbatimin e dhënies së masave mbështetëse për burimet e energjisë së rinovueshme.

2. Çdo masë mbështetëse që përbën ndihmë shtetërore i nënshtrohet miratimit nga komisioni i ndihmës shtetërore në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën shtetërore.

3. Mbështetja për prodhuesit me përparësi jepet përmes procesit konkurrues në përputhje me nenin 13, të këtij ligji, përveç mbështetjes për projektet demonstruese sipas nenit 15 të këtij ligji.

4. Për prodhues ekzistues me përparësi, çmimi i blerjes së energjisë elektrike nga burimet hidrike me kapacitet të instaluar deri në 15 mw caktohet nga ERE-ja në përputhje me metodologjinë e miratuar nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit. Metodologjia përcakton kriteret e llogaritjes së çmimit, duke u bazuar në çmimin e tregut të organizuar të energjisë elektrike ose deri në krijimin e tij, në çmime të krahasueshme të tregjeve të organizuara të vendeve fqinje, plus një bonus të caktuar për promovimin e këtyre burimeve, i cili merr në konsideratë një kthim të arsyeshëm të vlerës së investimeve. Në çdo rast, ky çmim nuk do të jetë më i ulët se çmimi i miratuar nga ERE-ja në vitin 2016.

5. Për prodhues ekzistues me përparësi, çmimi i blerjes së energjisë elektrike nga burimet fotovoltaike dhe eolike caktohet nga ERE-ja në përputhje me metodologjinë e miratuar nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit. Metodologjia përcakton kriteret e llogaritjes së çmimit, duke u bazuar në kthimin e arsyeshëm të vlerës së investimeve sipas llojit të teknologjisë së përdorur.

Neni 11
Përgjegjësia e balancimit dhe fleksibiliteti

1. Prodhuesit me përparësi, përfshirë edhe prodhuesit ekzistues me përparësi, janë financiarisht përgjegjës për disbalancat e tyre. Në përputhje me rregullat e tregut të balancimit dhe procedurat e tjera të miratuara nga ERE-ja, ata bëhen palë përgjegjëse për balancim ose e transferojnë këtë përgjegjësi te një grup tjetër balancimi. Kushtet për marrëveshjen e shërbimeve të balancimit përcaktohen lirisht midis palës përgjegjëse të grupit të balancimit dhe pjesëmarrësit të grupit të balancimit.

2. Energjia elektrike e prodhuar nga prodhuesit me përparësi, e cila nuk është hedhur në rrjet, por është ruajtur në objektet e tyre të depozitimit, konsiderohet e dorëzuar dhe i nënshtrohet mbështetjes në kohën e injektimit të planifikuar në rrjet.

3. Prodhuesit me përparësi kanë të drejtë të përdorin objektet e tyre ose objekte të tjera të depozitimit duke mbuluar të gjitha kostot për të zbutur efektin e disbalancës dhe, në rast se skemat e tyre mbështetëse e lejojnë, të përfitojnë nga diferencat për orë përmes zhvendosjes së injektimit në rrjet.

4. Operatori i Energjisë së Rinovueshme ka të drejtë të përdorë objektet e depozitimit duke

mbuluar të gjitha kostot, me qëllim optimizimin e kostove të përgjithshme të disbalancave dhe për të përfituar nga diferencat për orë përmes zhvendosjes së dërgesave.

5. Prodhuesit me përparësi mund të ofrojnë shërbime balancimi nëse plotësojnë kriteret teknike të përcaktuara nga operatori i sistemit të transmetimit. Energjia elektrike e depozituar, e prodhuar ose e kufizuar nën pjesëmarrjen vullnetare në mekanizmin balancues nuk do t'i nënshtrohet skemës së mbështetjes.

6. Operatori i Sistemit të Transmetimit i siguron Operatorit të Energjisë së Rinovueshme informacionin përkatës të kërkuar për të kompensuar pagesën e skemës mbështetëse në përputhje me pikën 5 të këtij neni.

Neni 12
Skemat mbështetëse

1. Mbështetja për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme mund të jetë në një nga format e mëposhtme:

a) marrëveshje për blerje të energjisë;

b) kontratë për diferencën;

c) kontratë për prim.

2. Përpara krijimit të një tregu likuid të energjisë elektrike të ditës në avancë në përputhje me nenin 30 të këtij ligji, mbështetja mund të jepet në formën e një marrëveshjeje për blerjen e energjisë, e cila duhet t'i nënshtrohet një konvertimi në një kontratë për diferencë pas krijimit të tregut likuid të energjisë elektrike të ditës në avancë, në përputhje me nenin 30, pikat 4, 5 dhe 6, të këtij ligji.

3. Forma e skemës mbështetëse përcaktohet përpara nisjes së çdo procesi konkurrues nga ministria.

Neni 13
Procesi konkurrues

1. Ministria mund të vendosë që procesi konkurrues të jetë neutral ndaj teknologjisë ose i kufizuar në një teknologji specifike.

2. Ministria në përcaktimin e procesit konkurrues të kufizuar në teknologji specifike merr për bazë kritere të caktuara dhe në veçanti:

a) potencialin afatgjatë të një teknologjie;

b) nevojën për të arritur diversifikimin e burimeve;

c) kufizimet e rrjetit dhe qëndrueshmërinë e rrjetit;

ç) kostot e lidhjes në rrjet;

d) nevojën për të shmangur deformimet në tregun e materialeve të para nga mbështetja e biomasës;

dh) nëse një proces i hapur ndaj të gjitha teknologjive do të çonte në rezultate jo të përshtatshme.

3. Procesi konkurrues iniciohet dhe zbatohet në bazë të njoftimit publik.

4. Njoftimi publik dhe dokumentet e procesit konkurrues duhet të përmbajnë të paktën informatat e mëposhtme:

a) nëse procesi konkurrues do të jetë neutral ndaj teknologjisë ose i kufizuar në një teknologji specifike;

b) nëse procedura do të realizohet me një fazë apo dy faza dhe kush ka të drejtë të dorëzojë një kërkese për të marrë pjesë në secilën fazë;

c) kapacitetin e ofruar në procesin konkurrues;

ç) nëse është e aplikueshme, tarifën maksimale për çmimin e garantuar (tavani i çmimit);

d) mënyrën dhe formën e kërkesës për pjesëmarrje në procesin konkurrues;

dh) dokumentacionin që duhet dorëzuar së bashku me kërkesën për pjesëmarrje në procesin konkurrues;

e) kushtet për kualifikim dhe konkurrim;

ë) kushtet për përzgjedhjen e zonës së ndërtimit, si dhe nëse dhënia e tokës është pjesë e mbështetjes për realizimin e projektit;

f) kushtet për vlerësimin e ofertave;

g) afatet për pjesëmarrje në procesin konkurrues;

gj) afatet për zbatimin e projektit;

h) mbështetjen që jepet në këtë proces konkurrues;

i) kushtet për pjesëmarrje në një grup balancimi ose shërbimet për dhënien e aksesit në treg nga një palë e tretë, të cilat mund t´i vihen në dispozicion prodhuesit me përparësi me të drejtë zgjedhjeje;

j) miratimin nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën shtetërore;

k) elemente tjera të vlerësuara nga ministria.

5. Rregullat e detajuara për organizimin e procedurës konkurruese përcaktohen nga ministri.

Neni 14
Kontrata për mbështetje

1. Kontratat për mbështetje përfshijnë:

a) kushtet e përgjithshme, të cilat përbëhen nga kushte dhe terma kontraktualë të standardizuar, që janë të ngjashëm me të gjitha projektet e krahasueshme.

b) kushtet individuale, të cilat përbëhen nga kushte specifike të zbatueshme për projekte individuale dhe/ose zgjedhje midis opsioneve të disponueshme sipas kushteve të përgjithshme.

2. Kushtet e përgjithshme të kontratës tip për mbështetje miratohen nga Enti Rregullator i Energjisë.

3. Në një proces konkurrues, ministri mund të publikojë paraprakisht si pjesë të dokumenteve të procedurës konkurruese kushtet e përgjithshme dhe individuale të kontratës përkatëse për mbështetje.

4. Kontratat për mbështetje përgjithësisht kanë një kohëzgjatje prej 15 vjetësh.

Neni 15
Masat mbështetëse për projektet demonstruese

1. Mbështetja për projektet demonstruese ofrohet përmes vendimit të Këshillit të Ministrave, i cili përcakton përkufizimin e projekteve demonstruese dhe mbështetjen që ofrohet për këto projekte.

2. Projektet demonstruese me kapacitet më të vogël se 10.8 kw u nënshtrohen procedurave të lehtësuara të lidhjes me rrjetin përmes njoftimit për lidhje me rrjetin, drejtuar Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

3. Lidhja me rrjetin përmes njoftimit për lidhje mundësohet për projekte demonstruese me kapacitet mbi 10.8 kw deri në 50 kw vetëm në rastet kur ruhet stabiliteti, besueshmëria dhe siguria në rrjetin e shpërndarjes.

Neni 16
Operatori i Energjisë së Rinovueshme

1. Operatori i Energjisë së Rinovueshme (OER) është pala kontraktuese e prodhuesve me përparësi të kualifikuar për mbështetje në përputhje me këtë ligj nëpërmjet kontratës për mbështetje, ose i mbështetur përmes sistemit të tarifave nxitëse përmes marrëveshjeve për blerjen e energjisë.

2. Operatori i Energjisë së Rinovueshme do të themelohet dhe do të regjistrohet nga ministria brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji si shoqëri tregtare e pavarur nga çdo shoqëri ekzistuese e sektorit të energjisë. Operatori i Energjisë së Rinovueshme krijohet në formën e shoqërisë aksionare dhe kapitali i saj do të zotërohet 100% nga ministria.

3. OER-ja do të jetë blerësi i energjisë elektrike i të gjithë prodhuesve me përparësi, që janë me mbështetje në formën e një MBE-je dhe do ta shpërndajë këtë energji direkt në tregun e organizuar.

4. OER-ja do të ketë përgjegjësi kontraktore ndaj çdo prodhuesi me përparësi për mbulimin e pagesave që rezultojnë nga çdo kontratë për mbështetje sipas këtij ligji.

5. OER-ja mban një regjistër publik *online* të prodhuesve me përparësi të kualifikuar për mbështetje, duke shfaqur për secilin prodhues të tillë një skedar që përmban:

a) emrin dhe vendndodhjen e prodhuesve të tillë;

b) datën e pranimit në kontratë për mbështetje, formën dhe nivelin e mbështetjes;

c) mbështetjen e ofruar që nga data e pranimit në skemën e mbështetjes;

ç) datën e përfundimit të periudhës së mbështetjes;

d) mbështetjen në lidhje me përgjegjësinë balancuese për prodhuesit me përparësi që janë të përjashtuar nga përgjegjësia balancuese.

6. OER-ja menaxhon fondin e mbështetjes së burimeve të rinovueshme, i cili përdoret kryesisht për të mbuluar kostot e skemave mbështetëse si më poshtë:

a) diferencat e pagueshme ndërmjet çmimit të garantuar dhe çmimit të referencës për prodhuesit me përparësi, mbështetjen e dhënë në formën e një CfD-je dhe pagesave të primit për prodhuesit me përparësi, mbështetjen e dhënë në formën e kontratave për prim;

b) tarifat nxitëse për prodhuesit me përparësi, mbështetjen e dhënë në formën e MBE-ve;

c) kostot e përditshme operative dhe të mirëmbajtjes së OER-së, duke përfshirë, por pa u kufizuar në koston e financimit, aksesin në treg, kapitalin qarkullues dhe koston e sigurimit të

rezervave për të siguruar likuiditetin financiar dhe aftësinë e pagesave të fondit të mbështetjes së rinovueshme në baza të vazhdueshme.

7. Detyrat dhe përgjegjësitë e Operatorit të Energjisë së Rinovueshme, duke përfshirë procesin e llogaritjes dhe përditësimit sistematik të fondit të mbështetjes së burimeve të rinovueshme, do të përcaktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave, të propozuar nga ministria.

8. Kostot e Operatorit të Energjisë së Rinovueshme do të mbulohen nëpërmjet detyrimit të energjisë së rinovueshme, i cili do të llogaritet sipas një metodologjie të hartuar dhe miratuar nga ERE-ja.

9. ERE-ja brenda 12 muajve nga miratimi i këtij ligji përcakton detyrimin për energjinë e rinovueshme për t'u paguar nga konsumatorët fundorë të energjisë elektrike në baza vjetore ose sipas periudhave të përcaktuara nga ERE-ja dhe të llogaritur për kwh të konsumuar. Kushtet dhe procedurat për llogaritjen dhe mbledhjen e detyrimit për energjinë e rinovueshme do të miratohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën shtetërore.

10. Në interes të mbështetjes dhe garantimit të qëndrueshmërisë financiare të fondit për mbështetje të burimeve të rinovueshme, OER-ja ka të drejtën të rikuperojë çdo pagesë të paarkëtuar nga një furnizues i falimentuar, duke i ndarë këto të arkëtueshme të pambledhura me furnizuesit e mbetur në treg, në proporcion me pjesën e tregut që zë secili furnizues.

11. OER-ja mund të ndërmarrë çdo aktivitet tjetër që konsiderohet i nevojshëm ose i dobishëm për përmbushjen e përgjegjësive të veta, duke respektuar kufizimet ligjore që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi. OER-ja mund të nënkontraktojë palë të treta për këto aktivitete në rast se është me kosto efektive.

12. ERE-ja mund të vendosë për çdo furnizues detyrimin për të bërë parapagime të pjesës së tij të detyrimit për energjinë e rinovueshme në baza mujore, tremujore ose vjetore, siç përcaktohet në metodologjinë e saj për detyrimet e energjisë së rinovueshme. ERE-ja mund t'u kërkojë furnizuesve të sigurojnë instrumente likuiditeti afatshkurtra për të siguruar fondet e nevojshme për kryerjen e këtyre parapagimeve. Kostot e arsyeshme të bëra për sigurimin e këtyre instrumenteve afatshkurtra të likuiditetit duhet të mbulohen nëpërmjet detyrimit të energjisë së rinovueshme në përputhje me metodologjinë e përcaktuar nga ERE-ja.

13. Operatori i Energjisë së Rinovueshme mban të dhëna të hollësishme për të gjitha masat që përfshijnë dhënien e mbështetjes. Këto të dhëna duhet të mbahen gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës për mbështetje dhe për një periudhë shtesë prej dhjetë vjetësh, duke përfshirë të gjitha informacionet e nevojshme për të provuar se kushtet e kontratës për diferencë, kontratës për prim dhe MBE janë përmbushur.

14. Operatori i Energjisë së Rinovueshme publikon çdo vit detajet e llogaritjeve të pagesave, sipas kontratës për mbështetje, brenda datës 31 maj.

Neni 17
Aksesi në rrjete

1. Operatorit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme i garantohet akses në rrjetet e transmetimit dhe shpërndarjes sipas parimit të transparencës dhe jodiskriminimit, bazuar në kriteret dhe në bazë të tarifave të miratuara dhe të publikuara nga ERE-ja.

2. Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, në përputhje me aksesin me përparësi në rrjet sipas parashikimeve të ligjit për sektorin e energjisë elektrike, kur janë të nevojshme reduktimet e energjisë elektrike, duhet të kufizojnë fillimisht energjinë elektrike që vjen nga burime të tjera dhe më pas energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme, për sa kohë që kjo nuk rrezikon funksionimin e sigurt të sistemit elektroenergjetik. Kufizimet dhe reduktimet e energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit e burimeve të rinovueshme duhet të jenë transparente dhe të justifikueshme.

3. Në rast se Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes kanë shteruar burimet e tjera reduktuese, energjia elektrike e prodhuar nga burimet e rinovueshme mund të kufizohet dhe, sipas rastit, kompensohet. Vëllimi i reduktuar dhe kompensimi përkatës do të vlerësohen në bazë të një metodologjie të miratuar nga ERE-ja.

4. Metodologjia do të marrë parasysh kostot e pjesëmarrjes në mekanizmin balancues, formimin e çmimeve të disbalancës, fitimet nga shitja e

energjisë elektrike në tregun e organizuar të energjisë, që prodhuesi i burimeve të rinovueshme do të kishte përfituar pa ndërprerjen e pavullnetshme dhe mbështetja që do t'i jepej një impianti nga burimet e rinovueshme në rast se përfiton nga një masë mbështetëse në kuptim të këtij ligji.

5. ERE-ja miraton masat e operimit të rrjetit dhe tregut, me propozim të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, për të minimizuar ndërprerjet e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme të energjisë dhe metodologjinë për vlerësimin e vëllimit të kufizuar të energjisë elektrike. Metodologjia e ERE-s do të marrë parasysh vëllimin e energjisë së kufizuar nga injektimi në rrjet, por të ruajtur në objektin e depozitimit të prodhuesve me përparësi.

Neni 18
Lidhja në rrjete

1. Operatorët e sistemit të transmetimit dhe të shpërndarjes zhvillojnë rrjetin e transmetimit dhe të shpërndarjes, rrjetet inteligjente me qëllim që të garantojnë funksionim të sigurt të sistemit të energjisë elektrike për të akomoduar zhvillimin e mëtejshëm të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë, përfshirë interkonjeksionin me vendet fqinje.

2. Operatorët e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes, me kërkesë të një prodhuesi të energjisë nga burimet e rinovueshme dhe në përputhje me kodet dhe rregulloret e miratuara nga ERE-ja, propozojnë si pikë lidhjeje në rrjetin e tyre pikën që plotëson kushtet më të favorshme për prodhuesin e energjisë së rinovueshme nga pikëpamja e kostos dhe e largësisë nga rrjeti dhe garanton qëndrueshmërinë e rrjetit dhe sigurinë e tij.

Në përzgjedhjen e pikës së lidhjes më të mirë dhe më të përshtatshme, operatorët e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes marrin në konsideratë kufizimet teknike dhe efikasitetin ekonomik të pikës së përzgjedhur të lidhjes me rrjetin.

3. Me kërkesë të prodhuesve potencialë të energjisë së rinovueshme, operatori i sistemit të rrjetit duhet të propozojë lidhje, duke përcaktuar pikën e lidhjes më të mundshme të projektit. Kjo ofertë lidhjeje duhet të jetë e vlefshme dhe detyruese për operatorin e sistemit sipas afateve të përcaktuara në Kodin e Transmetimit apo Shpërndarjes.

4. Instalimet ose njësitë e prodhimit të agreguar të vetëprodhuesve të burimeve të rinovueshme dhe projektet demonstruese me një kapacitet elektrik prej 10.8 kw ose më pak, ose lidhje ekuivalente të ndryshme nga lidhjet trefazore, do të lidhen në rrjetin e shpërndarjes pas një njoftimi të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.

Neni 19
Kostot për lidhjen me rrjetin dhe zgjerimin e kapaciteteve

1. Kostot e nevojshme të lidhjes së impianteve të gjenerimit të energjisë elektrike nga burime të rinovueshme të energjisë në pikën e lidhjes dhe pajisjet e nevojshme matëse për të regjistruar energjinë elektrike të furnizuar e të pranuar përballohen nga prodhuesi i energjisë së rinovueshme.

2. Çdo ndryshim tjetër i pikës së lidhjes nga impianti dhe çdo rritje tjetër e kapacitetit jashtë kushteve fillestare të kontratës, që ndikon në rrjet dhe shoqërohet me investime dhe kosto shtesë, do të mbulohet ekskluzivisht nga prodhuesi me miratimin paraprak të operatorit të rrjetit të shpërndarjes ose transmetimit.

3. Operatori i rrjetit është përgjegjës për kostot e optimizimit, të përforcimit dhe të zgjerimit të sistemit të rrjetit.

Neni 20
Vetëprodhuesit e energjisë së rinovueshme

1. Vetëprodhuesit e energjisë së rinovueshme kanë një kapacitet maksimal prej 500 kw dhe kanë të drejtë të gjenerojnë, të konsumojnë, të ruajnë dhe të shesin prodhimin e tepërt të energjisë elektrike të rinovueshme, duke përfshirë marrëveshjet dypalëshe me furnizues të energjisë elektrike dhe marrëveshje të tregtisë me homologët sipas parimit të barazisë dhe propocionalitetit.

2. Të drejtat dhe përgjegjësitë e vetëprodhuesve të energjisë së rinovueshme miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

3. Vendimi i Këshillit të Ministrave, referuar në pikën 2 të këtij neni, përcakton ndër të tjera:

a) skemën e kompensimit të vetëprodhuesit të energjisë së rinovueshme bazuar në metodologjinë e faturimit neto;

b) procedurën e trajtimit të aplikimeve për vetëprodhuesit e energjisë së rinovueshme, duke përfshirë afatet përkatëse;

c) kërkesat teknologjike dhe teknike, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në përmirësimet e nevojshme të matësve për të mundësuar zbatimin e skemës së kompensimit;

ç) rregullat për shitjen e energjisë së vetëprodhuar;

d) periudhën vjetore që do të shërbejë për matjen e prodhimit të tyre.

4. Çmimi i energjisë elektrike i gjeneruar nga vetëprodhuesit e energjisë së rinovueshme duhet të sigurojë një kompensim të drejtë që pasqyron vlerën e tregut të energjisë së furnizuar në rrjet dhe do të shmangë ndërsubvencionet ose diskriminimin e padrejtë ndërmjet vetëprodhuesit të energjisë së rinovueshme dhe konsumatorëve të tjerë. Çmimi i energjisë elektrike merr në konsideratë edhe kostot e shkaktuara për transmetimin, shpërndarjen dhe balancimin e sistemit. Çmimi për energjinë elektrike të gjeneruar nga vetëprodhuesit e energjisë së rinovueshme përcaktohet nga ERE-ja në përputhje me metodologjinë e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

5. Instalimi i impiantit të vetëprodhuesit të energjisë së rinovueshme mund të jetë në pronësi të një pale të tretë ose të menaxhohet nga një palë e tretë për instalim, operim, duke përfshirë matjen dhe mirëmbajtjen, me kusht që pala e tretë të mbetet subjekt i udhëzimeve të vetëprodhuesit të energjisë së rinovueshme. Në këtë rast pala e tretë nuk konsiderohet një vetëprodhues i energjisë së rinovueshme.

6. Operatori i Sistemit të Shpërndarjes mban dhe operon një sistem që regjistron informacionin për emrin, vendndodhjen, kapacitetin dhe datën e vënies në punë të impianteve të rinovueshme të vetëprodhuesit, duke përfshirë çdo informacion shtesë sipas parashikimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave, referuar në pikën 2 të këtij neni.

7. Skemat mbështetëse për vetëprodhuesit e energjisë së rinovueshme do të jenë proporcionale, do të kontribuojnë në objektivat kombëtarë për energji të rinovueshme të qeverisë së Shqipërisë dhe nuk do të rrezikojnë qëndrueshmërinë financiare të asnjë prej segmenteve të zinxhirit të furnizimit me energji elektrike. Skema do t'i nënshtrohet miratimit paraprak nga komisioni i ndihmës shtetërore në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën shtetërore.

8. Vetëprodhuesit e energjisë së rinovueshme të vendosur në të njëjtën ndërtesë, duke përfshirë blloqet me shumë apartamente, kanë të drejtë të angazhohen bashkërisht si vetëprodhues të energjisë së rinovueshme dhe u lejohet të organizojnë ndarjen e energjisë së rinovueshme që prodhohet në ndërtesën e tyre, duke respektuar tarifat e rrjetit dhe tarifa të tjera përkatëse, taksat dhe tatimet e aplikueshme për çdo vetëprodhues të energjisë së rinovueshme.

Neni 21

Komunitetet e energjisë së rinovueshme

1. Një komunitet i energjisë së rinovueshme ka të drejtë:

a) të prodhojë, të konsumojë, të depozitojë, të ndajë, të shesë energji të rinovueshme dhe të ofrojë agregim, duke përfshirë edhe marrëveshjet e shitblerjes së energjisë;

b) të ketë akses në të gjitha tregjet e përshtatshme të energjisë, drejtpërdrejt ose përmes agregimit, në mënyrë jodiskriminuese;

c) të mbështetet si prodhues me përparësi në përputhje me këtë ligj. Këshilli i Ministrave mund të vendosë që të mbështesë me masa shtesë komunitetet e energjisë së rinovueshme, duke i trajtuar si projekte demonstruese, në përputhje me nenin 15 të këtij ligji.

2. Çdo komunitet i energjisë së rinovueshme do t'i mundësojë dhe do të stimulojë familjet me të ardhura të ulëta ose në nevojë të bëhen anëtare.

3. Një kompani private mund të jetë anëtare e një komuniteti të energjisë së rinovueshme, me kusht që pjesëmarrja e saj të mos përfaqësojë veprimtarinë e saj kryesore tregtare ose profesionale.

4. Çdo konsumator fundor dhe konsumatori familjar kanë të drejtë të bëhen anëtarë të komunitetit të energjisë së rinovueshme dhe do të mbajnë statusin e konsumatorit fundor, me të drejtat dhe detyrimet që kanë në përputhje me këtë ligj dhe kuadrin ligjor përkatës dhe nuk do t'u nënshtrohen kushteve ose procedurave të pajustifikuara ose diskriminuese që pengojnë

pjesëmarrjen e tyre në një komunitet të energjisë së rinovueshme, me kusht që për sipërmarrjet private, pjesëmarrja e tyre të mos jetë veprimtaria e tyre kryesore tregtare ose profesionale.

5. Një komunitet i energjisë së rinovueshme u nënshtrohet tarifave të rrjetit kosto reflektuese, të cilat përcaktohen nga ERE-ja sipas metodologjisë së miratuar nga ana saj, si dhe tarifave, taksave dhe tatimeve përkatëse, duke siguruar kontribut në mënyrë adekuate, të drejtë dhe të balancuar në ndarjen e përgjithshme të kostos së sistemit.

6. Me udhëzim të ministrit përcaktohen:

a) format ligjore të krijimit të komuniteteve të energjisë së rinovueshme;

b) kushtet e pjesëmarrjes së hapur dhe vullnetare;

c) organizimi i kontrollit efektiv të masave të komunitetit të energjisë së rinovueshme, për lehtësimin e aksesit financiar, informativ, si dhe për ofrimin e mbështetjes rregullatore, ngritjen e kapaciteteve për autoritetet publike në mundësimin dhe krijimin e komuniteteve të energjisë së rinovueshme dhe për të ndihmuar autoritetet që të marrin pjesë drejtpërdrejt;

ç) çështje të tjera relevante.

7. Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës do të parashikojë politika dhe masa për nxitjen dhe lehtësimin e vetëprodhimit të energjisë së rinovueshme dhe komunitetet e energjisë së rinovueshme.

Neni 22

Garancitë e origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme

1. ERE-ja krijon një sistem për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe revokimin/anulimin e garancive të origjinës në lidhje me energjinë e prodhuar nga burimet e rinovueshme të energjisë. ERE-ja miraton rregullat për lëshimin e garancive të origjinës dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit të garancive të origjinës.

2. ERE-ja është organi kombëtar lëshues i garancive të origjinës në Republikën e Shqipërisë dhe siguron përafrimin e politikave dhe parimeve të garancisë së origjinës me sistemet e certifikatave të njohura në Komunitetin e Energjisë.

ERE-ja krijon një mekanizëm të përshtatshëm që siguron se garancitë e origjinës lëshohen, transferohen dhe anulohen në mënyrë elektronike dhe janë të sakta, të besueshme dhe jo të manipulueshme.

3. Procedura e lëshimit, transferimit, përdorimit dhe përfundimit të vlefshmërisë së garancisë së origjinës bazohet në parimet e objektivitetit, transparencës dhe mosdiskriminimit.

4. Garancia e origjinës do të lëshohet me kërkesë të prodhuesit të energjisë nga burimet e rinovueshme vetëm një herë për një sasi neto njësie prej 1 mwh të energjisë elektrike të prodhuar e të matur në pikën e lidhjes me sistemin e transmetimit, shpërndarjes ose të sistemit të mbyllur të shpërndarjes. E njëjta njësi e energjisë nga burimet e rinovueshme merret në konsideratë vetëm një herë.

5. Garancia e origjinës është e vlefshme për një vit duke filluar nga dita e fundit e periudhës së prodhimit për të cilën është lëshuar. Garancitë e origjinës që nuk janë anuluar skadojnë maksimalisht 18 muaj pas prodhimit të njësisë së energjisë.

6. Operatorët e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes dorëzojnë në ERE të dhëna për energjinë elektrike të prodhuar për të cilën është lëshuar garancia e origjinës.

7. Garancia e origjinës nuk mund të lëshohet për energjinë elektrike të prodhuar në një hidrocentral të kthyeshëm me sistem pompimi, në rast se energjia elektrike është prodhuar nga funksionimi i pompës.

8. Garancia e origjinës është e transferueshme.

9. Energjia elektrike e prodhuar nga burime të rinovueshme për të cilën prodhuesi nga burimet e rinovueshme e ka shitur garancinë përkatëse të origjinës veçmas nga energjia elektrike, nuk mund t'i tregohet apo t'i shitet blerësit fundor si energji elektrike e prodhuar nga burime të rinovueshme.

10. Kur një prodhues me përparësi përfiton nga masat mbështetëse sipas këtij ligji, vlera e tregut e garancisë së origjinës për të njëjtin prodhim duhet të kthehet te OER-ja. Në rast se prodhuesi përfiton masë mbështetëse për blerje të energjisë, garancia e origjinës i lëshohet OER-së. OER-ja vendos nëse e shet garancinë e origjinës direkt te furnizues apo konsumatorë apo në një procedurë konkurruese. Të ardhurat e krijuara nga OER-ja nga shitja e certifikatave të origjinës përdoren për fondin e energjisë së rinovueshme.

11. ERE-ja mund të refuzojë njohjen e garancisë së origjinës të një pale tjetër të

Komunitetit të Energjisë vetëm kur ka dyshime të bazuara për saktësinë, besueshmërinë ose vërtetësinë e saj. ERE-ja njofton sekretariatin e komunitetit të energjisë për çdo refuzim së bashku me arsyet për këtë refuzim. ERE-ja do të marrë parasysh çdo opinion të sekretariatit të komunitetit të energjisë për njohjen e garancive të origjinës dhe do të japë me shkrim arsyet për çdo devijim.

12. ERE-ja bashkëpunon me të gjitha autoritetet që lëshojnë garanci të origjinës në vendet anëtare të BE-së dhe me palët kontraktuese të komunitetit të energjisë, me qëllim që të vërë në dispozicion për konsumatorët fundorë informacionin për pjesën e energjisë së prodhuar nga burimet e rinovueshme të energjisë në totalin e energjisë së furnizuar.

13. ERE-ja mban një regjistër të garancive të origjinës në formë elektronike dhe publikon të dhënat nga regjistri në faqen e saj të internetit.

14. ERE-ja duhet t'i bashkohet sistemit rajonal të komunitetit të energjisë për të mundësuar tregtimin e garancive të origjinës me palët e tjera kontraktuese të komunitetit të energjisë. Kostot e sistemit rajonal të komunitetit të energjisë do të mbulohen nga tarifa që do të vendosen nga ERE-ja për lëshimin dhe tregtimin e certifikatave të origjinës së prodhuesve të pavarur.

KREU IV
BURIMET E RINOVUESHME TË ENERGJISË NË SEKTORIN E TRANSPORTIT, NGROHJES DHE FTOHJES DHE PËR PRODHIMIN E UJIT TË NXEHTË

Neni 23
Përdorimi i burimeve të rinovueshme të energjisë në transport

Masat nxitëse dhe promovuese për përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë në transport përcaktohen me ligj të veçantë.

Neni 24
Përdorimi i burimeve të rinovueshme të energjisë në ngrohje dhe ftohje

Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit, miraton vendimin për të mbështetur arritjen e objektivit kombëtar për burimet e rinovueshme të energjisë në sektorin e ngrohjes dhe ftohjes.

Neni 25
Detyrimet shtesë të raportimit në fushën e energjisë së rinovueshme

Raportet e integruara të progresit të energjisë dhe klimës të Shqipërisë përfshijnë informacionin shtesë si më poshtë:

a) funksionimi i sistemit të garancive të origjinës për energjinë elektrike, gazin dhe ngrohjen dhe ftohjen nga burimet e rinovueshme, nivelet e lëshimit dhe anulimit të garancive të origjinës dhe konsumit vjetor kombëtar të energjisë së rinovueshme që rezulton, si dhe masat e marra për të garantuar besueshmërinë dhe mbrojtjen e sistemit;

b) zhvillimet në disponueshmërinë, origjinën dhe përdorimin e burimeve të biomasës për qëllime energjetike;

c) ndryshimet në çmimet e mallrave dhe përdorimit të tokës brenda Republikës së Shqipërisë, të shoqëruara me rritjen e përdorimit të biomasës dhe formave të tjera të energjisë nga burimet e rinovueshme;

ç) prodhimi i tepërt i parashikuar i energjisë nga burimet e rinovueshme që mund të transferohen te palë të tjera kontraktuese ose shtetet anëtare të Bashkimit Evropian në mënyrë që këto të jenë në përputhje me këtë ligj dhe të arrijnë kontributet dhe trajektoret kombëtare, të përcaktuara në nenin 7, shkronja "a";

d) sipas rastit, kërkesa e vlerësuar për energji nga burimet e rinovueshme që duhet të plotësohet me mjete të ndryshme nga prodhimi vendas deri në vitin 2030, duke përfshirë lëndën e parë të biomasës së importuar;

dh) informacion se si është vlerësuar pjesa e mbetjeve të biodegradueshme në mbetjet e përdorura për prodhimin e energjisë dhe çfarë hapash janë marrë për të përmirësuar dhe verifikuar vlerësimet e tilla;

e) gjenerimi i energjisë elektrike dhe nxehtësisë nga energjia e rinovueshme në ndërtesa, duke përfshirë të dhënat e ndara për energjinë e prodhuar, konsumuar dhe futur në rrjet nga sistemet diellore fotovoltaike, sistemet termike diellore, biomasa, pompat e nxehtësisë, sistemet gjeotermale, si dhe të gjitha sistemet e tjera të rinovueshme të decentralizuara;

ë) sipas rastit, pjesa e energjisë së rinovueshme në ngrohjen qendrore, si dhe energjia e

rinovueshme e prodhuar nga qytetet dhe komunitetet e energjisë së rinovueshme;

f) furnizimi primar i biomasës së ngurtë;

g) çdo informacion tjetër.

Neni 26

Objektivat minimalë për përdorimin e energjisë diellore për prodhimin e ujit të ngrohtë

1. Këshilli i Ministrave përcakton treguesit minimalë për prodhimin e ujit të ngrohtë urban për përdorim sanitar dhe për proceset teknologjike, i përftuar prej sistemeve të energjisë diellore.

2. Treguesit minimalë për përdorimin e energjisë diellore, të përcaktuar sipas pikës 1 të këtij neni, vendosen duke marrë në konsideratë sasinë e rrezatimit diellor për zonat e ndryshme të vendit.

3. Këshilli i Ministrave miraton kriteret specifike për përllogaritjen e energjisë diellore të përdorur për të përfituar ujë të ngrohtë në mënyrë të veçantë ose si pjesë e kodit të energjisë së banesave, duke marrë në konsideratë standardet më të fundit të BE-së, të miratuara për këtë qëllim.

KREU V

DEPOZITIMI

Neni 27

Masat mbështetëse për depozitimin e pavarur

1. Ministri mund të vendosë mbështetjen e kapaciteteve të depozitimit përmes mekanizmave të kapacitetit në rast se:

a) kapacitetet e depozitimit nuk i përmbushin objektivat e përcaktuar, bazuar në një vlerësim të mjaftueshmërisë së sistemit të kryer nga Operatori i Sistemit të Transmetimit, në përputhje me ligjin për sektorin e energjisë elektrike;

b) kur një vlerësim sipas shkronjës "a" të kësaj pike, ose plani i zhvillimit të rrjetit identifikon nevoja fleksibile që nuk mund të përmbushen nga burimet ekzistuese në përputhje me ligjin për sektorin e energjisë elektrike.

2. Ministri merr një vendim për formën dhe kushtet e skemës së mbështetjes, si dhe për procesin konkurrues, duke identifikuar kategori të ndryshme depozitash që kanë të drejtë të marrin pjesë. Për këtë qëllim, ministri merr mendimin paraprak nga ERE-ja.

3. Çdo masë mbështetëse e bazuar në sa më sipër dhe përbën një ndihmë shtetërore do t'i nënshtrohet miratimit paraprak nga komisioni i ndihmës shtetërore në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën shtetërore.

Neni 28

Masat mbështetëse për depozitim në vend dhe energjia elektrike e prodhuar nga burimet e rinovueshme

1. Këshilli i Ministrave miraton masa për të mbështetur një teknologji specifike të depozitimit të energjisë së rinovueshme për të arritur reduktimin e emetimeve të CO2, sigurinë e furnizimit ose optimizimin e përdorimit të prodhimit të energjisë së rinovueshme.

2. Masat mbështetëse mund të marrin formën e granteve, kredive për investime, primit ose mbështetje tjetër operative. Çdo masë mbështetëse që përbën ndihmë shtetërore do t'i nënshtrohet miratimit paraprak nga komisioni i ndihmës shtetërore në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën shtetërore.

3. Çdo masë mbështetëse, sipas këtij neni, duhet të jepet nëpërmjet një procesi konkurrues të përcaktuar me urdhër të ministrit. Forma e skemës së mbështetjes, kushtet e tjera të skemës së mbështetjes, pala mbështetëse dhe dokumentet e procesit konkurrues përcaktohen përpara nisjes së çdo procesi konkurrues nga ministri.

KREU VI

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 29

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktet nënligjore në zbatim të nenit 5, pika 2; nenit 6, pika 2; nenit 10, pikat 1, 4 dhe 5; nenit 15, pika 1; nenit 16, pika 7; nenit 20, pika 2; nenit 24 dhe nenit 26, pikat 1 e 3, të këtij ligji.

2. Ngarkohet ministria përgjegjëse për energjinë që brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktet nënligjore në zbatim të nenit 10, pika 1, dhe nenit 21, pika 6, të këtij ligji.

3. Ngarkohet Enti Rregullator i Energjisë që brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktet nënligjore në zbatim të nenit 14, pika 2; nenit 16, pika 9; nenit 17, pika 5; nenit 20, pika 4, të këtij ligji.

Neni 30
Dispozitat kalimtare

1. Deri në krijimin e Operatorit të Energjisë së Rinovueshme, detyrat e tij kryhen nga furnizuesi në tregun e lirë. Gjatë kësaj periudhe, furnizuesi në tregun e lirë do të kryejë detyrat për llogaritjen dhe arkëtimin e detyrimit për energjinë e rinovueshme.

2. Ky ligj nuk do të zbatohet dhe as nuk do të prekë MBE-të ekzistuese, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga MBE-ja specifike ekzistuese.

3. Prodhuesit ekzistues me përparësi ndryshojnë MBE-të ekzistuese duke zgjedhur OER-në si marrës të energjisë elektrike të prodhuar, pa cenuar siguritë dhe garancitë e dhëna sipas MBE-së ekzistuese.

4. Prodhuesit ekzistues me përparësi kanë të drejtë të zgjedhin të përfitojnë nga mbështetja në formën e një CfD-je, ndërsa tarifa e MBE-së ekzistuese shërben si çmimi i garantuar.

5. Palët do të ndërmarrin të gjithë hapat e nevojshëm për të kthyer MBE-në në një CfD pas kryerjes së vlerësimit të gatishmërisë së tregut nga ERE-ja në përputhje me këtë nen, që vlerëson se tregu është likuid. ERE-ja duhet të kryejë një vlerësim të gatishmërisë së tregut jo më herët se 10 (dhjetë) muaj pas krijimit të bursës shqiptare të energjisë elektrike, ku të vlerësojë që kriteret e mëposhtme janë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme:

a) është krijuar një bursë operacionale e energjisë elektrike që ofron çmime reference për periudhën përkatëse të shlyerjes për tregun e ditës në avancë për një periudhë të njëpasnjëshme 10-mujore;

b) janë duke u zbatuar parimet dhe rregullat për integritetin dhe transparencën e shitjes së energjisë në treg, përfshirë për personat që organizojnë profesionalisht transaksione;

c) vëllimet e tregtuara në tregun e një dite në avancë në lidhje me madhësinë fizike të tregut janë në një nivel të krahasueshëm me vëllime të tilla në disa tregje të ditës në avancë në vende të Bashkimit Evropian. ERE-ja ka të drejtë të përzgjedhë disa tregje të ditës në avancë në Bashkimin Evropian për të kryer një vlerësim krahasimor të përshtatshëm.

6. ERE-ja do të organizojë një këshillim publik me palët e interesuara në lidhje me vlerësimin e gatishmërisë së tregut sipas këtij neni dhe do të publikojë një raport të këtij vlerësimi së bashku me gjetjet e saj.

7. Çdo ndryshim për shkak të një konvertimi CfD-je duhet të arrijë të njëjtën balancë të përfitimeve, detyrimeve, rreziqeve dhe shpërblimeve ndërmjet palëve si në MBE-në ekzistuese.

8. Në çdo rast, niveli i mbështetjes nuk do të rishikohet në një mënyrë që të ndikojë negativisht në të drejtat që u jepen prodhuesve me përparësi dhe të dëmtojë qëndrueshmërinë ekonomike të projekteve të prodhuesve me përparësi.

9. Në përfundim të vlerësimit të gatishmërisë së tregut nga ERE-ja, Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit, mund të përcaktojë një blerës së mundësisë së fundit ku, në rast të vështirësisë së shitjes së vëllimeve në tregun e lirë, prodhuesit me përparësi mund të shesin vëllimet e energjisë elektrike tek blerësi i mundësisë së fundit përkundrejt një tarife më të ulët se çmimi referencë. Kushtet për përcaktimin e blerësit të mundësisë së fundit dhe të ofrimit të shërbimit të blerjes mundësisë së fundit për prodhuesit me përparësi sipas këtij neni përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit.

10. Neni 20 i këtij ligji është i zbatueshëm duke filluar nga data 1 janar 2024. Deri në këtë datë klientët privatë apo publikë, si dhe klientët familjarë mund të instalojnë një kapacitet total deri në 500 kw për prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme për të mbuluar një pjesë ose të gjithë energjinë që nevojitet për nevojat e tij dhe të injektojë energjinë e tepërt të prodhuar në rrjetin e shpërndarjes. Këta klientë përfitojnë sipas skemës së matjes neto të energjisë dhe duhet të instalojnë me shpenzimet e tyre një matës me dy drejtime. Bilanci neto dhe faturimi bëhen në baza vjetore për secilën pikë matëse.

Neni 31
Shfuqizimi i akteve

1. Ky ligj shfuqizon ligjin nr. 7/2017, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", i ndryshuar.

2. Aktet nënligjore të dala në bazë dhe në zbatim të ligjit nr. 7/2017, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme", të ndryshuar, vazhdojnë të mbeten në fuqi dhe të zbatohen deri në momentin e miratimit të akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 32
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.3.2023.

Shpallur me dekretin nr.56, datë 11.4.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 56, datë 11.4.2023

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 24/2023, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ
Nr. 25/2023

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, PËR PROGRAMIN KOMBËTAR TË MODERNIZIMIT TË SEKTORIT TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE NË SHQIPËRI

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, shkronja "ç", të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, për Programin Kombëtar të Modernizimit të Sektorit të Ujësjellës-Kanalizimeve në Shqipëri, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.3.2023.

Shpallur me dekretin nr. 52, datë 6.4.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

NUMRI I HUAS 9373-AL

MARRËVESHJE HUAJE
(PROGRAMI KOMBËTAR I MODERNIZIMIT TË SEKTORIT TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE NË SHQIPËRI) NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Marrëveshje e datës, sipas datës së nënshkrimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë ("Huamarrësi") dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim ("Banka"),

duke pasur parasysh se Banka, duke vepruar si administratore e Programit Kombëtar të Modernizimit të Sektorit të Ujësjellës-Kanalizimeve në Shqipëri nga Fondi i Mirëbesimit me Një Donator, ra dakord t'i japë Huamarrësit një grant në një shumë prej 3,000,000 dollarësh, për të ndihmuar në financimin e Projektit të përshkruar në skedulin 1 të Marrëveshjes së Grantit mbi afatet dhe kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen e Grantit;

tashmë, si rrjedhojë, Huamarrësi dhe Banka bien dakord si më poshtë.

Neni I
Kushtet e përgjithshme; përkufizimet

1.01 Kushtet e përgjithshme (siç përcaktohen në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje) janë të zbatueshme dhe janë pjesë e kësaj Marrëveshjeje.

1.02 Përveç rasteve kur konteksti e kërkon ndryshe, termat me germa kapitale të përdorura në këtë Marrëveshje kanë kuptimet përkatëse të parashikuara në Kushtet e Përgjithshme ose në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje.

Neni II
Huaja

2.01 Banka pranon t'i japë Huamarrësit shumën prej gjashtëdhjetë e shtatë milionë e treqind mijë eurosh (67,300,000 €), siç kjo shumë mund të konvertohet herë pas here përmes këmbimit valutor ("Hua"), për të ndihmuar në financimin e programit të përshkruar në skedulin 1 të kësaj Marrëveshjeje ("Programi").

2.02 Huamarrësi mund të tërheqë të ardhurat e Huas në përputhje me seksionin IV të skedulit 2 të kësaj Marrëveshjeje. Të gjitha tërheqjet nga llogaria e huas do të depozitohen nga Banka në një llogari të caktuar nga Huamarrësi dhe të pranueshme për Bankën.

2.03 Komisioni paraprak konsiston në një të katërtën e një për qind (0.25%) të shumës së huas.

2.04 Tarifa e Angazhimit konsiston në një të katërtën e një për qind (0.25%) në vit mbi Balancën e Huas së Patërhequr.

2.05 Norma e interesit është Norma Referuese plus shpërndarja e ndryshueshme; ose kjo normë mund të zbatohet pas një Konvertimi; në bazë të seksionit 3.02(e) të Kushteve të Përgjithshme.

2.06 Datat e pagesës janë 15 janari dhe 15 korriku i çdo viti.

2.07 Shuma e principalit të huas do të paguhet në përputhje me skedulin 3 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni III
Programi

3.01 Huamarrësi deklaron angazhimin e tij ndaj objektivave të Programit. Për këtë qëllim, Huamarrësi do të realizojë pjesën 1 të Programit nëpërmjet MIE-s dhe do të marrë masa që pjesët 2 dhe 3 të Programit të realizohen nga AKUM-i, të gjitha në përputhje me dispozitat e nenit V të Kushteve të Përgjithshme dhe Skedulit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni IV
Mjetet Ligjore të Bankës

4.01 Rastet Shtesë të Pezullimit përbëhen nga sa vijon:

a) se legjislacioni i AKUM-it është ndryshuar, pezulluar, shfuqizuar, anuluar ose hequr dorë, në mënyrë që të ndikojë materialisht dhe negativisht, sipas mendimit të Bankës, në aftësinë e Huamarrësit për të përmbushur ndonjë nga detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje;

b) se çdo Ndërmarrje UK ose NJQV nuk ka arritur të përmbushë asnjë nga detyrimet e saj, sipas Marrëveshjes së saj përkatëse të Performancës.

4.02 Rasti Shtesë i Përshpejtimit përbëhet nga sa vijon: specifikisht që një rast i përcaktuar në seksionin 4.01(a) ose (b) të kësaj Marrëveshjeje ndodh dhe vazhdon për një periudhë prej 60

ditësh, pasi Huamarrësit i është dhënë njoftimi për rastin nga Banka.

Neni V
Hyrja në Fuqi; Zgjidhja

5.01 Kushtet shtesë të hyrjes në fuqi përbëhen nga sa vijon:

a) Manuali Operacional i Programit është miratuar nga MIE dhe AKUM-i në formë dhe përmbajtje të pranueshme për Bankën.

b) Marrëveshja e Grantit është zbatuar dhe dorëzuar dhe janë përmbushur kushtet paraprake të hyrjes në fuqi të marrëveshjes në fjalë ose të së drejtës së Huamarrësit për të kryer tërheqje, sipas marrëveshjes në fjalë (përveç hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje).

5.02 Afati i hyrjes në fuqi është data pasuese pas 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit. Në bazë të seksionit 9.03 të Kushteve të Përgjithshme, përveç rasteve kur Banka dhe Huamarrësi bien dakord ndryshe, kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën kur Banka i dërgon Huamarrësit njoftimin që konfirmon se është e bindur që kushtet e specifikuara në seksionin 9.01 të saj janë përmbushur ("Data e hyrjes në fuqi").

Neni VI
Përfaqësuesi; Adresat

6.01 Përfaqësuesi i Huamarrësit është ministri i tij përgjegjës për financat:

6.02 Për qëllime të seksionit 10.01 të Kushteve të Përgjithshme:

a) adresa e Huamarrësit është:

Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3
Tiranë, Shqipëri dhe

b) Adresa elektronike e Huamarrësit është:

E-mail:
sekretariamin@financa.gov.al

6.03 Për qëllime të seksionit 10.01 të Kushteve të Përgjithshme:

a) adresa e Bankës është:

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim
1818 H Street, N.W.
Washington, D.C., 20433
Shtetet e Bashkuara të Amerikës; dhe

b) Adresa elektronike e Bankës është:

Telefon: 248423(MCI) ose 64145(MCI)
Faks: 1-202-477-6391
E-mail: esalinas@worldbank.org

Palët ranë dakord në Datën e Nënshkrimit

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga /*nënshkrimi*/
_____
Përfaqësues i Autorizuar

Emri: Delina Ibrahimaj
Titulli: Ministër i Financave dhe Ekonomisë
Datë 15.12.2022

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga /*nënshkrimi*/
_____
Përfaqësues i Autorizuar

Emri: Emanuel Salinas
Titulli: Menaxher i Vendit
Datë 8 dhjetor 2022

SKEDULI 1
PËRSHKRIMI I PROGRAMIT

Objektivat e Programit janë përmirësimi i performancës operacionale dhe financiare të ndërmarrjeve të ujësjellës-kanalizimeve (UK) dhe rritja e aksesit në shërbimet e ujësjellësit të menaxhuar në mënyrë të sigurt në Republikën e Shqipërisë.

Programi përbëhet nga aktivitetet e mëposhtme:

Pjesa 1. Forcimi i Kuadrit Sektorial Kombëtar

1. Miratimi i udhëzimeve të politikave me kriteret e përshtatshmërisë dhe metodologjinë për ndarjen e subvencioneve të financuara nga buxheti fiskal për NJQV-të dhe ndërmarrjet UK nga AKUM-i, në lidhje me sa vijon:

i. grante për NJQV dhe/ose ndërmarrjet UK për të mbuluar mungesat e të ardhurave si një përgjigje emergjente ndaj situatës së COVID-19 ("Grantet e COVID-19") dhe grante të bazuara në performancë për NJQV-të dhe/ose ndërmarrjet

UK për të mbuluar shpenzimet operacionale ("Grante të bazuara në performancë");

ii. grante për ndërmarrjet UK për të mbështetur investimet në eficiencë dhe përmirësimin e performancës, duke përfshirë infrastrukturën e ujësjellësit për vazhdimësinë e shërbimit, ngritjen e zonave të matura në rrethe, reduktimin e ujit pa të ardhura, matjen e vëllimeve të ujit dhe përmirësime të tjera në zonat urbane dhe zonat rurale, investimet për eficiencën e energjisë dhe masat e ndryshimit të ndërmarrjeve ("Grantet e Investimeve");

iii. stimuj për proceset e grumbullimit ose ristrukturimit për NJQV-të dhe/ose ndërmarrjet UK ("Stimujt"); dhe

iv. grante për ndërmarrjet UK për të mbështetur investimet në lidhjet e reja të ujësjellësit në zonat e pafurnizuara periurbane dhe rurale, duke përfshirë familjet në nevojë ("Grante Investimi për Lidhje të Reja").

2. Mbështetja e koordinimit ndërmjet AKUM-it dhe ERRU-së për të kërkuar rregullimin e politikave në përcaktimin e metodologjisë së tarifave dhe për të promovuar miratimin e një udhëzuesi për planin e biznesit në përputhje me kërkesat rregullatore.

3. Mbështetja: i. e përhapjes së sistemit kombëtar të informacionit për të përmirësuar besueshmërinë e të dhënave të performancës/vlerësimit të ndërmarrjeve dhe duke mundësuar monitorimin e treguesve kryesorë të performancës së ndërmarrjes; ii. miratimin e programit kombëtar të certifikimit për stafin e ndërmarrjeve UK; dhe iii. forcimin e kërkesave ekzistuese të qeverisjes korporative dhe mekanizmave të korrigjimit të ankesave, menaxhimin e aktiveve dhe sistemet e informacionit të menaxhimit në nivel lokal dhe qendror.

Pjesa 2. Përmirësimi i Performancës Operacionale dhe Financiare të Ndërmarrjeve UK

1. Financimi: a) i Granteve të COVID-19; dhe b) Grantet e Bazuara në Performancë për NjQV-të e përzgjedhura dhe/ose Ndërmarrjet UK.

2. Financimi i Granteve të Investimeve për ndërmarrjet e përzgjedhura të UK.

3. Stimuj financimi për NJQV-të e përzgjedhura dhe/ose ndërmarrjet UK.

Pjesa 3. Mbyllja e mangësive të Shërbimeve të Përgjithshme të Aksesit të Ujësjellësit

1. Financimi i Granteve të Investimeve të Lidhjes së Re për ndërmarrjet e përzgjedhura të UK-së.

SKEDULI 2
EKZEKUTIMI I PROGRAMIT

Seksioni I. Marrëveshjet e Zbatimit

A. Institucionet e programit

1. Jo më vonë se 3 (tre) muaj pas datës së hyrjes në fuqi, Huamarrësi, nëpërmjet MIE-s, do të marrë masa dhe më pas do të mbajë gjatë gjithë zbatimit të Programit, Njësinë e Monitorimit të Programit ("NJMP") me staf kryesor, duke përfshirë të paktën menaxherin e Programit, specialistin ligjor/për institucionin dhe specialistin për monitorimin dhe vlerësimin, të gjithë të pajisur me kualifikime profesionale, përvojë, përgjegjësi dhe terma reference të pranueshëm për Bankën; të jenë përgjegjës për monitorimin e Programit dhe përgjegjësitë e tjera të përcaktuara në Manualin Operacional të Programit.

2. Jo më vonë se 3 (tre) muaj pas datës së hyrjes në fuqi, Huamarrësi, nëpërmjet MIE-s, do të marrë masa që AKUM-i të krijojë dhe më pas të mbajë gjatë gjithë zbatimit të Programit, Njësinë e Koordinimit të Programit (NJKP) me staf kryesor, duke përfshirë të paktën një menaxher/koordinator të programit, specialist ligjor, specialist teknik të ujit, specialist analist të biznesit për ujin, specialist të menaxhimit dhe të monitorimit të të dhënave, specialist të menaxhimit financiar, specialist prokurimi, specialist të punëve sociale, specialist të angazhimit të qytetarëve dhe komunikimit dhe specialist mjedisor, të gjithë të pajisur me kualifikime, përvojë, përgjegjësi dhe termat e referencës të pranueshme për Bankën; me përgjegjësitë e përcaktuara në Manualin Operacional të Programit.

B. Marrëveshjet e Performancës

Për të lehtësuar zbatimin e Programit, Huamarrësi, nëpërmjet MlE-s, do të marrë masa që AKUM-i të lidhë një marrëveshje (secila një "Marrëveshje e Performancës) me çdo Ndërmarrje përkatëse të UK-së dhe/ose NJQV-së, sipas afateve dhe kushteve të pranueshme për Bankën dhe të përcaktuara në Manualin Operacional të Programit, duke përfshirë:

a) detyrimin e AKUM-it që: i. të ofrojë grante të bazuara në performancë dhe/ose grante për COVID-19 për ndërmarrjet e UK-së dhe/ose NJQV-së sipas pjesës 2.1 të Programit; ii. të ofrojë Grante të Investimeve dhe Grant të Investimit për Lidhje të Reja për ndërmarrjet e UK-së dhe/ose NJQV-së, sipas pjesëve 2.2 dhe 3, përkatësisht, të Programit; ose iii. të ofrojë stimuj për ndërmarrjet e UK-së dhe/ose NJQV-të sipas pjesës 2.3 të Programit; dhe

b) detyrimin e ndërmarrjes UK dhe/ose detyrimin e NJQV-së për të përmbushur kërkesat e përcaktuara në udhëzuesin e Huamarrësit që do të hartohet sipas pjesës 1.1 të Programit, Udhëzuesin Kundër Korrupsionit, POM dhe të garantojë që veprimtaritë e Programit të kryhen nga një subjekt që nuk kryen asnjë veprimtari që nuk përcaktohet në seksionin II të këtij Skeduli 2.

C. Manuali Operacional i Programit

1. Huamarrësi do të miratojë, nëpërmjet MIE-s, dhe më pas do të zbatojë Programin dhe do marrë masa për zbatimin e tij, në përputhje me dispozitat e manualit (Manuali Operacional i Programit ose "POM") të përshtatshme për Bankën, që përfshin, ndër të tjera: a) veprimtaritë dhe planin e veprimeve që do të kryhen në kuadër të Programit; b) rolet dhe përgjegjësitë përkatëse të subjekteve pjesëmarrëse në Program; c) përbërjen dhe përgjegjësitë e NJMP-së dhe NJKP-së; d) aspektet dhe procedurat teknike dhe operacionale në mirëbesim për zbatimin e Programit, duke përfshirë procedurat e menaxhimit financiar; e) treguesit e performancës për Programin; f) kriteret dhe procedurat minimale të përshtatshmërisë dhe përzgjedhjes për Grantet, duke përfshirë kërkesat minimale për vlerësimet vjetore të performancës së ndërmarrjeve të UK-së dhe kufijtë maksimalë për këto grante; g) procedurat për alokimin në kohë të Granteve nga AKUM-ja për NJQV/Ndërmarrjet e UK-së dhe verifikimin e përputhshmërisë me kërkesat e përshtatshmërisë, sipas udhëzuesit të politikave; h) protokollet e verifikimit për DLI dhe DLR; i) Udhëzuesit Kundër Korrupsionit; dhe j) Planin e Veprimit të Programit, si shtojcë.

2. Huamarrësi, nëpërmjet MIE-s, duhet dhe do të marrë masa që AKUM të mos ndryshojë, të mos heqë dorë dhe të mos zbatojë asnjë dispozitë të POM-së, pa miratimin paraprak me shkrim të Bankës.

3. Në rast të ndonjë konflikti midis kushteve të POM-së dhe atyre të kësaj Marrëveshjeje, kushtet e kësaj Marrëveshjeje do të kenë përparësi.

D. Agjencia e Pavarur Verifikuese

1. Jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj pas datës së hyrjes në fuqi, Huamarrësi, nëpërmjet MIE-s, do të: i. rekrutojë një agjenci të pavarur verifikuese ose agjenci të pavarura verifikimi, sipas rastit, sipas termave të referencës/ve të përshtatshme për Bankën ("Agjent i Pavarur Verifikues" ose "IVA") që do të jetë përgjegjëse për përgatitjen dhe ofrimin e raporteve të verifikimeve në përputhje me Protokollin e Verifikimit, duke vërtetuar arritjen e atyre DLI/DLR-ve të caktuara për t'u verifikuar nga agjenci/agjenci të pavarura verifikimi në Protokollin e Verifikimit; dhe t'i dorëzojë Bankës raportet e verifikimit në atë fushë dhe në detajet që do të kërkojë Banka.

2. Huamarrësi, nëpërmjet MIE-s, duhet dhe do të marrë masa që AKUM-i të garantojë që verifikimet janë kryer dhe se raportet e verifikimit janë përgatitur në përputhje me procedurat e përcaktuara në Protokollin e Verifikimit.

E. Masat shtesë për zbatimin e programit

1. Huamarrësi, nëpërmjet MIE-s, do të realizojë Planin e Veprimit të Programit ose do të marrë masa që Plani i Veprimit të Programit të realizohet, në përputhje me planin e përcaktuar në Planin e Veprimit të Programit në fjalë, në një mënyrë të përshtatshme për Bankën.

2. Huamarrësi, nëpërmjet MlE-s, duhet dhe do të marrë masa që AKUM-i të mos transferojë, ndryshojë, shfuqizojë ose heqë dorë, ose të lejojë transferimin, ndryshimin, shfuqizimin ose heqjen dorë nga asnjë nga dispozitat e Planit të Veprimit të Programit pa miratimin paraprak me shkrim të Bankës.

Seksioni II. Aktivitetet e përjashtuara

Huamarrësi, nëpërmjet MlE-së, duhet dhe do të marrë masa që AKUM-i të garantojë që Programi të përjashtojë çdo aktivitet, që:

a) sipas mendimit të Bankës, mund të ketë ndikime negative të rëndësishme që janë sensitive, të ndryshme ose të paprecedentë në mjedis dhe/ose personat e prekur;

b) përfshin prokurimin e: 1. punimeve që vlerësohet të kushtojnë 75,000,000 dollarë ekuivalente ose më shumë për kontratë; 2. mallrave që vlerësohet të kushtojnë 50,000,000 dollarë ekuivalente ose më shumë për kontratë; 3.

shërbime jokonsulence që vlerësohet të kushtojnë 50,000,000 dollarë ekuivalente ose më shumë për kontratë; ose 4. shërbime konsulence që vlerësohet të kushtojnë 20,000,000 dollarë ekuivalente ose më shumë për kontratë.

Seksioni III. Monitorimi, Raportimi dhe Vlerësimi i Projektit

Huamarrësi, nëpërmjet MlE-së, do t'i dorëzojë Bankës çdo Raport të Programit jo më vonë se dyzet e pesë ditë pas përfundimit të çdo semestri kalendarik, duke përfshirë semestrin kalendarik.

Seksioni IV. Tërheqja e të ardhurave nga huaja

A. Të përgjithshme

1. Pa u kufizuar në dispozitat e nenit II të Kushteve të Përgjithshme dhe në përputhje me Letrën e Informacionit të Disbursimit dhe atë Financiar, Huamarrësi mund të tërheqë të ardhurat e Huas, që: a) të paguajë komisionin paraprak; b) të paguajë çdo kufi të normës së interesit ose kufi të primit të normës së interesit; dhe c) të financojë Shpenzimet e Programit (duke përfshirë Taksat), në bazë të rezultateve ("Rezultatet e Lidhura me Disbursimin" ose "DLR") të kryera nga MIE, AKUM ose ndërmarrjet e UK-së, sipas rastit, të vlerësuara me tregues të veçantë ("Treguesit që lidhen me disbursimin" ose "DLI"); të gjitha siç janë përcaktuar në tabelën në paragrafin 2 të kësaj pjese A.

2. Tabela e mëposhtme specifikon çdo kategori të tërheqjes së të ardhurave të Huas (duke përfshirë treguesit që lidhen me disbursimin, sipas rastit) ("Kategoria"), rezultatet që lidhen me disbursimin për secilën kategori (sipas rastit) dhe alokimin e shumave të Huas për çdo kategori:

Kategoria (duke përfshirë treguesin që lidhet me disbursimin, sipas rastit)	Rezultati që lidhet me disbursimin (sipas rastit)	Shuma e Huas së Alokuar (e shprehur në euro)	Formula e Disbursimit
1. DLI #1: Përmirësimi i mekanizmave të financimit të sektorit dhe stimujve për performancën e përshtatur	DLR #1.1 Huamarrësi ka miratuar udhëzuesit e rinj në vijim të kritereve të pranueshmërisë dhe metodologjisë së bazuar në performancë për alokimin e subvencioneve nga buxheti i shtetit dhe monitorimin e përdorimit të tyre nga Ndërmarrjet e UK-së: i. Udhëzues mbi subvencionet për ndikimet dhe shpenzimet operacionale të COVID-19. ii. Udhëzues mbi subvencionet për investimet kapitale në përmirësimin e efikasitetit operacional dhe gjendjes financiare. iii. Udhëzues mbi subvencionet për stimujt për grumbullimin ose ristrukturimin e ndërmarrjeve të UK-së. iv. Udhëzues mbi subvencionet për investimet kapitale për akses të ri në shërbimet e furnizimit me ujë në zonat e pafurnizuara.	9,000,000	1,800,000 € për çdo udhëzues sipas DLR 1.1 (i), (ii), (iii) dhe (iv) dhe 1,800,000 € kur të gjitha udhëzimet e përmendura janë plotësuar, deri në 9,000,000 €
2. DLI #2: Përmirësimi i alokimit të shpenzimeve publike për sektorin e UK-së	DLR # 2.1 AKUM ka alokuar në planin e tij buxhetor afatmesëm grante për NJQV-të dhe/ose ndërmarrjet e UK-së në përputhje me udhëzimet e miratuara sipas DLR l.l (i), 1.1 (ii), dhe 1.1 (iii) dhe (iv).	22,131,750	1 € për çdo ekuivalent 1 € të alokuar deri në 22,131,750 €
3. DLI #3: Përmirësimi i qëndrueshmërisë financiare të sektorit të UK-së	DLR #3.1 10% Rezultati i Përmbledhur Kombëtar i Përmirësuar për Mbulimin e Drejtpërdrejtë të Kostos së Funksionimit, nga viti bazë 2022.	9,000,000	900,000 € për çdo rritje me 1% nga viti bazë 2022, deri në 9,000,000 €
4. DLI #4: Vazhdimësia e	DLR # 4.1 Të paktën tridhjetë e pesë	9,000,000	450,000 € për çdo

përmirësuar e shërbimeve të ujësjellësit	Zona Urbane me një minimum prej 18 orësh furnizimi me ujë nga një bazë prej pesëmbëdhjetë Zonash Urbane		Zonë të re Urbane deri në 9,000,000 €
5. DLI #5: Numri i lidhjeve të reja funksionale të familjeve që ofrojnë shërbime të sigurta dhe të besueshme të ujit	DLR #5.1 Lidhje të reja funksionale të ujit në familjet jo të cenueshme, nga një bazë prej 0. DRI #5.2 Lidhje të reja funksionale të ujit për familjet e cenuara, nga një bazë prej 0.	18,000,000	i. 1,400 € për çdo lidhje të re të ujit në familjet jo të cenueshme, deri në 12,600,000 €; dhe ii. 1,800 € për çdo lidhje të re të ujit në familjet e cenuara, deri në një shumë totale prej 18,000,000 € si për familjet jo të cenuara (DLR#5.l) dhe për familjet e cenuara (DLR#5.2).
4. Komisioni paraprak duhet të paguhet në përputhje me seksionin 2.03 të kësaj Marrëveshjeje në përputhje me seksionin 2.05 (b) të Kushteve të Përgjithshme		168,250	
5. "Kufiri i normës së interesit ose kufiri i primit të normës së interesit që duhet paguar në përputhje me seksionin 4.05 (c) të Kushteve të Përgjithshme			
SHUMA TOTALE		**67.300.000**	

B. Kushtet e tërheqjes; Periudha e Tërheqjes.

1. Pavarësisht nga dispozitat e pjesës A të këtij seksioni, nuk do të kryhet asnjë tërheqje:

a) në bazë të DLR-ve të arritura para datës së nënshkrimit, përveç rasteve për tërheqjet që arrijnë një shumë totale që nuk kalon dy milionë e shtatëqind mijë euro (2,700,000 €), mund të kryhen në bazë të DLR-ve të arritura para kësaj date, por jo në datën 20 qershor 2019 apo pas kësaj date.

b) për çdo DLR sipas kategorive 1 deri në 5, derisa dhe nëse Huamarrësi nuk i ka dhënë Bankës prova të mjaftueshme që DLR-ja është arritur.

2. Pavarësisht nga dispozitat e pjesës B.1(b) të këtij seksioni, Huamarrësi mund të tërheqë një shumë që nuk i kalon dymbëdhjetë milionë e pesëqind mijë euro (12,500,000 €) si paradhënie; megjithatë, me kusht që nëse DLR-të, sipas mendimit të Bankës, nuk arrihen (ose arrihen vetëm pjesërisht) deri në Datën e Mbylljes, Huamarrësi rimburson këtë paradhënie në Bankë menjëherë pas njoftimit nga Banka. Përveç rasteve kur është rënë dakord ndryshe me Huamarrësin, Banka anulon shumën e rimbursuar në këtë mënyrë. Çdo tërheqje e mëtejshme e kërkuar si paradhënie sipas çdo kategorie lejohet vetëm sipas kushteve dhe afateve të specifikuara nga Banka me njoftimin e Huamarrësit.

3. Data e mbylljes është 31 dhjetor 2027.

Seksioni IV. Ndërmarrje të tjera

A Huamarrësi, nëpërmjet MlE-së, dorëzon jo më vonë se 8 (tetë) muaj pas datës së Hyrjes në Fuqi, "Rezultatin e Përmbledhur Kombëtar për Mbulimin e Drejtpërdrejtë të Kostos së Funksionimit" për vitin kalendarik 2022, duke përfshirë llogaritjen dhe çdo dokumentacion mbështetës, të verifikuar nga IVA, në përputhje me kriteret e përcaktuara në POM, për miratim nga Banka.

SKEDULI 3
SKEDULI I SHLYERJES SË AMORTIZIMIT TË LIDHUR ME ANGAZHIMIN

Tabela e mëposhtme përcakton datat e pagesës së principalit të huas dhe përqindjen e shumës totale të principalit të huas që paguhet në secilën datë të pagesës së principalit ("Pjesa e kësteve").

Niveli i shlyerjes së principalit

Data e shlyerjes së principalit	Pjesa e kësteve
Në çdo 15 janar dhe 15 korrik Duke filluar nga data 15 korrik 2026 deri më 15 korrik 2037	4,17%
Më 15 janar 2038	4,09%

SHTOJCË

Seksioni I. Përkufizimet

1. "AKUM" nënkupton Agjencinë Kombëtare Shqiptare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, të krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 431, datë 11 korrik 2018, nën varësinë e MIE-s.

2. "Legjislacioni i AKUM-it" nënkupton vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 431, datë 11 korrik 2018, ose çdo instrument tjetër përkatës themelimi ose regjistrimi, çdo legjislacion, urdhër qeveritar, rregullore ose marrëveshje përkatëse që krijon AKUM-i dhe/ose ndikon në aftësinë e AKUM-it për të përmbushur ndonjë nga detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje, prezantohet, ndryshohet, pezullohet, shfuqizohet ose anulohet sipas mendimit të Bankës, për të ndikuar materialisht dhe negativisht në aftësinë e AKUM-it në përmbushjen e ndonjë prej detyrimeve sipas Programit.

3. "Udhëzues kundër Korrupsionit" nënkupton për qëllimet e paragrafit 5 të shtojcës së Kushteve të Përgjithshme, "Udhëzuesit e Bankës për Parandalimin dhe Luftën ndaj Mashtrimit dhe Korrupsionit në Financimin e Programit për Rezultate", datë 1 shkurt 2012 dhe i rishikuar në datën 10 korrik 2015.

4. "Kategori" nënkupton një kategori të përcaktuar në tabelën në Seksionin IV.A.2 të Skedulit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

5. "COVID-19" nënkupton sëmundjen e koronavirusit të shkaktuar nga koronavirusi i ri i vitit 2019 (SARS-CoV-2)

6. "Grant i COVID-19" nënkupton një subvencion të financuar nga buxheti fiskal që do t'i jepet një ndërmarrjeje UK si grant nga AKUM-i, për të mbuluar mungesat e të ardhurave si përgjigje emergjente ndaj situatës së COVID-19, në përputhje me udhëzimet për një grant të tillë që do të krijohet në kuadër të Programit.

7. "Mbulim i Drejtpërdrejtë i Kostos së Funksionimit" nënkupton raportin ndërmjet tarifave vjetore të mbledhura të ujit dhe kostos vjetore të funksionimit dhe mirëmbajtjes për çdo ndërmarrje UK, siç llogaritet nga AKUM-i bazuar në informacionin e dorëzuar nga kjo Ndërmarrje UK.

8. "Tregues i Lidhur me Disbursimin" ose "DLI" nënkupton, në lidhje me një Kategori të caktuar, treguesin që lidhet me kategorinë e përmendur, siç përcaktohet në tabelën në seksionin IV.A.2 të shtojcës 2 të kësaj Marrëveshjeje,

9. "Rezultat i lidhur me Disbursimin" ose "DLR" nënkupton një kategori të caktuar, rezultatin sipas kategorisë së përmendur siç është paraqitur në tabelën në seksionin IV.A.2 të tabelës 2 të kësaj Marrëveshjeje, në bazë të arritjes së të cilës, shuma e Huas e akorduar për rezultatin në fjalë mund të tërhiqet në përputhje me dispozitat e seksionit IV.

10. "ERRU" nënkupton Autoritetin Rregullator për Shërbimet e Ujit, të krijuar sipas ligjit nr. 8102, datë 28 mars 1996, "Për Kuadrin Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar deri më sot.

11. "Marrëveshje granti" nënkupton marrëveshjen ndërmjet Bankës që vepron si administratore e Programit Kombëtar të Modernizimit të Sektorit të Ujësjellës-Kanalizimeve në Shqipëri, Fondit të Mirëbesimit me një Donator dhe Huamarrësit, sipas së cilës Banka bie dakord t'i japë Huamarrësit një grant në shumën prej

3,000,000 dollarësh, për të ndihmuar në financimin e Projektit të përshkruar në shtojcën 1 të kësaj marrëveshjeje.

12. "Grante" nënkupton Grantet e COVID-19, Grantet e bazuara në Performancë, Grantet e Investimeve, Stimujt dhe Grantet e Investimeve të Lidhjeve të Reja, bashkërisht.

13. "Kushtet e Përgjithshme" nënkupton "Kushtet e Përgjithshme të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Financimin e IBRD-së, Financimin e Projekteve të Rezultateve", datë 14 dhjetor 2018 (të rishikuar më 1 gusht 2020, më 21 dhjetor 2020, 1 prill 2021 dhe 1 janar 2022).

14. "Stimuj" nënkupton stimuj monetarë ose jomonetarë që do të ofrohen nga AKUM për Njësitë Vendore Qendrore dhe ndërmarrjet e përzgjedhura të UK-së për të stimuluar procesin e grumbullimit, në përputhje me udhëzimet që do të përcaktohen në kuadër të Programit.

15. "Agjenci e Pavarur Verifikuese" nënkupton një agjenci të pavarur që do të angazhohet nga Huamarrësi për qëllime të certifikimit të arritjes së DLR-së, siç i referohet seksionit I.D të skedulit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

16. "Grant investimi" nënkupton një subvencion të financuar nga buxheti fiskal që do të jepet si grant nga AKUM për ndërmarrjet e UK-së për të mbështetur investimet në eficiencë dhe përmirësim të performancës, në përputhje me udhëzimet për një grant të tillë që do të vendoset në kuadër të Programit.

17. "NJQV" nënkupton "Njësi të Qeverisjes Vendore", e cila është një zonë e qeverisjes vendore, siç përcaktohet në ligjin nr. 115, 2014, "Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë".

18. "MIE" nënkupton Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë së Huamarrësit ose çdo pasues të saj.

19. "Rezultat i Përmbledhur Kombëtar për Mbulimin e Drejtpërdrejtë të Kostos së Funksionimit" nënkupton pikën e ponderuar (bazuar në numrin e lidhjeve të ujit për ndërmarrje UK) të Mbulimit të Drejtpërdrejtë të Kostos së Funksionimit për të gjitha Ndërmarrjet e UK-së në Shqipëri.

20. "Grante Investimi për Lidhje të Reja" nënkupton subvencione të financuara nga buxheti fiskal që do të ofrohen si grant nga AKUM-i për ndërmarrjet e UK-së për të mbështetur investimet për lidhjet e reja të furnizimit me ujë në zonat e pafurnizuara periurbane dhe rurale, në përputhje me udhëzimet për një grant të tillë që do të përcaktohen në kuadër të Programit.

21. "NJKP" nënkupton njësinë e përcaktuar në shtojcën 2, seksioni I.A.2 të kësaj Marrëveshjeje.

22. "Marrëveshje e Performancës" nënkupton marrëveshjen e përcaktuar në shtojcën 2, seksioni I.B të kësaj Marrëveshjeje.

23. "Grant i Bazuar në Performancë" nënkupton një subvencion të financuar nga buxheti fiskal që do të jepet si grant nga AKUM-i për një ndërmarrje UK për të mbuluar të ardhurat nga shpenzimet operacionale, në përputhje me udhëzimet për një grant të tillë që do të përcaktohen në kuadër të Programit.

24. "NJMP" nënkupton njësinë e përcaktuar në seksionin I.A.l të skedulit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

25. "Plan i Veprimit të Programit" nënkupton planin e Huamarrësit të datës 3 shkurt 2022 që do të përfshihet si shtojcë e POM-së dhe referohet në seksionin I.E të skedulit 2 të kësaj Marrëveshjeje, siç mund të ndryshohet herë pas here me marrëveshjen e Bankës.

26. "Ent Zbatues i Programit" nënkupton AKUM-në.

27. "POM" nënkupton Manualin e Operacionit të Programit të përmendur në seksionin I.C të skedulit 2 të kësaj Marrëveshjeje.

28. "Datë e nënshkrimit" nënkupton datën më të vonë nga dy datat kur Huamarrësi dhe Banka nënshkruan këtë Marrëveshje dhe një përkufizim i tillë zbatohet për të gjitha referencat për "datën e Marrëveshjes së Huas" në Kushtet e Përgjithshme.

29. "Zonë Urbane" nënkupton një qytet, siç përcaktohet në ligjin nr. 115/2014, "Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë".

30. "Protokoll verifikimi" nënkupton protokollin e Huamarrësit, të pranueshëm për Bankën, që përcakton mjetet me të cilat do të verifikohet arritja e DLR-së, sipas Programit, siç ky Protokoll Verifikimi mund të ndryshohet herë pas here me marrëveshjen paraprake me shkrim të Bankës.

31. "UK" nënkupton ujësjellës-kanalizimet.

32. "Ndërmarrjet e UK-së" nënkupton një ndërmarrje ujësjellës-kanalizimi.

DEKRET
Nr. 52, datë 6.4.2023

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 25/2023, "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për Programin Kombëtar të Modernizimit të Sektorit të Ujësjellës-Kanalizimeve në Shqipëri".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ
Nr. 26/2023

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FORCAVE SHUMËKOMBËSHE DHE VËZHGUESVE PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË SHQIPËRISË NË FORCAT SHUMËKOMBËSHE DHE VËZHGUESVE NË SINAI

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Forcave Shumëkombëshe dhe Vëzhguesve për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Shqipërisë në Forcat Shumëkombëshe dhe Vëzhguesve në Sinai sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar më datë 23.3.2023.

Shpallur me dekretin nr. 53, datë 6.4.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE FORCAVE SHUMËKOMBËSHE DHE VËZHGUESVE PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË SHQIPËRISË NË FORCAT SHUMËKOMBËSHE DHE VËZHGUESVE NË SINAI

Preambulë

Këshilli i Ministrave i Republikës të Shqipërisë (në vijim i referuar si "Shqipëria") dhe Forcat Shumëkombëshe dhe Vëzhguesve (në vijim të referuara si "FSHV"), (në vijim të referuar bashkërisht si "Palët"),

Duke marrë parasysh gatishmërinë e Shqipërisë për të ofruar personel për FSHV-në dhe për të mbështetur misionin e saj të shprehur me Traktatin e Paqes ndërmjet Egjiptit dhe Izraelit, të datës 26 mars 1979, (në vijim i referuar si Traktati) dhe protokollin e saj të datës 3 gusht 1981 (në vijim i referuar si "protokolli"),

Në bazë të ftesës së drejtorit të përgjithshëm të FSHV-së përmes përgjegjësive që i janë dhënë nga protokolli,

Kanë rënë dakord për sa vijon:

PJESA I
PËRBËRJA DHE MISIONI

1.Shqipëria do të sigurojë personel (në vijim i referuar si "personeli i caktuar") dhe pajisje, siç parashikohet këtu, për të shërbyer në FSHV. Personeli i caktuar do të vendoset në FSHV në Sinai, Republikën Arabe të Egjiptit.

2.“Personeli i caktuar” fillimisht do të përbëhet nga një oficer, komandanti i kontingjentit i cili do të shërbejë vendosje/dislokime njëvjeçare në Njësinë e Policisë Ushtarake të Forcave të FSHV-së (NJPUF) si Provost Marshall (OF4-Major) dhe dy anëtarë shtesë personeli që do të jenë të caktuar në NJPUF si Oficer Urdhri Provost (rreshter major ose oficer urdhri) dhe një Hetues (E6-Rreshter). Numri i personelit të caktuar dhe funksionet e tyre në vijim mund të rregullohen me marrëveshje të ndërsjellë. Komandanti i kontingjentit do të ketë qasje të drejtpërdrejtë me komandantin e forcës për çeshtjet operative që lidhen me pjesëmarrjen e personelit të caktuar në FSHV.

3. Përveç rasteve kur Palët bien dakord ndryshe, personeli i caktuar do të shërbejë një turne njëvjeçar, të pashoqëruar. Palët do të konsultohen dhe do të përcaktojnë reciprokisht planin e rotacionit të personelit të caktuar për të siguruar një mbivendosje të duhur të personelit me rotacion për qëllime trajnimi dhe vazhdimësie.

4. Personeli i caktuar do të dislokohet dhe do të funksionojë pasi Shqipëria të ketë përfunduar procedurat e nevojshme ligjore të brendshme për vënien në fuqi të Marrëveshjes.

PJESA II
RREGULLIMET FINANCIARE

1. Shqipëria do të marrë masa që të gjitha pagesat e pagave, shtesave dhe përfitimeve të tjera për personelin e caktuar që normalisht do t’i paguhet personelit ushtarak shqiptar kur të vendoset jashtë vendit. FSHV-ja do të paguajë Shqipërinë për personelin e caktuar me një normë standarde prej 1000 dollarë për person në muaj. Gjithashtu, ka një pagesë ditore prej 2,56 dollarë për person në ditë, e paguar drejtpërdrejt personelit të caktuar në Sinai.

2. FSHV-ja do të sigurojë, pa kosto për Republikën e Shqipërisë, ushqim, akomodim dhe mbështetje për personelin e caktuar në Sinai, brenda zonave të FSHV-ve, si dhe jashtë tyre.

3. FSHV-ja do t’i rimbursojë Republikës së Shqipërisë koston e: a) transportit të personelit të caktuar dhe bagazheve personale deri në 70 kg për personelin që shërben një turne njëvjeçar dhe deri në 45 kg për personelin që shërben një turne gjashtëmujor të detyrës me FSHV-në, me rrugën më të drejtpërdrejtë nga pika e caktuar e nisjes në stacionin e shërbimit të FSHV-së në Sinai dhe mbrapsht; dhe b) një dërgesë një herë deri në 150 kg për armët personale të personelit të caktuar, municionet dhe pajisjet e tjera të specifikuara në pjesën II, paragrafi 4 nga pika e caktuar e nisjes në stacionin e detyrës FSHV në Sinai dhe mbrapsht. Në konsultim me Ministrinë e Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, FSHV-ja do të bjerë dakord për një tarifë vjetore standarde transporti (TST) për rimbursimin e transportit të personelit të caktuar dhe bagazheve personale të lartpërmendura. Një TST do të llogaritet për çdo vit fiskal të FSHV-së (1 tetor deri më 30 shtator) dhe do të miratohet të paktën dy muaj para (jo më vonë se data 31 korrik) nga fillimi i një viti të ri fiskal të FSHV-së. TST-ja do të bazohet në një mesatare të tarifave ajrore të kuotuara (duke përfshirë taksat dhe tarifat e zbatueshme) të ofruara FSHV-së nga ofruesi i saj i kontraktuar i transportit për vajtje-ardhje, udhëtime të klasit ekonomik në transportuesit tregtarë të planifikuar rregullisht nga pika e caktuar e nisjes për në Tel Aviv, Kajro ose Sharm el Sheikh dhe kthimi për muajt prill, korrik dhe tetor. Pretendimet/pagesat për udhëtim vetëm vajtje do të bazohen në gjysmën e TST-së. Përveç rasteve kur Palët bien dakord ndryshe, pika e caktuar e nisjes/kthimit është Tirana. Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë do të konsultohet, gjithashtu, me FSHV-në në lidhje me mënyrën e transportit për dërgesën njëherëshe të përmendur këtu.

4. Shqipëria do të sigurojë dhe mirëmbajë, pa kosto për FSHV-në, armët personale, municionet, pajisjet e komunikimit për komunikimet kombëtare, uniformat, helmetën mbrojtëse dhe parzmoren e trupit, si dhe pajisjet e mjetet e tjera personale që kërkohen nga personeli i caktuar për kryerjen e misionit të tyre në FSHV. Personeli i caktuar do të jetë i armatosur me armë individuale në përputhje me ligjet dhe rregulloret kombëtare të Republikës së Shqipërisë dhe i pajisur gjatë gjithë kohës me rezerva municioni prej dy mbushjesh bazë FSHV për armë dhe një sasi shtesë trajnimi rreth gjysmës së një mbushjeje bazë FSHV për armë. Mbushja bazë FSHV është 200 fishekë për një pushkë dhe 26 fishekë për një pistoletë. Të gjitha armët personale, municionet dhe pajisjet e tjera të lartpërmendura për t’u vendosur nga Shqipëria, do të njoftohen nga Shqipëria të paktën katër javë përpara vendosjes së planifikuar në

shtabin e FSHV-së, e cila mund të vendosë kufizime për këtë vendosje/dislokim dhe që do të sigurojë dërgesa, duhet të kryhet në përputhje me rregulloret e FSHV-së dhe ligjet dhe rregulloret përkatëse të Republikës Arabe të Egjiptit.

5. Në rast nevoje në lidhje me orientimin dhe përgatitjen për vendosjen/dislokimin e parë të personelit të caktuar, FSHV-ja do të sigurojë transport, pa kosto për Republikën e Shqipërisë, për një ekip paraprak të një numri të rënë dakord të personelit shqiptar nga Tirana në Sinai dhe kthim, si dhe transportin lokal, ushqenin dhe akomodirnin brenda vendeve të FSHV-ve.

6. Shlyerja e të gjitha krediteve ose rimbursimeve nga FSHV-ja sipas kësaj pjese, përveç rasteve kur Palët bien dakord ndryshe, do të bëhet në dollarë amerikanë dhe do të bëhet mbi baza tremujore pas paraqitjes nga ose pranë FSHV-së të një fature të përgatitur në përputhje me këtë Marrëveshje. Faturat do të paraqiten brenda 30 ditëve pas përfundimit të çdo tremujori kalendarik dhe pagesa do të kryhet brenda 30 ditëve nga marrja e faturës.

7. Pa cenuar pjesën II, paragrafi 8, me paraqitjen nga Shqipëria në kanalin diplomatik të një pretendimi plotësisht të dokumentuar dhe të vërtetuar, FSHV-ja do të rimbursojë Shqipërinë për pjesën proporcionale të FSHV-së për çdo pagesë që Shqipëria kryen në përputhje me ligjet dhe rregulloret e Shqipërisë në rastin e vdekjes, lëndimit ose paaftësisë së personelit të caktuar që i atribuohet shërbimit në FSHV. Në rast se ligjet dhe rregulloret shqiptare kërkojnë pagesa periodike, FSHV-ja do të paguajë një shumë të vetme. Pjesa proporcionale sipas fjalisë së parë dhe shuma e vetme e përgjithshme sipas fjalisë së dytë do të bihen dakord nga Palët.

8. FSHV-ja do të kërkojë rimbursim në situatat që përfshijnë humbjen ose dëmtimin e pronës së FSHV-së që rezulton nga neglizhenca e rëndë ose sjellja jo e duhur e qëllimshme e personelit të caktuar. Për këtë qëllim, FSHV-ja do të informojë Shqipërinë për çdo pretendim të tillë që përfshin personelin e caktuar dhe do të sigurojë dokumentacionin e tyre. Me kërkesë të secilës palë, kurdoherë që është e nevojshme, FSHV-ja dhe Shqipëria do të zhvillojnë konsultime për ndarjen e përgjegjësisë për këto ose pretendime të tjera që mund të lindin dhe do t'i zgjidhin me marrëveshje në kanalet diplomatike.

9. Për pretendimet e mbuluara në pjesën II, paragrafi 8, FSHV-ja dhe Shqipëria do të konsultohen në mënyrë të pranueshme reciprokisht në lidhje me pagesën ose të kompensimit të kreditit.

PJESA III
ADMINISTRIMI DHE MENAXHIMI

1. Shqipëria do të kërkojë që personeli i caktuar të jetë në përputhje me direktivat, rregulloret dhe urdhrat e FSHV-ve.

2. Duke iu referuar paragrafit 6 të shtojcës së protokollit të Traktatit të Paqes, kuptohet se personeli i caktuar do të vendoset nën kontrollin operacional të Komandantit të Forcave të FSHV-së, Komandanti i Forcave të FSHV-së do t'i sigurojë komandantit të kontingjentit shqiptar urdhra të një natyre operacionale në përputhje me zinxhirin komandues të krijuar nga komandanti i Forcave të FSHV-së në zbatim të protokollit.

3. FSHV-ja do t'i sigurojë, pa kosto për Shqipërinë, personelit të caktuar kujdesin ambulator mjekësor dhe dentar rutinë (në të njëjtën masë siç i ofrohet personelit tjetër të FSHV-së), Stabilizim urgjent në objektet e trajtimit të FSHV-ve në Sinai, referim tek objektet mjekësore të nivelit më të lartë në Republikën Arabe të Egjiptit ose Izraelit (në vijim të referuara si "Shtetet Pranuese") dhe/ose rikthimin mjekësor, sipas rastit sipas rregullave dhe praktikës së FSHV-ve.

4. Shqipëria do të siguroje që personeli i caktuar të jetë i përshtatshëm nga pikëpamja mjekësore dhe dentare përpara se të dërgohet në FSHV, duke përfshirë vaksinimin kundër COVID-19, duke përdorur një vaksinë të miratuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë. Jo më vonë se gjashtë javë përpara vendosjes së personelit të parë të caktuar, FSHV-ja duhet t'i njoftojë Shqipërisë kushtet mjekësore dhe dentare që pengojnë dërgimin në FSHV dhe imunizimet që duhet të marrë personeli i caktuar përpara vendosjes/dislokimit. Një njoftim i tillë mund të përditësohet herë pas here.

5. Nëse personeli i caktuar, i cili është vendosur/dislokuar pas njoftimit të specifikuar në pjesën III, paragrafi 4 është dhënë, kërkon kujdes mjekësor ose dentar ose rikthim, për shkak të:

a) një kushti të specifikuar nga FSHV-ja në njoftimin e përmendur në pjesën III, paragrafi 4

dhe ekzistues përpara vendosjes/dislokimit të tyre; ose

b) mosmarrjes së imunizimit nga personeli i caktuar të specifikuar nga FSHV-ja në njoftimin e përmendur në pjesën III, paragrafi 4,

FSHV-ja mund të kërkojë rimbursim nga Shqipëria për kostot që lidhen me këtë kujdes mjekësor ose dentar ose kthimin.

6. FSHV-ja do të jete përgjegjëse dhe do të rimbursojë kostot e kthimit në Shqipëri të eshtrave të personelit të caktuar të ndjerë.

7. a) "Itinerari FSHV" nënkupton itinerarin më të drejtpërdrejtë nga pika e caktuar e nisjes në stacionin e detyrës FSHV në Sinai dhe, në përfundim të detyrës me FSHV-në, nga stacioni detyrës FSHV në itinerarin më të drejtpërdrejtë në pikën e caktuar të kthimit.

b) Personeli i caktuar do të konsiderohet se ka hyrë në shërbim që i atribuohet FSHV-së që nga koha kur largohen nga pika e caktuar e nisjes, me qellim të marrjes së detyrës me FSHV-në. Përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe reciprokisht, personeli i caktuar që devijon, për arsye personale ose kombëtare, zyrtare (duke përfshirë sëmundjen për shkak të çështjeve të përcaktuara në pjesën III, paragrafi 4), nga Itinerari FSHV, për aq kohë sa janë në atë devijim, nuk do të konsiderohen në shërbim që i atribuohet FSHV-së. Personeli i caktuar, udhëtimi i të cilit për të marrë detyrën në FSHV, fillon në një vend të ndryshëm nga pika e përcaktuar e nisjes, nuk do të konsiderohet se ka hyrë në shërbim që i atribuohet FSHV-së derisa të jenë raportuar për detyre tek autoritetet e FSHV-së në një nga Shtetet Pranuese.

c) Personeli i caktuar, pas kryerjes së detyrës me FSHV-në, do të ndërpresë shërbimin që i atribuohet FSHV-së në përputhje me sa vijon:

i. në lidhje me personelin e caktuar me një stacion shërbimi në vazhdim në Shqipëri, i cili udhëton drejtpërdrejt në Shqipëri, shërbimi që i atribuohet FSHV-së do të përfundojë me mbërritjen në Shqipëri;

ii. në lidhje me personelin e caktuar me një stacion në vazhdim jashtë Shqipërisë, i cili udhëton drejtpërdrejt në atë vend, shërbimi që i atribuohet FSHV-së do të përfundojë me mbërritjen në çdo pikë në atë vend;

iii. në lidhje me personelin e caktuar i cili, për arsye leverdie personale, kombëtare ose zyrtare (përfshirë sëmundjet për shkak të çështjeve të përcaktuara në pjesën III, paragrafi 5) vonon mbërritjen në vendin e stacionit të ri të detyrës, shërbimi që i atribuohet FSHV do të përfundojë me nisjen nga secili prej Shteteve Marrëse; dhe

iv. në lidhje me personelin e caktuar, i cili, për arsye leverdie personale kombëtare ose zyrtare (përfshirë sëmundjet për shkak të çështjeve të përcaktuara në pjesën III, paragrafi 5), vonon nisjen nga Shtetet Pranuese, shërbimi që i atribuohet FSHV-së do të përfundojë me nisjen nga stacioni i shërbimit të MPF-së.

d) FSHV-ja nuk do të jetë përgjegjëse për mbërritjen me vonesë në stacionin e mëtejshëm të detyrës së çdo personeli të caktuar që devijon nga itinerari i FSHV-së.

e) Çdo kosto shtesë që rezulton nga devijimet e itinerarit të FSHV-së, duke përfshirë devijimet si rezultat i një sëmundjeje për shkak të çështjeve të përcaktuara në pjesën III, paragrafi 5, do të përballohet nga Shqipëria ose individi.

8. a) Shqipëria mund t'i ofrojë personelit të caktuar, me shpenzimet e veta, lidhje të drejtpërdrejta radio ose lidhje të tjera komunikimi dhe pajisje shoqëruese. Zbatimi i vendimit për këtë qëllim do të koordinohet me komandantin e Forcave të FSHV-së. Shmangia e çdo ndërhyrjeje në komunikimet e FSFIV-ve është përgjegjësi e Shqipërisë. Frekuencat (përfshirë frekuencat satelitore) duhet të përcaktohen reciprokisht ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Arabe të Egjiptit. Dëshmia e një koordinimi të tillë duhet t'i jepet FSHV-së përpara përdorimit të çdo radioje, pajisjeje satelitore ose transmetuesi tjetër.

b) Objektet e komunikimit të FSHV-ve mund të përdoren nga Komandanti shqiptar për komunikimet me Shqipërinë që lidhen me pjesëmarrjen shqiptare, kur ky përdorim është pa kosto për FSHV-në, në bazë të hapësirës së disponueshme. Komandanti i Forcave të FSHV-së mund të autorizojë komunikime me kosto për FSHV-në në rast emergjence personale ose për arsye humanitare ose pas konsultimeve me shtabin e FSHV-së në Romë, për FSHV-në.

c) Me përjashtim të çështjeve operacionale të trajtuara në pjesën I, paragrafin 42, shtabi i FSHV-së në Romë, nëpërmjet Ambasadës së Republikës së Shqipërisë në Romë, do të jetë kanali për të gjitha komunikimet zyrtare ndërmjet FSHV-së dhe Shqipërisë.

9. a) Shqipëria mund të hyjë në marrëveshje me autoritetet postare të Shteteve Marrëse dhe/ose shteteve të tjera pjesëmarrëse për dërgesat e saj postare dhe postës së paketave drejt dhe nga personeli i caktuar.

b) Posta për personelin e caktuar mund të postohet gjithashtu nëpërmjet kanaleve të postës ushtarake të Shteteve të Bashkuara në FSHV në adresën e mëposhtme ose në një adresë tjetër që FSHV-ja mund t'i njoftojë Shqipërisë me shkrim herë pas here:

Emri [në tekstin latin]
FSHV Kampi Jugor/Kontingjenti shqiptar
Njësia 31530
APO AE 09804

c) Posta e adresuar rregullisht personelit të caktuar dhe e marrë në adresën e mësipërme do të transportohet nga FSHV-ja tek komandanti i kontingjentit shqiptar, ose i caktuari i tij/saj, në Sinai. Për letrat dhe pakot dalëse, tarifat postare në SHBA shiten në Kampin Jugor.

10. Kërkesat zyrtare të kontingjentit për mallra ose shërbime nga burimet e shtetit pranues, edhe nëse bëhen me shpenzimet e personelit të caktuar, do të prokurohen përmes kanaleve të prokurimit të FSHV-ve, përveç rasteve kur mund të përcaktohet më parë reciprokisht.

11.Në masën që është e mundur dhe në përputhje me ligjet dhe rregulloret shqiptare, komandanti i kontingjentit shqiptar do të ndihmojë FSHV-në në çdo hetim të çdo akti që i shkakton humbje FSHV-së, përfshirë dëmtimin e pajisjeve, automjeteve ose pronës tjetër në pronësi të FSHV-së që rezulton nga shkeljet e ligjeve dhe rregulloreve të Shqipërisë ose rregulloreve apo urdhrave të FSHV-ve; ky asistim mund të përfshijë, kur është e përshtatshme, veprime për të disiplinuar personelin në fjalë dhe për të garantuar kthimin e FSHV-së duke rikuperuar koston e një humbjeje ose dëmi të tillë nga personeli në fjalë.

12. Kurdoherë që Shqipëria heton ndonjë personel të caktuar sipas ligjeve dhe rregulloreve të Shqipërisë kur supozohet se ka shkaktuar dëme në lidhje me pronën e FSHV-së, Shqipëria do të japë informacion mbi zgjidhjen e çdo rasti të tillë me kërkesë të FSHV-së.

13. Shqipëria ka të drejtë të kryejë hetime aksidentale, disiplinore ose hetime të tjera në lidhje me ngjarje që lidhen me personelin e caktuar ose pronën e tyre në përputhje me ligjet dhe rregulloret e Shqipërisë. Këto hetime do të koordinohen me çdo hetim paralel të FSHV-ve. FSHV-ja do të asistojë Shqipërinë në kryerjen e hetimeve.

14. Personeli i caktuar do të kthehet, me kërkesë të Shqipërisë, përpara përfundimit të turneut të detyrës. Në këtë rast, FSHV-ja mund të kërkojë që të sigurohet në kohë një zëvendësim përshtatshëm, në mënyrë që të ndodhë mbivendosja ndërmjet largimit të personelit të caktuar të kthyer dhe mbërritjes së personelit të ri të caktuar. Shqipëria pranon se ky rast duhet të ndodhë vetëm në rrethana të jashtëzakonshme dhe do ta shqyrtojë me kujdes një kërkesë të tillë për zëvendësim.

15. Kthimi i personelit të caktuar në Shqipëri për arsye disiplinore nga Komandanti i Forcave të FSHV-së do të koordinohet me drejtorin e përgjithshëm. Shqipëria do të marrë masat e duhura për të siguruar disponueshmërinë e këtij personeli të caktuar në lidhje me çdo hetim apo procedim ligjor.

16. Në përputhje me paragrafin 11(c) të shtojcës së protokollit të Traktatit të Paqes, Shqipëria do të marrë masat e nevojshme për të garantuar disiplinën e duhur të personelit të saj të caktuar dhe për të ushtruar juridiksion në lidhje me çdo krim ose shkelje që mund të kryhet nga personeli i saj i caktuar. Shqipëria do të njoftojë FSHV-në për kushtet e çdo marrëveshjeje plotësuese me një shtet marrës në përputhje me paragrafin 11(d) të shtojcës së protokollit të Traktatit të Paqes.

17. Në rast kthimi të çdo personeli të caktuar në Shqipëri për arsye disiplinore ose administrative shqiptare, FSHV-ja mund të kërkojë rimbursim ose kompensim krediti nga Shqipëria për kostot që lidhen me kthimin.

PJESA IV
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

1. Kjo Marrëveshje mund të plotësohet ose ndryshohet në çdo kohë me marrëveshje të ndërsjellë të Palëve.

2. Palët synojnë të ndërmarrin hapat e duhur të mëtejshëm, në përputhje me ligjin shqiptar, për të zbatuar privilegjet dhe imunitetet e organizatës ndërkombëtare që i janë dhënë FSHV-së nga protokolli i Traktatit të Paqes në Republikën e Shqipërisë.

3. Çdo dallim ndërmjet Palëve në lidhje me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet me negociata ndërmjet Palëve.

4. Shqipëria është e ndërgjegjshëm për rëndësinë e vazhdimësisë së shërbimit në njësitë me FSHV. Rrjedhimisht, personeli i caktuar nuk do të tërhiqet pa njoftim të duhur paraprak për drejtorin e përgjithshëm të FSHV-së që do të konsiderohet në përputhje me dispozitat e mëposhtme për kohëzgjatjen dhe përfundimin. Kjo Marrëveshje do të vazhdojë në fuqi për një vit (përveç rastit kur Shqipëria dhe FSHV-ja bien dakord reciprokisht për të zgjatur këtë Marrëveshje), Shqipëria jep një njoftim me shkrim për gjashtë muaj mbi synimin e saj për t'u tërhequr nga kjo Marrëveshje, ose deri në momentin kur qeveritë e Izraelit dhe Egjiptit mund të bien dakord reciprokisht për të përfunduar turneun e FSHV-së.

5. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e marrjes nga FSHV-ja të njoftimit nga Shqipëria se Shqipëria ka përfunduar procedurat e nevojshme të brendshme ligjore për vënien në fuqi të Marrëveshjes.

6. Kjo Marrëveshje është nënshkruar në Tiranë, më datë 8 nëntor 2022, në katër kopje origjinale, dy në gjuhën shqipe dhe dy në gjuhën anglisht, ku të gjitha tekstet janë njëlloj autentike. Në rast të mospërputhjes në interpretim, teksti në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

NË EMËR TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE
TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Nënshkrimi:
Emri:

NË EMËR TË FORCAVE SHUMËKOMBËSHE
DHE VËZHGUESVE
Nënshkrimi:
Emri:

DEKRET
Nr. 53, datë 6.4.2023

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 26/2023, "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Forcave Shumëkombëshe dhe Vëzhguesve për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Shqipërisë në Forcat Shumëkombëshe dhe Vëzhguesve në Sinai".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ
Nr. 27/2023

PËR KONTROLLIN E TREGTIMIT TË PRODUKTEVE QË MUND TË PËRDOREN PËR DËNIME ME VDEKJE, TORTURË OSE DËNIME APO TRAJTIME MIZORE, ÇNJERËZORE OSE POSHTËRUESE[2]

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky ligj përcakton rregullat dhe procedurat për kontrollin e tregtimit të produkteve që mund të përdoren për dënime me vdekje, torturë ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, si dhe ofrimin e shërbimeve të ndërmjetësimit, ndihmës teknike, trajnimin dhe reklamën në lidhje me produkte të tilla.

[2] *Ky ligj është përafruar pjesërisht me rregulloren (BE) 2019/125 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 16 janar 2019, "Për tregtinë e mallrave të caktuara, të cilat mund të përdoren për dënim me vdekje, torturë apo trajtime ose dënime të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese", të ndryshuar. Numri CELEX 32019R0125, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 30, datë 31.1.2019, f. 1–57.*

Neni 2
Përkufizimet

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Autoritet i zbatimit të ligjit" është çdo autoritet përgjegjës për parandalimin, zbulimin, hetimin, luftimin dhe ndëshkimin e veprave penale, duke përfshirë, por pa u kufizuar në policinë, prokurorinë, çdo autoritet gjyqësor, çdo institucion të ekzekutimit të vendimeve penale dhe, kur është e përshtatshme, institucionet shtetërore dhe autoritetet ushtarake.

2. "Autoriteti përgjegjës" është Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE), si struktura shtetërore përgjegjëse për lëshimin e autorizimeve të përcaktuara në pikat 3, 4 dhe 5 të këtij neni, për eksportin, importin, tranzitin, ofrimin e ndihmës teknike dhe veprimtari ndërmjetësuese.

3. "Autorizim global" është autorizimi i lëshuar nga autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve për një eksportues ose ndërmjetësues të veçantë në lidhje me një produkt apo një kategori të caktuar të produkteve të kontrolluara, i cili është i vlefshëm për:

a) eksportet te një ose më shumë përdorues të fundit të specifikuar dhe/ose në një ose më shumë vende të huaja të specifikuara;

b) eksportet në një ose më shumë shpërndarës të posaçëm, në një ose më shumë vende të huaja të specifikuara, ku eksportuesi është një prodhues i mallrave;

c) furnizimin e shërbimeve të ndërmjetësimit në lidhje me transferimet e mallrave që ndodhen në një vend të huaj te një ose më shumë përdorues të caktuar në një ose më shumë vende të huaja;

ç) furnizimin e shërbimeve të ndërmjetësimit në lidhje me transferimet e mallrave që ndodhen në një vend të huaj, në një ose më shumë shpërndarës të posaçëm në një ose më shumë vende të huaja, ku ndërmjetësi është një prodhues i mallrave.

4. "Autorizim i përgjithshëm" është autorizimi i lëshuar nga autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve për një kategori të caktuar mallrash për të kryer një eksport, sipas përkufizimeve të pikës 6 të këtij neni, drejt disa vendeve të huaja të miratuara, i cili jepet për të gjitha subjektet që respektojnë kushtet dhe kërkesat për përdorim, të përcaktuara në autorizimin e përgjithshëm.

5. "Autorizim individual" është një autorizim i dhënë për:

a) një eksportues të posaçëm për te një përdorues fundor ose marrës në një vend të huaj dhe që mbulon një ose më shumë mallra;

b) një ndërmjetës të posaçëm për furnizimin e shërbimeve të ndërmjetësimit për një përdorues fundor ose marrës në një vend të huaj dhe që mbulon një ose më shumë mallra;

c) një person fizik ose juridik, entitet ose organ që transporton mallra brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë për kalim të përkohshëm tranzit.

6. "Eksport" është një procedurë eksporti në kuptim të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë, pa përfshirë mallrat në tranzit.

7. "Eksportues" është çdo person fizik ose juridik ose një bashkim i tyre, në emër të të cilit paraqitet deklarata doganore e eksportit, ose personi që, në kohën kur pranohet deklarata, ka kontratën me marrësin e ngarkesës në vendin e huaj dhe ka autoritetin që të vendosë për dërgimin e mallit jashtë territorit doganor të Shqipërisë.

8. "Import" është një procedurë importi në kuptim të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë.

9. "Importues" është personi fizik apo juridik i vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë, në emër të të cilit bëhet një deklaratë importi, ose një person që në kohën e dhënies së autorizimit ka nënshkruar kontratë me marrësin e mallrave brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

10. "Kërkues" do të thotë:

a) eksportuesi/importuesi në rastin e eksporteve/importeve;

b) personi fizik ose juridik, që transporton mallrat brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, në rastin e kalimit tranzit;

c) ofruesi i ndihmës teknike në rastin e ofrimeve të ndihmës teknike;

ç) muzeu që do të ekspozojë mallrat, në rastin e importeve dhe ofrimeve të ndihmës teknike;

d) ndërmjetësi, në rastin e shërbimeve të ndërmjetësimit.

11. "Lista e mallrave të kontrolluara" është një listë e ndarë në tri kategori si më poshtë:

- Kategoria 1: mallra të cilat nuk kanë përdorim tjetër, përveç qëllimit të dënimit me vdekje, ose për qëllime torture ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese;

- Kategoria 2: mallra që mund të përdoren për qëllime torture apo trajtime të tjera apo ndëshkime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese;

- Kategoria 3: mallra që mund të përdoren për qëllim të dënimit me vdekje.

12. "Muze" është institucioni i ruajtjes së kujtesës, në shërbim të shoqërisë dhe zhvillimit të saj, i hapur për publikun, që konservon, studion, komunikon dhe prezanton trashëgiminë e luajtshme e të paluajtshme të njerëzimit dhe mjedisit rrethues të tij, me qëllim edukimin, studimin, promovimin dhe argëtimin.

13. "Objekt muzeor" është një pasuri e luajtshme, që, pas hulumtimeve dhe vlerësimit, njihet si një objekt me rëndësi kulturore e historike, që ruhet, mbrohet, administrohet dhe vlerësohet në një muze.

14. "Produkt për arsye muzeore" ka të njëjtin kuptim sipas përcaktimit për objektin muzeor.

15. "Ndërmjetësues" është çdo person fizik, shtetas shqiptar, i cili ofron shërbimin për lidhje të dy ose më shumë palëve për përfundimin e një marrëveshjeje, pa qenë i lidhur me asnjërin prej tyre në marrëdhënie bashkëpunimi, varësie ose përfaqësimi nga brenda Shqipërisë; çdo person fizik ose juridik, apo organ, duke përfshirë dhe një bashkim të tyre, që është rezident ose i vendosur në Shqipëri dhe që ofron këtë lloj ndihme nga brenda Shqipërisë; çdo person fizik ose juridik ose organ i regjistruar ose i krijuar sipas legjislacionit shqiptar, pavarësisht se ku është i vendosur, që ofron shërbime të tilla nga Shqipëria.

16. "Ndihmë teknike" është çdo mbështetje teknike në lidhje me riparimet, zhvillimin, prodhimin, testimin, mirëmbajtjen, montimin ose ndonjë shërbim tjetër teknik dhe mund të marrë forma të tilla, si: udhëzime, këshilla, trajnime, transmetim të njohurive të punës ose aftësive ose këshillime. Ndihma teknike përfshin forma verbale të ndihmës dhe ndihmës së siguruar me mjete elektronike.

17. "Ofrues i ndihmës teknike" është çdo shtetas shqiptar, pavarësisht se ku është rezident, i cili ofron këtë lloj ndihme nga brenda Shqipërisë; çdo person fizik ose juridik, ose organ, duke përfshirë një bashkim të tyre, që është rezident ose i vendosur në Shqipëri dhe që ofron këtë lloj ndihme nga brenda Shqipërisë; çdo person fizik ose juridik ose organ i regjistruar ose i krijuar sipas legjislacionit shqiptar, pavarësisht se ku është i vendosur, që ofron shërbime të tilla nga Shqipëria dhe që ofron ndihmën teknike për mallrat e përcaktuara në pikën 12 të këtij neni.

18. "Organ" në kuptim të këtij ligji do të konsiderohen organet publike sipas përkufizimit të dhënë në Kodin e Procedurave Administrative.

19. "Person fizik" në kuptim të këtij ligji është një person i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe i pajisur me numër unik të identifikimit të subjektit.

20. "Rieksport" është procedurë rieksporti në kuptim të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë, pa përfshirë mallrat në regjimin e tranzitit.

21. "Shpërndarës" është një person fizik ose juridik, që kryen tregti me shumicë në lidhje me mallrat e kategorive 2 dhe 3, duke i prokuruar këto mallra nga prodhuesi ose duke furnizuar apo eksportuar këto mallra. Tregtia kuptohet si blerja e mallrave nga prodhuesi ose mbajtja, ofrimi apo eksportimi i këtyre mallrave, përveç prokurimit të mallrave nga ana e institucioneve të kujdesit shëndetësor.

22. "Torturë" është çdo veprim me dashje, me anën e të cilit i shkaktohet një personi dhimbje ose vuajtje të rënda fizike a mendore, me qëllimin që nga ky person apo nga një i tretë të përftohen informacione apo një rrëfim, duke ndëshkuar atë person për një veprim që ai person ose një i tretë ka kryer ose dyshohet ta ketë kryer apo kërcënimi ose ushtrimi i presionit ndaj atij personi ose një të treti për çfarëdolloj arsyeje të bazuar në çfarëdolloj diskriminimi, kur kjo dhimbje ose vuajtje shkaktohet nga ose me nxitjen, pëlqimin apo miratimin e heshtur të një punonjësi publik apo të një personi tjetër që ushtron një funksion zyrtar. Në këtë përkufizim nuk përfshihet dhimbja ose vuajtja e shkaktuar vetëm nga sanksione ekzistuese të ligjshme ose aksidentale.

23. "Trajtime ose ndëshkime mizore, çnjerëzore apo poshtëruese" është çdo veprim nëpërmjet të cilit i shkaktohet një personi dhimbje apo vuajtje fizike a mendore të një niveli minimal, kur kjo dhimbje a vuajtje shkaktohet nga ose me nxitjen, pëlqimin apo miratimin e heshtur të një punonjësi publik apo të një personi tjetër që ushtron një

funksion zyrtar. Në këtë përkufizim nuk përfshihet dhimbja ose vuajtja e shkaktuar vetëm nga sanksione ekzistuese të ligjshme ose aksidentale.

24. "Tranzit" është procedura në kuptim të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë dhe dispozitave zbatuese të Kodit Doganor.

25. "Tregtim" në kuptim të këtij ligji do të jetë eksporti, importi, tranziti i produkteve që mund të përdoren për dënime me vdekje, torturë ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese.

26. "Veprimtari ndërmjetësimi" është:

a) negocimi apo organizimi i transaksioneve për blerjen, shitjen ose ofrimin e mallrave të kontrolluara nga një vend i huaj, në cilindo vend tjetër të huaj;

b) blerja, shitja apo organizimi i transferimeve të mallrave të kontrolluara që ndodhen në një vend të huaj drejt një vendi tjetër të huaj.

Në kuptim të këtij ligji, shërbimet ndihmëse, ku përfshihen transporti, shërbimet financiare, sigurimi, risigurimi dhe reklamimi i përgjithshëm ose promovimi nuk konsiderohen veprimtari ndërmjetësimi.

27. "Territori doganor" është territori tokësor, ujërat territoriale, ujërat e brendshme dhe hapësira ajrore e Republikës së Shqipërisë.

KREU II
KONTROLLI MBI MALLRAT TË CILAT NUK KANË PËRDORIM TJETËR PËRVEÇSE PËR QËLLIME TË DËNIMIT ME VDEKJE, TORTURËS DHE DËNIMEVE APO TRAJTIMIT MIZORE, ÇNJERËZORE OSE POSHTËRUESE

Neni 3
Ndalimi i eksportit

1. Ndalohet eksporti i produkteve, të cilat nuk kanë përdorim tjetër përveç qëllimit të dënimit me vdekje, torturës dhe dënimeve apo trajtimeve mizore, çnjerëzore ose poshtëruese.

2. Ndalohet ofrimi i ndihmës teknike në lidhje me produktet, të cilat nuk kanë përdorim tjetër përveçse mund të përdoren për dënime me vdekje, torturë ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, qoftë edhe pa pagesë, ndaj çdo personi, subjekti apo organi të një vendi të huaj.

3. Përjashtim bëjnë rastet kur përdorimi i këtyre produkteve do të jetë për arsye muzeore.

4. Për rastet e përmendura në pikën 3 të këtij neni, subjektet do të autorizohen për të eksportuar këto produkte dhe ofrimin e ndihmës teknike përkatëse nga ana e autoritetit përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve, nëse kërkuesi paraqet deklaratë me shkrim që sendi është jofunksional dhe konfirmimin që këto mallra do të përdoren ekskluzivisht për t'u shfaqur nga muzeu në të cilin do të ekspozohet.

5. Lista e produkteve, të cilat nuk kanë përdorim tjetër përveç qëllimit të dënimit me vdekje, torturës ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Kjo listë përditësohet çdo herë në përputhje me listat më të fundit që miraton Bashkimi Evropian

Neni 4
Ndalimi i importit

1. Ndalohet importi i produkteve, të cilat nuk kanë përdorim tjetër përveç qëllimit të dënimit me vdekje, torturës ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese.

2. Ndalohet çdo person fizik ose juridik apo organ në Republikën e Shqipërisë të pranojë ndihmë teknike, qoftë edhe pa pagesë, që ofrohet nga një person, subjekt apo organ në një vend të huaj për mallrat e rregulluara nga ky kre.

3. Përjashtim bëjnë rastet kur përdorimi i këtyre produkteve do të jetë për arsye muzeore.

4. Për rastet e përmendura në pikën 3 të këtij neni, subjektet do të autorizohen për të importuar këto produkte dhe ofrimin e ndihmës teknike përkatëse nga ana e autoritetit përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve, nëse kërkuesi paraqet deklaratë me shkrim që sendi është jofunksional dhe konfirmimin që këto mallra do të përdoren ekskluzivisht për t'u shfaqur nga muzeu në të cilin do të ekspozohet.

Neni 5
Ndalimi i tranzitit

1. Ndalohet kalimi tranzit i produkteve, të cilat nuk kanë përdorim tjetër përveç qëllimit të dënimit me vdekje, torturës ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, përmes

territorit doganor të Republikës së Shqipërisë në territorin e një vendi të huaj.

2. Përjashtim bëjnë rastet kur përdorimi i këtyre produkteve do të jetë për arsye muzeore.

3. Për rastet e përmendura në pikën 2 të këtij neni, subjektet do të autorizohen për të tranzituar nga ana e autoritetit përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve, nëse kërkuesi provon se mallrat në vendin e destinacionit do të përdoren ekskluzivisht për t'u shfaqur në muze.

Neni 6
Ndalimi i ofrimit të shërbimeve të ndërmjetësimit

Ndalohet sigurimi i shërbimeve të ndërmjetësimit ndaj çdo personi, subjekti, ose organi të një vendi të huaj për mallrat, të cilat nuk kanë përdorim tjetër përveç dënimit me vdekje, torturës ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, pavarësisht nga origjina e këtyre mallrave.

Neni 7
Ndalimi i ofrimit të ndihmës teknike

Ndalohet ofrimi i ndihmës teknike ose ofrimi i trajnimit ndaj çdo personi, subjekti ose organi të një vendi të huaj për përdorimin e mallrave, të cilat nuk kanë qëllim tjetër, përveç përdorimit për dënime me vdekje, torturës ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese.

Neni 8
Ndalimi i reklamimit dhe shfaqjes së mallrave në panaire

1. Ndalohet shitja ose blerja e hapësirës së reklamimit apo kohës së reklamimit në Republikën e Shqipërisë për çdo individ, person fizik ose juridik, apo organ, duke përfshirë një bashkim ndërmjet tyre, që është rezident apo i themeluar në Republikën e Shqipërisë, për çdo shtetas shqiptar që shet ose blen hapësirë reklamimi ose kohë reklamimi brenda Republikës së Shqipërisë, dhe për çdo person fizik ose juridik apo organ të themeluar apo të krijuar sipas legjislacionit shqiptar, që shet ose blen hapësirë reklamimi ose kohë reklamimi brenda Republikës së Shqipërisë, për t'i shitur ose blerë, çdo personi, subjekti ose organi të një vendi të huaj, hapësirë reklamimi në medien e shkruar ose në internet ose kohë reklamimi në televizion ose radio për mallrat, të cilat nuk kanë përdorim tjetër përveçse të përdorimit për dënime me vdekje, torturë ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese.

2. Ndalohen të ekspozohen apo të ofrohen për shitje, në një ekspozitë apo panair që zhvillohet në Shqipëri, mallra të cilat nuk kanë përdorim tjetër përveçse përdorimit për dënime me vdekje, torturë ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, nga çdo individ, person fizik ose juridik, apo organ, duke përfshirë një bashkim ndërmjet tyre, që është rezident ose i themeluar apo jo në Shqipëri, përveçse nëse kërkuesi vërteton pranë autoritetit përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve se, duke pasur parasysh natyrën e ekspozitës ose panairit, kjo ekspozitë apo oferta për shitje nuk është e rëndësishme dhe nuk promovon shitjen apo furnizimin e këtyre mallrave tek asnjë person, subjekt apo organ në një vend të huaj.

KREU III
KONTROLLI I MALLRAVE QË MUND TË PËRDOREN PËR QËLLIME TORTURE APO NDËSHKIME MIZORE, ÇNJERËZORE OSE POSHTËRUESE

Neni 9
Autorizimi individual ose global i eksportit

1. Për çdo eksport të mallrave, që mund të përdoren për qëllime torture apo ndëshkime mizore, çnjerëzore apo poshtëruese, është i nevojshëm një autorizim, ku përfshihen:

a) mallrat që përdoren për qëllimet e autoriteteve të zbatimit të ligjit;

b) mallrat që, duke pasur parasysh dizajnin dhe tiparet teknike, paraqesin një rrezik material për t'u përdorur për torturë dhe trajtime ose dënime mizore, çnjerëzore apo poshtëruese.

2. Nuk kërkohet autorizim në rastet e kalimit tranzit përmes territorit doganor të Republikës së Shqipërisë të mallrave që mund të përdoren për qëllime torture apo ndëshkime mizore, çnjerëzore apo poshtëruese.

3. Përjashtohen nga rregullimet e këtij neni mallrat e mëposhtme:

a) armët e zjarrit të kontrolluara sipas legjislacionit në fuqi;

b) artikujt me përdorim të dyfishtë të kontrolluar sipas legjislacionit në fuqi;

c) mallrat ushtarake të kontrolluara sipas legjislacionit në fuqi.

4. Pika 1 e këtij neni nuk zbatohet për eksportet në vendet e huaja, me kusht që mallrat të përdoren nga personeli ushtarak ose civil i Republikës së Shqipërisë, nëse një personel i tillë merr pjesë në një mision ushtarak, operacion paqeruajtës ose menaxhim emergjencash. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe autoritetet e tjera përkatëse kanë të drejtë të verifikojnë nëse ky kusht është përmbushur. Eksporti nuk do të bëhet deri në pritje të një verifikimi të tillë.

5. Lista e mallrave, që mund të përdoren për qëllime torture ose ndëshkime mizore, çnjerëzore apo poshtëruese, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Kjo listë përditësohet çdo herë në përputhje me listat më të fundit që miraton Bashkimi Evropian.

Neni 10

Kushtet për dhënien e autorizimeve individuale dhe globale për eksport

1. Vendimi për kërkesat për autorizimet lidhur me eksportin e mallrave sipas nenit 9 të këtij ligji, merret nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve pas marrjes së mendimit të organeve të tjera shtetërore, sipas fushës së kompetencës, të cilat marrin në konsideratë të gjitha rrethanat dhe, në veçanti, përdorimin përfundimtar të synuar dhe nëse ka rrezik devijimi nga ky përdorim.

2. Autoriteti kompetent nuk jep asnjë autorizim kur ka baza të arsyeshme për të besuar se mallrat e përcaktuara në nenin 9 të këtij ligji, mund të përdoren nga një autoritet ligjzbatues apo nga një person fizik ose juridik në një vend të huaj për torturë dhe trajtime ose dënime të tjera mizore, çnjerëzore apo poshtëruese, përfshirë këtu ndëshkimin trupor me vendim gjyqësor.

3. Për vlerësimin e eksportit, autoriteti kompetent merr në konsideratë:

a) vendimet gjyqësore të dhëna nga gjykata ndërkombëtare;

b) rezultatet e vlerësimeve të organeve kompetente të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian, raportet e Komitetit Evropian, të Këshillit të Evropës për Ndalimin e Torturës dhe Trajtimeve ose Dënimeve Mizore, Çnjerëzore apo Poshtëruese dhe të Raportuesit Special të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për torturën dhe trajtimet ose dënimet e tjera mizore, çnjerëzore apo poshtëruese.

c) informacione të tjera të rëndësishme, si vendimet gjyqësore ndërkombëtare të disponueshme ose publike, raportimet dhe informacionet e tjera të përgatitura nga organizatat e shoqërisë civile dhe informacioni mbi kufizimet për eksportin e mallrave sipas krerëve I dhe II, që aplikohen drejt vendit të destinacionit.

4. Kur prodhuesi i mallrave të parashikuara nga neni 9 i këtij ligji, kërkon një autorizim për eksportin e këtyre mallrave drejt një shpërndarësi, autoriteti kompetent bën një vlerësim të marrëveshjeve kontraktuale midis prodhuesit dhe shpërndarësit, si dhe të masave të marra prej tyre për të garantuar që këto mallra ose, sipas rastit, produktet ku ato do të inkorporohen, nuk përdoren për torturë dhe trajtime ose dënime mizore, çnjerëzore apo poshtëruese.

5. Kur për eksportin e mallrave të parashikuara nga neni 9 i këtij ligji, drejt një përdoruesi fundor kërkohet një autorizim, autoriteti kompetent kërkon deklaratën e përdorimit fundor të nënshkruar nga përdoruesi fundor.

6. Përveç kushteve të përcaktuara në këtë nen, gjatë vlerësimit të një kërkese për autorizim global, autoriteti përgjegjës merr në konsideratë zbatimin nga eksportuesi të mjeteve dhe procedurave që garantojnë pajtueshmërinë me dispozitat dhe objektivat e këtij ligji dhe me kushtet e autorizimit.

Neni 11

Ndalimi i tranzitit

Ndalohet që një individ, person fizik ose juridik apo organ, përfshirë këtu një bashkim të tyre, qoftë rezident ose i themeluar në Shqipëri apo jo, të kalojë tranzit mallrat e parashikuara nga neni 9 i këtij ligji, që mund të përdoren për qëllime torture, trajtime ose ndëshkime mizore, çnjerëzore apo poshtëruese, nëse ky individ, person fizik ose juridik apo organ ka dijeni se një pjesë e dërgesës së këtyre mallrave ose e gjitha është e synuar për përdorimin për torturë dhe trajtime ose dënime mizore, çnjerëzore apo poshtëruese në një vend të huaj.

Neni 12
Autorizim individual ose global për disa shërbime

1. Kërkohet autorizim për çdo shërbim nga një ofrues i ndihmës teknike apo ndërmjetës, pavarësisht origjinës së këtyre mallrave, në favor të një personi, subjekti apo organi në një vend të huaj, pavarësisht nëse ofrohen ose jo me pagesë, për secilin nga shërbimet e mëposhtme:

a) ndihmë teknike lidhur me të gjitha mallrat e parashikuara nga ky kre, pavarësisht nga origjina e tyre;

b) shërbime ndërmjetësimi lidhur me të gjitha mallrat e parashikuara nga ky kre, pavarësisht nga origjina e tyre.

2. Në marrjen e vendimit për kërkesat për autorizim për ofrimin e ndihmës teknike zbatohen kushtet e përcaktuara në pikat 3, 4, 5 dhe 6 të nenit 10 të këtij ligji, për të vlerësuar nëse:

a) ndihma teknike i jepet një personi ose subjekti që mund t'i përdorë mallrat për të cilat jepet ndihma teknike për torturë dhe trajtime ose dënime mizore, çnjerëzore apo poshtëruese;

b) ndihma teknike do të përdoret për riparimin, zhvillimin, prodhimin, testimin, mirëmbajtjen apo montimin e mallrave të destinuara për një person, subjekt apo organ me qëllim që këtyre të fundit t'u jepet ndihma teknike për mallrat që mund të përdoren për torturë dhe trajtime ose dënime mizore, çnjerëzore apo poshtëruese.

3. Pika 1 e këtij neni nuk zbatohet për ofrimin e ndihmës teknike, nëse ndihma teknike:

a) i jepet në kuadër të parashikimeve të pikës 4 të nenit 9 të këtij ligji;

b) konsiston në dhënien e informacionit që është publik;

c) është minimumi i nevojshëm për instalimin, funksionimin, mirëmbajtjen apo riparimin e mallrave, eksporti i të cilave është autorizuar nga një autoritet kompetent në përputhje me këtë ligj.

4. Një autorizim për eksport për ndihmë teknike nënkupton një autorizim për eksportuesin për të furnizuar me ndihmë teknike përdoruesin përfundimtar në masën që ndihma e tillë është e nevojshme për instalimin, funksionimin, mirëmbajtjen ose riparimin e atyre mallrave, eksporti i të cilave është i autorizuar.

KREU IV
MALLRAT QË MUND TË PËRDOREN PËR DËNIMIN ME VDEKJE

Neni 13
Autorizimi individual ose global për eksport dhe tranzitim

1. Kërkohet një autorizim për çdo eksport të mallrave që mund të përdoren për dënimin me vdekje, ku përfshihen ato mallra që janë miratuar apo përdoren aktualisht për dënimin me vdekje nga një ose më shumë vende, të cilat nuk e kanë shfuqizuar këtë lloj dënimi.

2. Nuk kërkohet autorizim në rastet e kalimit tranzit përmes territorit doganor të Republikës së Shqipërisë të mallrave që mund të përdoren për dënimin me vdekje.

3. Përjashtohen nga rregullimet e këtij neni mallrat e mëposhtme:

a) armët e zjarrit, të kontrolluara sipas legjislacionit në fuqi;

b) artikujt me përdorim të dyfishtë, të kontrolluara sipas legjislacionit në fuqi;

c) mallrat ushtarake, të kontrolluara sipas legjislacionit në fuqi.

4. Kur në zbatim të këtij ligji, eksporti i produkteve mjekësore kërkon një autorizim, ky eksport u nënshtrohet gjithashtu edhe kërkesave për licencim/autorizim në përputhje me legjislacionin vendas për kontrollin e lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope.

5. Përveç kushteve të përcaktuara në këtë nen, gjatë vlerësimit të një kërkese për autorizim global, autoriteti kompetent merr në konsideratë zbatimin nga eksportuesi/tranzituesi të mjeteve dhe procedurave që garantojnë pajtueshmërinë me dispozitat dhe objektivat e këtij ligji dhe me kushtet e autorizimit.

6. Lista e mallrave, që mund të përdoren për dënimin me vdekje, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Kjo listë përditësohet çdo herë në përputhje me listat më të fundit që miraton Bashkimi Evropian.

Neni 14
Kushtet për dhënien e autorizimeve individuale ose globale për eksport

1. Vendimi mbi kërkesat për autorizime lidhur me eksportin e mallrave, të përcaktuara në nenin 13 të këtij ligji, merret nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve pas marrjes së mendimit të organeve të tjera shtetërore, sipas fushës së kompetencës, të cilat marrin në konsideratë të gjitha rrethanat përkatëse, në veçanti përdorimin përfundimtar të synuar dhe nëse ka rrezik devijimi nga ky përdorim.

2. Autoriteti kompetent nuk jep asnjë autorizim kur ka baza të arsyeshme për të besuar se mallrat mund të përdoren për dënimin me vdekje në një vend të huaj.

3. Kur prodhuesi i mallrave, të parashikuara në nenin 13 të këtij ligji, kërkon një autorizim për eksportin e këtyre mallrave drejt një shpërndarësi, autoriteti kompetent bën një vlerësim të marrëveshjeve kontraktuese midis prodhuesit dhe shpërndarësit, si dhe të masave të marra prej tyre për të garantuar që këto mallra ose, sipas rastit, produktet ku ato do të inkorporohen, nuk do të përdoren për dënimin me vdekje.

4. Kur për eksportin e mallrave të parashikuara nga neni 13 i këtij ligji, drejt një përdoruesi fundor kërkohet një autorizim eksporti, autoriteti kompetent i vendit eksportues kërkon deklaratën e përdorimit fundor të nënshkruar nga përdoruesi fundor.

5. Përveç kushteve të përcaktuara në këtë nen, gjatë vlerësimit të një kërkese për autorizim global, autoriteti kompetent merr në konsideratë zbatimin nga eksportuesi të mjeteve dhe procedurave që garantojnë pajtueshmërinë me dispozitat dhe objektivat e këtij ligji dhe me kushtet e autorizimit.

Neni 15
Ndalimi i tranzitit

Ndalohet që një individ, person fizik ose juridik, apo organ, përfshirë këtu një bashkim të tyre, qoftë rezident ose i themeluar në Shqipëri apo jo, të kalojë tranzit mallrat e parashikuara në nenin 13, nëse ky individ, person fizik ose juridik, apo organ ka dijeni se këto mallra ose një pjesë e dërgesës së këtyre mallrave synohet të përdoret për dënim me vdekje në një vend të huaj.

Neni 16
Autorizimi individual ose global për ofrimin e disa shërbimeve

1. Kërkohet autorizim për çdo shërbim nga një ofrues i ndihmës teknike apo ndërmjetës për secilin nga shërbimet e mëposhtme në favor të një personi, subjekti apo organi në një vend të huaj, pavarësisht nëse ofrohen ose jo me pagesë dhe pavarësisht origjinës:

a) ndihmë teknike lidhur me të gjitha mallrat e rregulluara nga ky kre;

b) shërbime ndërmjetësimi lidhur me të gjitha mallrat e rregulluara nga ky kre.

2. Në marrjen e vendimit për kërkesat për autorizim për ofrimin e shërbimeve të ndërmjetësimit zbatohen kushtet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji për mallrat e rregulluara nga ky kre.

Në marrjen e vendimit për kërkesat për autorizim për ofrimin e ndihmës teknike zbatohen kushtet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji për e rregulluara nga ky kre për të vlerësuar nëse:

a) ndihma teknike i jepet një personi, subjekti apo organi që mund t'i përdorë mallrat për dënimin me vdekje me të cilat lidhet ndihma teknike, dhe

b) ndihma teknike do të përdoret për riparimin, zhvillimin, prodhimin, testimin, mirëmbajtjen apo montimin e mallrave të rregulluara nga ky kre, apo për të ofruar ndihmë teknike për një person, subjekt ose organ, që mund të përdorë mallrat për dënimin me vdekje me të cilat lidhet ndihma teknike ".

3. Pika 1 e këtij neni nuk zbatohet për ofrimin e ndihmës teknike nëse:

a) ndihma teknike konsiston në dhënien e informacionit që është publik;

b) ndihma teknike është minimumi i nevojshëm për instalimin, funksionimin, mirëmbajtjen apo riparimin e mallrave, eksporti i të cilave është autorizuar nga një autoritet kompetent, në përputhje me këtë ligj.

KREU V
LLOJET E AUTORIZIMEVE DHE PROCEDURAT E LËSHIMIT

Neni 17
Llojet e autorizimeve dhe autoritetet përgjegjëse

1. Autoriteti përgjegjës lëshon autorizimet individuale, të përgjithshme apo globale. Për produktet e përmendura në kreun II të këtij ligji, për qëllime muzeore lëshon vetëm autorizime individuale për import, eksport, tranzit dhe për ndihmën teknike. Ndërsa për produktet e parashikuara në krerët III dhe IV të këtij ligji lëshon autorizime individuale ose globale për eksport, ofrimin e shërbimeve të ndërmjetësimit dhe ndihmës teknike.

2. Autorizimi individual është i vlefshëm për një periudhë të përcaktuar kohe, por jo më shumë se 1 vit. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve, bazuar në kërkesën e kërkuesit, mund ta zgjasë këtë periudhë, por jo përtej afatit të vlefshmërisë së parashikuar në marrëveshjen / kontratën së cilës i referohet ky autorizim dhe jo përtej afatit të autorizimit.

3. Autorizimi i përgjithshëm është i vlefshëm për një afat trevjeçar dhe mund të përdoret nga të gjithë personat fizikë/juridikë, të cilët veprojnë në përputhje me kërkesat dhe kushtet e parashikuara nga ky ligj, aktet nënligjore, si dhe në përputhje me kushtet e përcaktuara në autorizimin e përgjithshëm për dërgimin e mallrave në shtetet e listuara në këtë autorizim.

4. Autorizimi i përgjithshëm i eksportit mund të mbulojë, gjithashtu, ofrimin e ndihmës teknike për përfituesin përfundimtar, kur kërkohet një ndihmë e tillë për instalimin e mallrave, trajtimin e mallrave, mirëmbajtjen ose riparimin e mallrave, eksporti i të cilave është i miratuar, nëse eksportuesi ofron një ndihmë të tillë.

5. Autorizimi global është i vlefshëm për një periudhë të caktuar kohe, por jo më shumë se 2 vjet. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve, bazuar në kërkesën e kërkuesit, mund ta zgjasë këtë periudhë, por jo përtej afatit të vlefshmërisë së parashikuar në marrëveshjen/ kontratën së cilës i referohet ky autorizim dhe jo përtej afatit të autorizimit.

6. Autorizimet e mallrave dhe shërbimeve të përcaktuara pikat 1, 2, 3, 4 e 5 të këtij neni, lëshohen nga autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve me kërkesë të një personi fizik/juridik privat ose publik, në formë shkresore ose me mjete elektronike, nëpërmjet sistemeve të ngritura për këtë qëllim.

7. Këshilli i Ministrave miraton me vendim modelet standarde të autorizimeve, tarifat e autorizimeve, formatet e kërkesave për këto dokumente, afatet dhe procedurat për lëshimin për të tria llojet e autorizimeve të përcaktuara në këtë nen.

8. Një autorizim i përgjithshëm për eksportin miratohet me vendim të Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, duke përcaktuar kushtet për përdorimin e këtij autorizimi, mallrat dhe shtetet e huaja ku do të eksportohet.

Neni 18
Paraqitja e kërkesës për lëshimin e autorizimit individual, global dhe të përgjithshëm

1. Për pajisjen me autorizim kërkuesi duhet të përcaktojë personin në emër të të cilit eksportohen ose importohen mallrat, ose ofruesin e shërbimeve, i cili duhet të ketë një kontratë me marrësin në një vend të huaj dhe autoritetin për të vendosur për dërgimin e mallrave jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë. Përjashtim bën rasti kur në kontratën e eksportit është përcaktuar një palë kontraktuese, e cila vepron në emrin e dikujt tjetër. Në këtë rast kërkesa mund të paraqitet nga një person i autorizuar, i cili ka të drejtë të vendosë për dërgesën e mallrave jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

2. Pas depozitimit të kërkesës, autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve merr në shqyrtim dokumentacionin e depozituar nga pala kërkuese dhe vendos, sipas rastit, pranimin ose jo të kërkesës, brenda 20 ditëve.

3. Në rast se dokumentacioni i depozituar nga pala kërkuese nuk është i plotë ose nevojiten shpjegime, autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve i komunikon palës kërkuese dokumentacionin ose informacionin e kërkuar dhe i lë një afat të ri për plotësimin e kërkesave, jo më pak se 5 ditë. Ky afat e pezullon afatin e parashikuar në pikën 3 të këtij neni.

4. Kundër vendimit të autoritetit përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve mund të ushtrohet ankim në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

Neni 19

Dokumentacioni për aplikim për autorizime individuale, globale dhe të përgjithshme për importin, eksportin dhe ofrimin e shërbimeve

Për pajisjen me autorizim, kërkuesi duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

a) emrin, selinë e personit fizik ose juridik, përkatësisht emri dhe adresa e aktivitetit, letërnjoftimi ose numri i pasaportës i përfaqësuesit ligjor dhe vendbanimi;

b) emrin, përshkrimin, kodin tarifor, numrin dhe sasinë e mallrave ose shërbimeve;

c) qëllimin e përdorimit të mallrave ose shërbimeve;

ç) vlerën totale të mallrave ose shërbimeve;

d) të dhëna për pjesëmarrësit e tjerë të transaksionit: prodhuesi, eksportuesi, importuesi, blerësi, transportuesi i mallrave, ndërmjetësit, nëse dihen;

dh) emrin dhe adresën e përdoruesit përfundimtar;

e) mënyrën e pagesës për mallrat ose shërbimet;

ë) muzeun që do të ekspozojë mallrat, në rastin e importit ose eksportit dhe ndihmës teknike për produktet e parashikuara në kreun II të këtij ligji;

f) deklaratën e përdoruesit fundor të këtyre mallrave për qëllimin e përdorimit të tyre.

Neni 20

Dokumentacioni i kërkuar për dhënien e autorizimeve individuale ose globale për tranzit

Për pajisjen me autorizim për tranzitimin, kërkuesi duhet të përcaktojë dhe/ose të paraqesë:

a) personin në emër të të cilit eksportohen dhe importohen mallrat;

b) kontratën ose marrëveshjen me marrësin ose dërguesin në një vend të huaj, i cili ka autoritetin për të dërguar mallrat;

c) rezidencën, vendbanimin ose selinë e aktivitetit në Republikën e Shqipërisë;

ç) të dhëna për pjesëmarrësit e tjerë të transaksionit: prodhuesi, eksportuesi, importuesi, blerësi, transportuesi i mallrave, ndërmjetësit, nëse dihen;

d) deklaratën e përdoruesit të fundit dhe autorizimin e eksportit nga vendi eksportues nëse ka.

Neni 21

Detyrimet e prodhueseve për autorizimet e eksportit

Kur një prodhues ose përfaqësues i një prodhuesi duhet të eksportojë ose të shesë dhe të transferojë mallra, sipas përcaktimit të kreut III ose kreut IV të këtij ligji, te një shpërndarës në një vend të huaj, ai duhet të sigurojë informacion për rregullimet e bëra dhe masat e marra për të parandaluar që mallrat e përfshira në kreun III të përdoren për tortura ose trajtime apo ndëshkime të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese ose për të parandaluar mallrat e përfshira në kreun IV nga përdorimi për dënim me vdekje, në vendin e destinacionit, si dhe informacion për përdorimin përfundimtar dhe përdoruesin fundor të mallrave.

Neni 22

Refuzimi i autorizimit

1. Autoriteti përgjegjës refuzon kërkesën për autorizim me vendim të arsyetuar nëse:

a) kërkuesi deklaron informacion të pasaktë në kërkesën për autorizim;

b) të dhënat e depozituara në kërkesë janë të falsifikuara;

c) në rastet e tjera të përcaktuara me këtë ligj.

2. Në rast të refuzimit të kërkesës për autorizim, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve do të informojë kërkuesin për arsyet e moslëshimit të autorizimit, pa përmendur të dhënat e konsideruara sekrete, në përputhje me legjislacionin që rregullon informacionin e klasifikuar "sekret shtetëror".

3. Vendimi i refuzimit të autorizimit mund të ankimohet në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

Neni 23

Shfuqizimi i autorizimit

1. Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve shfuqizon autorizimin e lëshuar nëse vlerëson se:

a) ka pasur një ose disa devijime ose shkelje nga kushtet e përcaktuara për dhënien e autorizimit pa miratimin e autoritetit licencues;

b) i autorizuari nuk i përmbush kushtet e përcaktuara në autorizim;

c) autorizimi është dhënë në bazë të informacionit të pasaktë apo të paplotë.

ç) janë plotësuar kushtet për zbatimin e pikës 3 të nenit 29 të këtij ligji.

2. Vendimi i shfuqizimit të autorizimit mund të ankimohet në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

KREU VI
DETYRIMET E SUBJEKTEVE TË PAJISURA ME AUTORIZIM DHE BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL

Neni 24
Bashkëpunimi ndërinstitucional

1. Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, kur vendos për kërkesën për autorizim për eksport, ndihmë teknike apo shërbime ndërmjetësimi, merr mendim nga institucionet e tjera të administratës shtetërore, sipas fushës së përgjegjësisë. Në rastet e mallrave, të cilat do të përdoren për muze, duhet të marrë mendim nga ministria përgjegjëse për trashëgiminë kulturore.

2. Pas marrjes së kërkesës për lëshimin e një autorizimi, Autoriteti për Kontrollin Shtetëror të Eksporteve u përcjell kërkesën organeve të administratës shtetërore, përgjegjëse për punët e jashtme dhe të brendshme, si dhe organeve të tjera përgjegjëse për fushën e mallrave ose shërbimeve.

3. Organet e përmendura në pikën 2 të këtij neni, kur japin mendim, duhet të marrin parasysh:

a) vendimet e gjykatës ndërkombëtare;

b) vendimet dhe të dhënat e organeve kompetente të Kombeve të Bashkuara dhe organizatave të tjera ndërkombëtare që janë të detyrueshme për Republikën e Shqipërisë.

4. Institucionet e përmendura në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, si dhe institucionet e tjera që mund të angazhohen në kontrollin e mallrave të kontrolluara, kthejnë përgjigje brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve. Në rast se informacioni nuk mund t'u vihet në dispozicion brenda këtij afati në mënyrë të justifikuar, palët bien dakord për shtyrjen e tij.

5. Autoriteti Shtetëror i Kontrollit të Eksporteve mund të vërë informacion në dispozicion të mekanizmit parandalues kombëtar të ngritur në bazë të protokollit opsional të Konventës kundër Torturës dhe Trajtimit ose Dënimit Mizor, Çnjerëzor apo Poshtërues.

Neni 25
Detyrimet e mbajtjes së të dhënave për subjektet e autorizuara për mallra të kontrolluara

Subjektet janë të detyruara të arkivojnë për një kohë prej të paktën 10 vjetësh, pas finalizimit të transferimit ndërkombëtar, dokumentacionin e mëposhtëm për:

a) përshkrimin teknik të mallrave, nomenklaturën e tarifave doganore;

b) sasinë e mallrave në njësi matëse dhe peshë neto të mallrave;

c) emrin dhe adresën e plotë të eksportuesit, importuesit, personit përgjegjës të tranzitit, tranzshipit, rieksportuesit apo ofruesit të shërbimeve të ndërmjetësimit ose të shërbimeve të ndihmës teknike;

ç) emrin dhe adresën e plotë të shitësit apo të marrësit të mallrave;

d) emrin dhe adresën e plotë të përdoruesit të fundit të mallrave;

dh) përshkrimin e shërbimeve të ndërmjetësimit, emrin dhe adresën e plotë të marrësit/ marrësve dhe të palëve të tjera (sipas rastit);

e) porositë, faturat, kontratat, fletëporositë, fletët e shoqërimit, listat e ngarkimit dhe dokumente të tjera lidhur me eksportin, importin, tranzitin dhe ofrimin e shërbimeve të ndërmjetësimit ose të ndihmës teknike.

Neni 26
Detyrimet për raportim për subjektet e autorizuara të mallrave të kontrolluara

1. Subjektet, që kanë marrë autorizim, janë të detyruara që:

a) me kërkesë të titullarit të autoritetit përgjegjës për kontrollin e eksporteve apo të një organi tjetër mbikëqyrës, të ofrojnë të gjithë dokumentacionin e përcaktuar në nenin 25 të këtij ligji;

b) të respektojnë kushtet në bazë të të cilave është lëshuar autorizimi dhe të njoftojnë autoritetin përgjegjës për kontrollin e eksporteve brenda 5 ditëve për çdo ndryshim që ka ndodhur në kushtet e autorizimit të lëshuar;

c) të njoftojnë me shkrim për çdo ndryshim lidhur me përdoruesin e fundit apo një palë tjetër brenda 10 ditëve nga data e ndryshimit. Ndryshimet duhet të miratohen nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve sipas afateve dhe procedurave të përcaktuara në nenin 18 të këtij ligji për lëshimin e autorizimeve. Në rast se nuk miratohen, autorizimi shfuqizohet;

ç) me kërkesë të Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve të sigurojnë konfirmimin e dorëzimit dhe marrjes së mallrave;

d) të kthejnë çdo autorizim të përdorur tek Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve brenda 15 ditëve nga finalizimi i transaksionit përkatës. Në këtë rast autorizimi nuk është më i vlefshëm.

2. Në rast se ndryshimet e raportuara nga subjekti sipas shkronjave "b" dhe "c" të pikës 1, të këtij neni, nuk miratohen nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror i Eksporteve, autorizimi do të konsiderohet i shfuqizuar.

3. Subjektet, të cilat janë pajisur me autorizim, i paraqesin një herë në vit autoritetit përgjegjës të kontrollit shtetëror të eksporteve raport me shkrim për transferimet aktuale të mallrave të përmendura në këto dokumente dhe për përdorimin e këtyre mallrave sipas qëllimit të deklaruar.

KREU VII
KONTROLLI DOGANOR, PARANDALIMI I SHKELJEVE DHE SANKSIONET

Neni 27
Kontrolli doganor

1. Kontrolli doganor i mallrave dhe procedurat e tjera doganore kryhen në bazë të Kodit Doganor të Republikës së Shqipërisë dhe të akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, si dhe të këtij ligji.

2. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve duhet t'u japë autoriteteve doganore një kopje të autorizimit të lëshuar, si dhe duhet ta informojë për vendimet për pezullime apo shfuqizime të autorizimeve.

3. Në kryerjen e procedurave doganore eksportuesi ose importuesi duhet të paraqesë autorizimin e lëshuar nga autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve.

4. Në rastet kur plotësohet deklarata doganore dhe konfirmohet që deklaruesi nuk është pajisur me autorizimin përkatës, autoritetet doganore duhet të bllokojnë mallrat dhe të njoftojnë importuesin/eksportuesin për mundësinë e kërkesës për autorizimin përkatës, sipas dispozitave të këtij ligji.

5. Nëse brenda 90 ditëve nga bllokimi i mallrave, subjekti deklarues nuk ka paraqitur kërkesë pranë autoritetit përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve ose kërkesa është refuzuar, autoritetet doganore duhet të refuzojnë hyrjen/daljen e këtij malli ose ta asgjësojnë atë sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi.

Neni 28
Shkeljet e legjislacionit në fushën e kontrollit shtetëror të eksporteve

Shkeljet e mëposhtme, të kryera nga personat fizikë/juridikë, kur nuk përbëjnë vepër penale sipas Kodit Penal, përbëjnë kundërvajtje administrative:

a) eksporti, importi, tranziti, ofrimi i shërbimeve për produktet që mund të përdoren për dënime me vdekje, torturë ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese në mungesë të autorizimit, sipas procedurave ligjore;

b) eksporti, importi, tranziti, ofrimi i shërbimeve për produktet që mund të përdoren për dënime me vdekje, torturë ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, të lëshuara në bazë të dokumenteve false ose të dokumenteve që përmbajnë informacion të rremë;

c) eksporti, importi, tranziti, ofrimi i shërbimeve të produkteve që mund të përdoren për dënime me vdekje, torturë ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, në kundërshtim me kushtet e parashikuara në autorizim, duke përfshirë ndërhyrjen dhe bërjen e ndryshimeve në marrëveshjen/kontratën ekonomike me vendet e huaja pa dijeninë e autoritetit përgjegjës të kontrollit shtetëror të eksporteve, si dhe tek emrat dhe kushtet e vendosura nga eksportuesi, importuesi, ndërmjetësi dhe përdoruesi i fundit dhe te përshkrimi i mallrave, deklarimet për përdorimin e fundit dhe dhënien e garancive;

ç) ndryshimi i destinacionit të produkteve që mund të përdoren për dënime me vdekje, torturë ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese, gjatë transferimeve ndërkombëtare dhe përdorimi për qëllime të ndryshme apo nga përdorues të fundit të tjerë, të ndryshëm nga ajo që është deklaruar në marrëveshjen/kontratën ekonomike me vendet e huaja dhe në dokumentet e tjera që lidhen me të, në bazë të të cilave është lëshuar autorizimi ndërkombëtar i importit;

d) fshehja e qëllimshme e informacionit, që mund të ndikojë në marrjen e vendimeve për dhënien e autorizimit;

dh) shkatërrimi i qëllimshëm i dokumenteve që lidhen me transferimin ndërkombëtar të produkteve që mund të përdoren për dënime me vdekje, torturë ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore apo poshtëruese, në bazë të të cilave është lëshuar autorizimi përpara afatit të parashikuar në legjislacionin në fuqi;

e) krijimi i pengesave në ushtrimin e detyrës zyrtare nga punonjësit e autoritetit përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve dhe organet e tjera shtetërore, që kryejnë kontrollin shtetëror të eksporteve, sipas kompetencave ligjore të legjislacionit në fuqi;

ë) refuzimi i pabazuar për dhënien e informacionit dhe të dokumenteve të kërkuara nga autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve ose nga ndonjë organ tjetër, që kryen kontrollin shtetëror të eksporteve, brenda kompetencave të tij ligjore, dhe shtrembërimi me dashje apo fshehja e tyre;

f) mosinformimi me shkrim i autoritetit përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve brenda një afati prej 15 ditësh për çdo ndryshim lidhur me autorizimin e lëshuar;

g) moskthimi i autorizimit që nuk është zbatuar pranë autoritetit përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve brenda një afati prej 15 ditësh nga data e skadimit të saj.

Neni 29
Sanksionet administrative

1. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve vendos dënim me gjobë ndaj subjekteve tregtare të përfshira në eksport, import, tranzit, ofrim shërbimesh për produktet e kontrolluara si më poshtë:

a) për shkeljet e parashikuara në shkronjat "a", "b", "c" dhe "ç" të nenit 28 të këtij ligji nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) – 500 000 (pesëqind mijë) lekë;

b) për shkeljet e parashikuara në shkronjat "d", "dh", "e" dhe "ë" të nenit 28 të këtij ligji nga 20 000 (njëzet mijë) – 200 000 (dyqind mijë) lekë;

c) për shkeljet e parashikuara në shkronjat "f" dhe "g" të nenit 28 të këtij ligji nga 10 000 (dhjetë mijë) – 100 000 (njëqind mijë) lekë.

2. Subjekteve të përmendura në pikën 1, përsëritëse të shkeljeve të parashikuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 1 të këtij neni, përveç gjobës, mund t'u caktohet një masë shtesë që ndalon kryerjen e eksportit, importit, tranzitit, ofrimit të shërbimeve për produktet e kontrolluara. Masa shtesë e përcaktuar vendoset për një periudhë deri në 3 vjet nga data e vendimit përfundimtar.

3. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve, përveç sanksioneve administrative, të parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, mund të shfuqizojë autorizimin dhënë këtyre subjekteve kur ata përsërisin shkeljet apo nuk marrin masa për t'i korrigjuar ato.

4. Në rastet e hetimit penal për vepra penale të lidhura me aktivitetin e tregtisë së mallrave, objekt i këtij ligji, apo me sigurinë kombëtare, autorizimi i lëshuar nga autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve mund të pezullohet deri në përfundim të hetimit të çështjes penale.

5. Të ardhurat e arkëtuara nga sanksionet administrative kalojnë në buxhetin e shtetit.

6. Kundër masave të vendosura sipas këtij neni, subjekti ka të drejtë të ankohet në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

KREU VIII
DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 30
Trajtimi i të dhënave personale

Të dhënat personale përpunohen dhe shkëmbehen në përputhje me legjislacionin që rregullon të dhënat personale në Republikën e Shqipërisë.

Neni 31
E drejta i informimit

E drejta i informimit për procedurat dhe shpërndarja e informacionit të mbledhur do të bëhet në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit në Republikën e Shqipërisë.

Neni 32
Publikimi i vendimeve

Autorizimet e lëshuara dhe vendimet për pezullimin dhe shfuqizimin e tyre, të marra në bazë të këtij ligji, publikohen në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve.

Autorizimet e përcaktuara në këtë ligj bëjnë pjesë në fushën I, kategoria 1.1, "Siguria kombëtare, rendi publik dhe mbrojtja civile", sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë.

Neni 33
Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktet nënligjore në zbatim të pikës 5 të nenit 3, të pikës 5 të nenit 9, të pikës 6 të nenit 13 dhe të pikës 7 të nenit 17 të këtij ligji.

Neni 34
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.3.2023.

Shpallur me dekretin nr. 54, datë 11.4.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 54, datë 11.4.2023

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 27/2023, "Për kontrollin e tregtimit të produkteve që mund të përdoren për dënime me vdekje, torturë ose dënime apo trajtime mizore, çnjerëzore ose poshtëruese".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

LIGJ
Nr. 28/2023

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 48/2014, "PËR PAGESAT E VONUARA NË DETYRIMET KONTRAKTORE E TREGTARE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 48/2014, "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare", të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

Neni 1

Neni 1 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 1
Qëllimi i ligjit

Qëllimi i këtij ligji është përcaktimi i rregullave për afatet dhe mënyrën e llogaritjes së kamatave

ligjore për pagesat e vonuara në rastet e furnizimit me mallra apo shërbime nga ana e ndërmarrjeve tregtare kundrejt ndërmarrjeve të tjera tregtare dhe autoriteteve publike ose nga ana e prodhuesve bujqësore kundrejt ndërmarrjeve tregtare, në mënyrë që të sigurohet funksionimi i duhur i tregut të brendshëm, duke nxitur aftësinë konkurruese të ndërmarrjeve tregtare dhe në veçanti të ndërmarrjeve të vogla e të mesme.".

Neni 2

Në nenin 3 bëhen ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. 'Veprimi juridik tregtar' është kontrata apo çdo veprim tjetër juridik, përfshirë dhe faturën tatimore, i kryer ndërmjet ndërmarrjeve tregtare ose ndërmjet ndërmarrjeve tregtare nga njëra anë dhe prodhuesve bujqësore apo autoriteteve publike nga ana tjetër, të cilat çojnë në lëvrimin e mallrave ose realizimin e shërbimeve kundrejt një kundërpagese.".

2. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

"3/1. 'Prodhues bujqësor' është subjekti që zhvillon aktivitetin e vet në kuadrin e një sipërmarrjeje bujqësore, pyjore dhe peshkimi, i cili në zbatim të legjislacionit në fuqi për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, është i pajisur me një numër identifikimi të personit të tatueshëm, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore, ku ushtron aktivitetin prodhuesi bujqësor.".

Neni 3

Në nenin 4 bëhen shtesat si më poshtë:

1. Në titullin e nenit pas fjalëve "veprime juridike ndërmjet" shtohen fjalët "prodhuesve bujqësorë,".

2. Kudo në nenin 4 pas fjalës "kreditori" shtohen fjalët "përfshirë këtu dhe prodhuesit bujqësorë".

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.3.2023.

Shpallur me dekretin nr. 55, datë 11.4.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 55, datë 11.4.2023

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 28/2023, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 48/2014 'Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare', të ndryshuar".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 1, datë 17.3.2023

PËR DIAGNOSTIKIMIN DHE MJEKIMIN PRANË QENDRËS SPITALORE UNIVERSITARE DHE INSTITUCIONEVE SPITALORE RAJONALE, SI DHE PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË DETAJUARA PËR MËNYRËN E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR DHE FUNKSIONIMIN E SKEMËS SË SIGURIMEVE SHËNDETËSORE PËR PERSONAT E BURGOSUR

Në mbështetje nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe të nenit 41, pikat 13 dhe 17, të ligjit nr. 81/2020, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", ministri i

Drejtësisë dhe ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

UDHËZOJNË:

1. Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i rregullave mbi diagnostikimin dhe mjekimin pranë Qendrës Spitalore Universitare dhe institucioneve spitalore rajonale të të burgosurit që dyshohet ose ka sëmundje ngjitëse apo sëmundje të tjera, si dhe përcaktimi i rregullave për mënyrën e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe funksionimin e skemës së sigurimeve shëndetësore për personat e burgosur.

2. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale:

a) siguron trajtimin e nevojshëm dhe të specializuar shëndetësor për të burgosurit;

b) mundëson kryerjen e ekzaminimeve mjekësore të specializuara terciare apo sekondare, sipas protokolleve të miratuara në Qendrën Spitalore Universitare dhe institucionet spitalore rajonale, brenda kapaciteteve;

c) realizon konsulta të zgjeruara në shërbimet përkatëse të Qendrës Spitalore Universitare për të burgosurit me sëmundje komplekse dhe në gjendje shëndetësore të rënduar, kur është ezauruar ofrimi i shërbimit në institucionet spitalore rajonale;

ç) siguron ambiente të veçanta për trajtimin e personave të burgosur, në Qendrën Spitalore Universitare dhe institucionet spitalore rajonale;

d) siguron kryerjen e ndërhyrjeve kirurgjikale për të burgosurit, qofshin ato urgjenca kirurgjikale apo të planifikuara, në Qendrën Spitalore Universitare dhe institucionet spitalore rajonale.

3. Rastet urgjente shëndetësore të të burgosurve dhe konsultat jashtë orarit zyrtar të punës realizohen nga pavionet e urgjencës dhe mjekët e shërbimit 24-orësh (njëzetekatërorësh) në qendrën spitalore të burgjeve ose në institucionet e kujdesit shëndetësor rajonal.

4. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet Institutit të Shëndetit Publik, ju ofron të burgosurve ekzaminime laboratorike, depistime epidemiologjike dhe asistencë për diagnozë, sipas nevojave të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

5. Të burgosurit përfshihen në kategorinë e personave ekonomikisht joaktivë. Në zbatim të ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994, "Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, pagesa e kontributeve të të burgosurve financohet nga buxheti i shtetit. Të burgosurit përfitojnë të gjitha shërbimet që ofron skema e sigurimit të detyrueshëm shëndetësor sipas këtij ligji.

6. Në zbatim të vendimit nr. 955, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kategorive të individëve të siguruar që përjashtohen nga pagesat e drejtpërdrejta të shërbimeve shëndetësore", të ndryshuar, të burgosurit përjashtohen nga pagesat e drejtpërdrejta për alternativat e para të barnave të listës së barnave të rimbursueshme.

7. Drejtoritë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor lidhin kontrata trepalëshe me institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale dhe shpërndarësin farmaceutik. Në këto kontrata përcaktohen detyrimet e secilës palë. Institucioni i ekzekutimit të vendimeve penale pajis Drejtorinë Rajonale të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor me listën e mjekëve që kanë të drejtën e plotësimit të recetave me rimbursim.

8. Mjeku i institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale, për trajtimin me barna të rimbursueshme të të burgosurit me probleme shëndetësore, mbështetet në listën e barnave të rimbursuara dhe aktet e tjera të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, duke plotësuar recetën me rimbursim të plotë. Receta me rimbursim të plotë ekzekutohet në farmacinë e institucionit të ekzekutimit të vendimeve penale. Për barnat që tregtohen në farmacitë e spitaleve, pjesë e listës së barnave të rimbursuara, ndiqet procedura sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

9. Ministria e Drejtësisë, nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve:

a) siguron transportin e të burgosurit, së bashku me informacionin mjekësor, nëpërmjet Policisë së Burgjeve;

b) siguron dhe ruan të burgosurit gjatë trajtimit në Qendrën Spitalore Universitare dhe institucionet spitalore rajonale në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;

c) merr masat për sigurinë dhe mbrojtjen e stafit shëndetësor, pacientëve, familjarëve, vizitorëve dhe qytetarëve në ambientet e Qendrës Spitalore Universitare dhe institucioneve spitalore rajonale.

10. Memorandumi i Bashkëpunimit i ministrit të Drejtësisë dhe i ministrit të Shëndetësisë i vitit 2014, "Për sigurimin e kujdesit shëndetësor, diagnostikimin dhe mjekimin e të burgosurve nga institucionet shëndetësore në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë", shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi.

11. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor dhe Instituti i Shëndetit Publik për ndjekjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Ulsi Manja

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 196, datë 11.4.2023

PËR MIRATIMIN E KRITEREVE TË VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE PËR DREJTUES TË SHËRBIMIT NË STRUKTURAT SHËNDETËSORE UNIVERSITARE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në pikën 10, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 424, datë 10.5.2017, "Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurës së përzgjedhjes e të emërimit të drejtuesve të shërbimit në strukturat shëndetësore universitare", të ndryshuar,

UDHËZOJMË:

1. Miratimin e kritereve të vlerësimit të kandidatëve për drejtues të shërbimit në strukturat shëndetësore universitare si vijon:

Nr.	Kriteret vlerësuese	Pikëzimi
1	**Të zotërojë titullin/gradën**	
	Profesor	**15 pikë**
	Profesor i asociuar	**10 pikë**
	PHD	**5 pikë**
	Doktoraturë	**3 pikë**
2	**Projekti 4-vjeçar i kandidatit për zhvillimin e shërbimit shëndetësor ku aplikon**	**53 pikë**
3	**Aftësi profesionale dhe organizative në strukturat shëndetësore**	**14 pikë**

2. Udhëzimi i përbashkët nr. 644, datë 11.9.2018, "Për miratimin e kritereve të vlerësimit të kandidatëve për drejtues të shërbimit në strukturat shëndetësore universitare", shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

MINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT
Evis Kushi

UDHËZIM
Nr. 164, datë 20.3.2023

PËR METODOLOGJINË E LLOGARITJES SË KOSTOVE TË SHËRBIMEVE SPITALORE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 23, të ligjit nr. 55/2022, "Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

1. Spitalet përllogaritin kostot e trajtimit, diagnostikimit ambulator, e shtrimit në spital për pacientët.

2. Spitalet janë të detyruar të organizojnë struktura për llogaritjen e kostove spitalore, me qëllim planifikimin e financimit për vitin pasardhës.

3. Spitalet për llogaritjen e kostove spitalore, do të bazohen në parashikimet lidhur me numrin e pacientëve që do të trajtohen, bazuar në shërbimet ekzistuese, shërbimet që planifikohen të shtohen, apo transferohen etj. Për grumbullimin e të dhënave do të shërbejë aktiviteti spitalor i vitit të mëparshëm dhe ndryshimet e parashikueshme.

4. Spitalet do të përdorin metodologjinë si më poshtë:

A. Klasifikimi i kostove:

4.1 Llogaritja e kostove do të bëhet sipas klasifikimit për efekt të shpërndarjes së tyre në objektet e kostove. Klasifikimi i kostove do të jetë:

a) kosto direkte;

b) kosto indirekte.

B. Kostot direkte

4.2 Në koston direkte do të përfshihen:

4.2.1 Të gjitha shpenzimet që parashikohen të bëhen në një shërbim të caktuar për pacientët dhe që kanë të bëjnë me:

a) numrin e pacientëve që parashikohet të trajtohen në çdo shërbim, sipas diagnozave përkatëse;

b) shpenzimet për barna, e materiale të tjera mjekësore, për pacientët e planifikuar;

c) shpenzime për ekzaminime mjekësore;

d) shpenzimet (bruto), për pagat, shpërblimet, kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore që paguan punëdhënësi, për personelin e shërbimit përkatës;

e) shpenzimet për materiale ndihmëse që parashikohet të shkojnë direkt në shërbimin përkatës, për pacientët e planifikuar për trajtim;

f) shpenzimet për ushqimin për pacientët e shërbimit të cilat llogariten sipas dietës ditore dhe numrit të pacientëve që përfitojnë;

g) shpenzimet për materiale të buta (këtu do të kihet parasysh se materialet e buta kanë një afat përdorimi më shumë se një vit);

h) shpenzime të tjera të evidentueshme e të matshme për çdo shërbim.

4.2.2 Shpenzimet direkte do të evidentohen të veçanta, për të gjitha llojet e shërbimeve që ofron spitali, me shtretër apo pa shtretër.

C. Kosto indirekte

5.1 Në mungesë të evidentimit të saktë të shpenzimeve për energji elektrike, ujë, ruajtjen e objektit, pastrimit, siguracionit etj., të cilat përdoren për secilin shërbim, këto shpenzime nuk do të klasifikohen si elemente të kostos direkte, por do të klasifikohen në elementë të kostos indirekte.

5.2 Në këto kosto do të përfshihen edhe shpenzimet që parashikohet të bëhen për objektet e tjera, si administrata, farmacia, kuzhina, kartoteka, lavanderia, punti i gjakut, kaldaja qendrore, mirëmbajtja e ambienteve të jashtme (lulishtet, gjelbërimi). Gjithashtu do të përfshihen shpenzimet për paga e sigurime shoqërore të personelit të administratës, shpenzimet e tjera për kancelari, shpenzimet për karburant, ujë, ngrohje e shpenzimet e tjera që kryen gjithë administrata për drejtimin e gjithë aktiviteteve të spitalit, shpenzimet e personelit të kartotekës, farmacisë, të lavanterisë kur kjo është qendrore, shpenzimet e personelit të gazhinës, shpenzimet për shërbime bankare, shpenzime për gjoba e penalitete, shpenzimet për spote reklame, shpenzime për qira, shpenzime për pritje përcjellje etj., si dhe shpenzimet që bëjnë njësitë brenda spitalit (që nuk janë përfshirë më lart) dhe shërbejnë e janë në funksion të të gjitha shërbimeve spitalore.

5.3 Në këto kosto do të përfshihen:

a) të gjitha shpenzimet e pastokueshme që kryhen nga spitali, por që nuk përfshihen në kostot direkte;

b) amortizimi, rinovimi dhe modernizimi i pajisjeve spitalore. Këto kosto nuk do kalojnë 4% të kostove totale.

5.4 Të kihen parasysh standardet e normativat e përcaktuara më parë në akte ligjore e nënligjore, apo protokolle shëndetësore, në elementë të veçantë të kostove.

5.5 Kostoja indirekte do të ndahet sipas raportit të mëposhtëm:

a) për shërbimet me shtretër 80% e shumës totale;

b) për shërbimet e tjera 20% e shumës totale (urgjenca, poliklinika, laboratorët, ekzaminimet).

5.6 Ndarja e kostove indirekte sipas shërbimeve do të bëhet mbi bazën e peshës specifike të ditëve të qëndrimit të pacientit në shërbim ndaj totalit të ditëve të qëndrimit për të gjitha shërbimet që parashikohet të realizohen në spital (me shtretër).

5.7 Shpërndarja e shpenzimeve indirekte brenda një shërbimi, për çdo diagnozë, do të bëhet mbi bazën e peshës specifike në përqindje që zënë ditët e qëndrimit të çdo diagnoze ndaj totalit të ditëve të qëndrimit të shërbimit përkatës (sipas parashikimeve për shtrimet sipas diagnozave).

5.8 Pjesa e shpenzimeve indirekte që u takon shërbimeve të tjera (urgjencë, laboratorë, imazheri, poliklinikë) ose 20% si më sipër, do të ndahet mbi bazën e numrit të pacientëve që parashikohet të trajtohen nga secili prej këtyre

shërbimeve ndaj totalit të numrit të pacientëve, që parashikohet të trajtohen nga të gjitha këto shërbime.

5.9 Këto shpenzime do t'u shtohen përkatësisht shpenzimeve direkte për secilin nga shërbimet e mësipërme.

5.10 Në bazë të të dhënave të grumbulluara, do të llogariten:

a) shuma e shpenzimeve indirekte;

b) ditëqëndrimi i pacientëve në një muaj, si dhe i ndarë për shërbim;

c) pesha specifike e ditëve të qëndrimit të secilit shërbim ndaj totalit të ditëve të qëndrimit;

d) shuma e shpenzimeve indirekte që do t'i kalojë çdo shërbimi mbi bazën e peshës specifike të ditëve të qëndrimit/ditët e qëndrimit gjithsej;

e) numri total i pacienteve të trajtuar në muaj nga shërbimet e tjera (urgjenca, poliklinika, laboratori, imazheria), numri e pacientëve për secilin nga këto shërbime, koeficientin e ndarjes së shpenzimeve indirekte (20%) për secilin nga këto shërbime dhe shumën përkatëse.

5.11 Treguesit që llogariten:

a) numri i pacientëve për çdo shërbim, sipas diagnozave përkatëse;

b) kosto mesatare për pacient;

c) kosto mesatare për çdo ditë pacient;

d) kosto mesatare të diagnozës për çdo ditë pacient;

e) kohëzgjatja mesatare të qëndrimit për rast;

f) kosto mesatare për shtrat;

g) kosto totale vjetore për mbulimin e aktivitetit spitalor.

5.12 Spitalet paraqesin pranë bordit drejtues/operatorit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor, për miratim, brenda muajit tetor të çdo viti, kostot e planifikuara, sipas treguesve të mësipërm.

6. Ngarkohen drejtoritë përkatëse në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për ndjekjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastiliu

SEKSIONI I TRETË

ÇËSHTJA SEVDARI KUNDËR SHQIPËRISË

(Kërkesa nr. 40662/19)

VENDIM

Neni 8 – Jeta private – Shkarkim joproporcional i prokurores dhe ndalim i përhershëm për të rihyrë në sistemin e drejtësisë, për shkak të një gabimi të izoluar profesional dhe mospagimit të tatimeve nga bashkëshorti i saj për një pjesë të vogël të të ardhurave të tij – Mungesë e keqbesimit ose e shkeljeve të qëllimshme nga kërkuesja

Neni 46 – Masat individuale – Rihapja e procesit të rivlerësimit, me kërkesë të kërkueses, dhe rishqyrtim i çështjes në përputhje me parashikimet e nenit 8 – Masat e përgjithshme nuk janë të nevojshme – Funksionimi i procesit aktual të rivlerësimit në përgjithësi, pa deklaruar si të tillë problemin sistemik të respektimit të parashikimeve të Konventës

STRASBURG
13 dhjetor 2022

I FORMËS SË PRERË

13.3.2023

Ky vendim do të bëhet i formës së prerë në mbështetje të rregullave të parashikuara në nenin 44 § 2 të Konventës. Ai mund të bëhet objekt i një rishikimi redaktues.

Në çështjen Sevdari kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si një Dhomë e përbërë nga:

Pere Pastor Vilanova, *Kryetar,*
Georgios A. Serghides,
Jolien Schukking,
Darian Pavli,
Peeter Roosma,
Ioannis Ktistakis,
Andreas Zünd, *gjyqtarë*
dhe Milan Blaško, *Sekretar i Seksionit,*

Duke mbajtur në konsideratë:

kërkesën (nr. 40662/19) kundër Republikës së Shqipërisë paraqitur pranë Gjykatës, në

mbështetje të nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ("Konventa") nga një shtetase shqiptare, znj. Antoneta Sevdari ("ankuesja"), më 29 korrik 2019;

vendimin për të njoftuar qeverinë shqiptare ("Qeveria") për kërkesën;

komentet e palëve të treta të paraqitura nga Res Publica, së cilës i është dhënë leja për të ndërhyrë nga Kryetari i Seksionit (neni 36 § 2 i Konventës dhe rregulli 44 § 3 i Rregullores së Gjykatës);

Pasi diskutoi me dyer të mbyllura më datë 22 nëntor 2022,

Shpall vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua në po atë datë:

HYRJE

1. Kërkesa ka të bëjë me procesin e rivlerësimit (*vetting*-ut), i cili rezultoi në shkarkimin e kërkueses nga pozicioni i prokurores. Ajo u ankua: i. se ishte shkelur e drejta e saj për respektim të jetës private, sipas nenit 8 të Konventës për shkak të shkarkimit të saj nga detyra dhe në vijim, për shkak të ndalimit të përhershëm të saj për të praktikuar ligjin si avokate; ii. në mbështetje të nenit 6 § 1 të Konventës se procesi kishte qenë i padrejtë; dhe iii. në mbështetje të nenit 13 të Konventës për mungesën e një mjeti efektiv në lidhje me ankesat e saj në mbështetje të neneve 6 dhe 8.

FAKTET

2. Kërkuesja ka lindur në vitin 1976 dhe jeton në Tiranë. Ajo u përfaqësua nga z. S. Powles, avokat i cili e ushtron profesionin e tij në Londër.

3. Qeveria u përfaqësua fillimisht nga agjenti i saj, z. A. Metani, dhe më pas nga znj. J. Mansaku, znj. E. Muçaj, znj. B. Lilo dhe z. O. Moçka, nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit.

4. Faktet e çështjes mund të përmblidhen si më poshtë.

I. SFONDI I ÇËSHTJES

5. Sfondi dhe qëllimet e reformës së sistemit të drejtësisë në Shqipëri, duke përfshirë edhe prezantimin e procesit të rivlerësimit në vitin 2016 me anë të aneksit në Kushtetutë dhe ligjit për Rivlerësimin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (ligji nr. 84/2016 – "Ligji i Rivlerësimit"), si edhe mënyra se si kryhet procesi i rivlerësimit, të cilit u nënshtrohen të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë, janë përmbledhur në vendimin e Gjykatës për çështjen *Xhoxhaj kundër Shqipërisë* (nr. 15227/19, §§ 4–7, 9 shkurt 2021).

6. Kërkuesja ka shërbyer si prokurore pranë Gjykatës se Rrethit Durrës nga muaji tetor 2003 deri në vitin 2012. Më pas u emërua si prokurore pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë. Nga muaji dhjetor 2018 e në vijim ajo ka shërbyer si anëtare e Këshillit të Lartë të Prokurorisë ("KLP").

II. PROCESI I RIVLERËSIMIT PËR KËRKUESEN

A. Procesi përpara Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

7. Më 18 korrik 2018, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ("KPK"), pas një seance publike, e konfirmoi unanimisht kërkuesen në postin e saj si prokurore pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë. Në përputhje me parashikimet e zbatueshme për rivlerësimin (shih paragrafët 36–42 më poshtë), KPK-ja e kishte vlerësuar kërkuesen mbi bazën e tri kritereve: i. vlerësim i pasurive të saj; ii. kontroll i figurës dhe i integritetit, me qëllim konstatimin e çdo lidhjeje të mundshme me krimin e organizuar; dhe iii. vlerësim i kompetencës profesionale.

8. Në lidhje me vlerësimin e pasurive të kërkueses, mbështetur në deklarimin, dhe provave mbi pasuritë paraqitur prej saj në procesin e rivlerësimit , KPK-ja arriti në përfundimin se deklarimi i saj për pasuritë ishte i saktë dhe i plotë, dhe se pasuritë e saj dhe të bashkëshortit të saj ishin të ligjshme. As kontrolli i figurës dhe i integritetit, i kryer mbështetur në deklaratën e paraqitur prej saj për figurën dhe integritetin, nuk përbën arsye për shqetësim. Për sa i përket vlerësimit të kompetencës profesionale të kërkueses, KPK-ja, në mbështetje të formularit të vetëvlerësimit profesional të paraqitur prej saj, dhe pasi shqyrtoi raportet si edhe denoncimet e publikut për performancën e saj, arriti në përfundimin se ajo ishte kompetente në aspektin profesional.

B. Procesi përpara Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

1. Zhvillimi i procesit nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit

9. Më 29 gusht 2018, Komisioneri Publik apeloi vendimin e KPK-së pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit ("KPA"). Ai argumentoi se hetimet e KPK-së nuk provonin se kërkuesja përmbushte kërkesat e Ligjit për Rivlerësimin, si për vlerësimin e pasurive, edhe për vlerësimin e kompetencës së saj profesionale.

10. Në vijim, kërkueses iu lejua të kishte akses në dosjen e çështjes.

11. Më 17 shtator 2018, gjyqtarët e çështjes së kërkueses u përzgjodhën me short dhe në vijim, kërkuesja u vu në dijeni për përbërjen e KPA-së (një kolegj i veçantë i Gjykatës Kushtetuese). Ajo nuk kërkoi as përjashtimin dhe as nuk pretendoi për papërshtatshmërinë e ndonjërit prej gjyqtarëve të KPA-së.

12. KPA-ja i zhvilloi seancat publike në tri ditë të ndryshme (13, 19 dhe 25 shkurt 2019), përpara se shpallte vendimin më 28 shkurt 2019. Kërkueses iu dha mundësia të bënte parashtrime, të kërkonte që KPA-ja të pranonte prova të reja, apo të kërkonte dëshmitarë.

2. Vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

13. Më 28 shkurt 2019, KPA-ja ndryshoi vendimin e KPK-së dhe e shkarkoi kërkuesen nga detyra i saj si prokurore. Kolegji gjykoi se ajo kishte bërë një deklarim të pamjaftueshëm të pasurive sipas kuptimit të nenit 61(3) të lexuar së bashku me nenin 33(5) të Ligjit për Rivlerësimin dhe nenin D §§ 1 dhe 3 të aneksit të Kushtetutës (shih paragrafët 42, 40 dhe 38 më poshtë), pasi ajo nuk kishte provuar ligjshmërinë e burimeve të saj financiare që ishin përdorur për të përftuar pasuritë e saj të paluajtshme, si edhe ligjshmërinë e disa prej të ardhurave të bashkëshortit të saj. Gjithashtu, pas një vlerësimi të përgjithshëm për të tria kriteret (neni 4(2) i Ligjit të Rivlerësimit, shih paragrafin 36 më poshtë), KPA-ja arriti në përfundimin se kërkuesja kishte cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë (neni 61(5) i Ligjit të Rivlerësimit, shih paragrafin 42 më poshtë).

a) Vlerësim i pasurive të kërkueses

i. Ara dhe shtëpia në Yzberisht, Tiranë

14. Ara dhe shtëpia në Yzberisht, Tiranë, ishin përftuar nga bashkëshorti – në atë kohë – i ardhshëm i kërkueses dhe të afërmit e tij nga viti 2000 deri në 2003, periudhë në të cilën kërkuesja nuk ishte ende prokurore. Për këtë arsye, KPK-ja nuk e vlerësoi këtë pronë. Megjithatë, KPA-ja, në të njëjtën linjë me Komisionerin Publik, ishte e mendimit se vlerësimi i pasurive brenda kuadrit të procesit të rivlerësimit duhej të shtrihej edhe te pasuria e përftuar përpara emërimit të kërkueses si prokurore dhe te ligjshmëria e burimeve të të ardhurave të përdorura për krijimin e tyre. Kërkuesja kishte argumentuar se pasuria e krijuar përpara emërimit të saj si prokurore nuk mund të konsiderohej se ishte krijuar me anë të akteve korruptive apo aktiviteteve të paligjshme, të cilat mund të kishin ndikim në integritetin e saj si prokurore.

15. Në deklaratën e saj të rivlerësimit, kërkuesja kishte deklaruar se ara dhe shtëpia ishin përftuar me anë të të ardhurave të bashkëshortit të saj prej 3,000,000 lekë (ALL – afërsisht 22,000 euro (EUR), në atë periudhë), të ardhura të cilat ai i kishte fituar si emigrant në Greqi nga viti 1997 deri në vitin 2000 (përpara se ajo të martohej me të), dhe me 12,000 euro, të cilat ai i kishte fituar me punën e tij si inxhinier në Arabinë Saudite në vitin 2003.

16. Në lidhje me këtë aspekt, KPA-ja gjykoi se kërkuesja kishte bërë një deklarim të pamjaftueshëm të pasurisë, sepse ajo nuk kishte mjete të mjaftueshme të ligjshme për të justifikuar arën dhe shtëpinë, për qëllimet e nenit 61(3) të Ligjit të Rivlerësimit të lexuar së bashku me nenin D § 3 të aneksit të Kushtetutës. Për qëllimet e rivlerësimit, të ligjshme mund të konsiderohen vetëm të ardhurat të cilat janë deklaruar më herët dhe për të cilat janë paguar taksat. Për pasojë, kërkuesja mund t'u referohej vetëm të ardhurave që i përmbushnin të dy këto kushte për të justifikuar përftimin e pasurive të paluajtshme.

17. Për sa u përket të ardhurave që bashkëshorti i kërkueses i kishte fituar si emigrant në Greqi, KPA-ja gjykoi se kërkuesja nuk kishte paraqitur mjaftueshëm dokumente mbështetëse, apo prova të tjera për të treguar se të ardhurat e transferuara nga Greqia në Shqipëri në formën e remitancave kishin qenë të ligjshme. Ajo nuk kishte provuar se bashkëshorti i saj kishte qenë i punësuar në Greqi gjatë periudhës konkrete, dhe nuk kishte specifikuar shumën

ekzakte të të ardhurave të fituara dhe shumën ekzakte të transferuar në Shqipëri.

18. Për sa u përket të ardhurave të fituara nga bashkëshorti i kërkueses në Arabinë Saudite në vitin 2003, KPA-ja konstatoi se kërkuesja dhe bashkëshorti i saj i kishin deklaruar këto të ardhura për herë të parë në vitin 2016, në kuadër të procesit të rivlerësimit, dhe se ata nuk kishin mundur të shpjegonin në mënyrë bindëse arsyet për mosdeklarimin e tyre në kohë. Në vijim, KPA-ja arriti në përfundimin se kërkuesja nuk kishte paraqitur prova të plota dhe të mjaftueshme për të treguar se burimi i të ardhurave të bashkëshortit të saj në këtë aspekt kishte qenë i ligjshëm. Dokumentet e paraqitura prej saj dhe deklaratat nga kompania e punësimit përmbanin "Indicie" për angazhimin profesional të personit të lidhur me kërkuesen (bashkëshorti i saj) dhe përftimin e të ardhurave për punën e bërë. Megjithatë, ajo nuk kishte paraqitur dokumentet e nevojshme që sqaronin plotësisht mënyrën sipas së cilës ishin paguar këto të ardhura dhe që provonin se taksat për këto të ardhura ishin paguar nga kompania. Në vijim, çifti nuk kishte mundur të demonstronte se ishte objektivisht e pamundur për ta që t'i paraqisnin këto dokumente.

ii. Të ardhurat e bashkëshortit nga puna në Arabinë Saudite në vitin 2006

19. Në deklaratën e saj për rivlerësim, në vijim, kërkuesja kishte deklaruar asete financiare në shumën prej 20,000 dollarësh amerikanë (USD), të fituara nga bashkëshorti i saj në Arabinë Saudite në vitin 2006. Edhe për këtë aspekt, KPA-ja gjykoi se ajo nuk kishte deklaruar në mënyrë të mjaftueshme pasurinë, sipas interpretimit të nenit 61(3) të Ligjit të Rivlerësimit të lexuar së bashku me nenin D § 3 të aneksit të Kushtetutës, pasi ajo nuk kishte provuar se bashkëshorti i saj kishte respektuar detyrimet përkatëse për tatimet mbi të ardhurat.

20. KPA-ja gjykoi se dokumentet e paraqitura nga kërkuesja, të cilat provonin se bashkëshorti i saj kishte jetuar dhe kishte ofruar shërbime në Arabinë Saudite gjatë periudhës konkrete, ishin të besueshme, por ato nuk përbënin "provë të plotë" në mungesë të një kontrate punësimi apo prove, se transfertat përkatëse bankare ishin bërë nga Arabia Saudite në emër të kompanisë për të cilën ai kishte ofruar shërbime.

21. Në vijim, KPA-ja konstatoi se kërkuesja nuk kishte paraqitur dokumente mbështetëse për të provuar se bashkëshorti i saj kishte paguar tatimet në Shqipëri për këto të ardhura, apo prova se ai kishte paguar tatime në Arabinë Saudite, apo se objektivisht ishte e pamundur për të që të paraqiste dokumentet e nevojshme.

iii. Pasuri të tjera

22. Pronat e tjera të paluajtshme dhe të ardhurat e tjera të kërkueses dhe të bashkëshortit të saj nga burime vendëse të vlerësuara nga KPA-ja u konsideruan të ligjshme.

b) Vlerësimi i kompetencës profesionale të kërkueses

23. KPA-ja konstatoi se asnjë prej denoncimeve të bëra nga publiku, në lidhje me kompetencën profesionale të kërkueses, nuk paraqiste mungesë të kompetencës profesionale prej saj.

24. Në lidhje me vlerësimin e një sërë çështjesh të trajtuara nga kërkuesja dhe të përzgjedhura për shqyrtim, në kuadër të rivlerësimit, KPA-ja konstatoi se në njërën prej këtyre çështjeve, e cila kishte të bënte me akuzat kundër një zyrtari publik për mosdeklarim të rregullt të pasurisë së tij, kërkuesja nuk kishte respektuar afatin për dorëzimin e një apelimi ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë për rrëzim të akuzave. Kërkesa e saj e mëpasshme për të marrë leje për apelim jashtë afatit për shkak të vështirësive familjare ishte rrëzuar. Në lidhje me këtë aspekt, KPA-ja arriti në përfundimin se edhe nëse rezultatet e hetimit konfirmonin se kërkuesja kishte demonstruar mungesë njohurish të praktikës gjyqësore, në lidhje me një koncept specifik ligjor dhe mungesë efikasiteti në menaxhimin e situatave komplekse në ushtrimin e detyrave të saj, çështja konkrete ishte e izoluar, dhe për këtë arsye, e pamjaftueshme në vetvete për të gjykuar se ajo ishte e paaftë profesionalisht. Megjithatë, KPA-ja gjykoi se fakti se çështja kishte të bënte me deklarimin e pasurisë së një zyrtari publik, edhe pse një rast i izoluar, kishte ndikim në besimin e publikut në sistemin e drejtësisë. Si prokurore e specializuar në veprat që kanë lidhje me tatimet, një gjë e tillë cenonte besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, nëse vetë anëtarët e familjes së saj nuk respektonin ligjet për tatimet.

c) Vlerësimi i përgjithshëm

25. Për këtë arsye, KPA-ja arriti në përfundimin, se mbështetur në një vlerësim të përgjithshëm të tri kritereve të vlerësimit, kërkuesja kishte cenuar edhe besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, për qëllimet e nenit 61(5) të Ligjit të Rivlerësimit.

d) Opinion mospajtues

26. Njëri prej anëtarëve të trupit gjykues, I.R., paraqiti një opinion mospajtues, në mbështetje të pozicionit se kërkuesja nuk duhej të shkarkohej nga detyra si prokurore. I.R. mbështeti mendimin se kërkuesja nuk kishte bërë deklarim të pamjaftueshëm të pasurisë sipas neneve 61(3) dhe 33 të Ligjit të Rivlerësimit. Ajo kishte provuar burimet e ligjshme të pasurive të saj deri në atë moment, ashtu siç kishte provuar mjaftueshëm ekzistencën e të ardhurave të bashkëshortit të saj dhe faktin se pasuria vinte nga veprimtari fitimprurëse të ligjshme (dhe jokriminale). Në opinionin mospajtues të gjyqtares, fakti se nuk provohet shlyerja e tatimeve për këto të ardhura nuk duhet të çojë gjithmonë në përfundimin se ka pasur burime të pamjaftueshme të ligjshme për të justifikuar pasurinë e personit dhe, për pasojë, deklarimi i pamjaftueshëm i pasurisë të çojë shkarkimin nga detyra sipas nenit 61(3) të Ligjit për Rivlerësimin. Në të tilla rrethana, neni 61(1) i Ligjit të Rivlerësimit duhet të zbatohet, si i tillë, vetëm në rastin kur pasuria e deklaruar e personit të rivlerësuar do të ishte më e madhe se sa dyfishi i vlerës së pasurisë së përftuar, së bashku me të ardhurat e tatueshme, duke përbërë kështu shkak për shkarkim nga detyra. Megjithatë, ky nuk ishte rasti për kërkuesen; të ardhurat e kundërshtuara përbënin 9.5% të totalit të të ardhurave. Në vijim, I.R. shprehu opinionin se shkarkimi i kërkueses për cenim të besimit të publikut në sistemin e drejtësisë ishte joproporcional, pasi ajo kishte ndjekur penalisht në mënyrë të suksesshme shumë çështje të rëndësishme publike financiare.

c) Opinioni i Vëzhguesit Ndërkombëtar

27. Edhe Vëzhguesi Ndërkombëtar i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit ("ONM") – një organ ndërkombëtar i udhëhequr nga Komisioni Evropian, i krijuar në mbështetje të nenit B të aneksit të Kushtetutës, për të mbështetur, monitoruar dhe mbikëqyrur procesin e rivlerësimit – dha një opinion mospajtues, më 25 prill 2019. Ai u shpreh se ishte joproporcionale që kërkuesja të sanksionohej me shkarkim nga detyra. Ai iu referua konstatimit të KPA-së se ajo kishte respektuar detyrimin për deklarim të pasurisë së saj dhe burimeve të lidhura të të ardhurave. Megjithatë, KPA-ja kishte gjykuar se (në kundërshtim me konstatimet e KPK-së) se ajo nuk kishte paraqitur justifikim të mjaftueshëm për pasuritë e saj, që do të thotë se ajo nuk kishte paraqitur mjaftueshëm dokumente për të provuar ligjshmërinë e burimeve të pretenduara të të ardhurave, veçanërisht prova për shlyerjen e tatimeve për ato të ardhura.

28. Vëzhguesi Ndërkombëtar shprehu mendimin se interpretimi i gjerë i KPA-së "i deklarimit të pamjaftueshëm të të ardhurave" në nenin 61(3) të Ligjit të Rivlerësimit, si shkak për shkarkim nga detyra binte në kundërshtim me nenin D §§ 4 dhe 5 të aneksit të Kushtetutës, dhe jepte rezultate joproporcionale. Ai argumentoi veçanërisht se konstatimi për "deklarim të pamjaftueshëm", në mbështetje të nenit 61(3) të Ligjit të Rivlerësimit mund të përmbushej vetëm nëse personi i rivlerësuar kishte bërë një deklaratë false, veçanërisht, nëse kishte prova se ai ose ajo nuk e zotëronte burimin e pretenduar të të ardhurave (gjë të cilën KPA-ja nuk e kishte konstatuar në çështjen e kërkueses). Mosjustifikimi i pasurive të deklaruara mund të sanksionohej sipas nenit 61(1) të Ligjit të Rivlerësimit, në rast se nuk përmbusheshin parashikimet në këtë nen (që do të thotë, nëse pasuria e pajustifikuar ishte më shumë se sa gjysma e shumës së pasurisë në total), çka nuk ishte rasti i kërkueses. Nëse mosjustifikimi i pasurisë së deklaruar sanksionohej si deklaratë e pamjaftueshme, neni 61(1) i Ligjit të Rivlerësimit nuk do të ishte i vlefshëm për rastin konkret dhe parashikimi i pragut prej "dyfish" nuk do të ishte i zbatueshëm.

29. Për sa ka të bëjë me profesionalizmin, Vëzhguesi Ndërkombëtar ishte i mendimit se mosdorëzimit të një apelimi për një çështje brenda afatit nuk i duhej dhënë ndonjë peshë e rëndësishme. Ai theksoi se apelimi do të duhej të dorëzohej në përputhje me udhëzimet e përgjithshme sipas së cilave prokuroria duhej të vepronte në këtë mënyrë sa herë që gjykata

merrte një vendim në kundërshtim me kërkesat e prokurorisë; apelimi konkret nuk kishte pasur ndonjë perspektivë të arsyeshme për sukses, kështu që kjo vonesë kishte qenë thjesht e natyrës formale. Aspektet e dobëta në tërësi nuk ishin të një rëndësie të tillë sa për të justifikuar përfundimin se kërkuesja kishte cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë për qëllime të nenit 61(5) të Ligjit të Rivlerësimit.

III. ZHVILLIME TË MËTEJSHME

A. Jeta profesionale e kërkueses pas vendimit të KPA-së

30. Më 19 mars 2019, KLP, duke marrë në konsideratë shkarkimin e kërkueses nga pozicioni i prokurores, e shkarkoi atë si anëtare të KLP-së.

31. Kërkuesja, e cila kishte marrë një licencë për të praktikuar ligjin si avokate nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë më 6 maj 2016, u regjistrua në regjistrin e Dhomës Kombëtare të Avokatisë si avokate më 7 mars 2019 për të ushtruar në mënyrë aktive profesionin, dhe në vijim nisi të praktikonte ligjin si avokate.

B. Procesi në lidhje me Gjyqtarët L.D. dhe A.H.

32. Më 4 dhjetor 2019, KPA-ja rrëzoi kërkesën e paraqitur nga kërkuesja pas përfundimit të procesit të rivlerësimit ndaj saj (më 23 maj 2019) për nisjen e një procedure disiplinore ndaj dy anëtarëve të KPA-së, L.D. dhe A.H., dhe për ndërprerjen e mandatit të tyre në mbështetje të parashikimeve kushtetuese dhe statutore për heqjen nga detyra të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, tek të cilët ishte referuar kërkuesja.

33. Më 20 nëntor 2019, ONM, që sipas nenit 17 të Ligjit të Rivlerësimit ishte organi kompetent për shqyrtimin e kërkesave për procese disiplinore nga publiku, e bëri me dijeni kërkuesen se pavarësisht pretendimeve të ngritura prej saj ndaj Gjyqtarëve L.D. dhe A.H., nuk mund të adresohej asnjë prej shkaqeve të parashikuar në nenin 16 të Ligjit të Rivlerësimit, sipas së cilit anëtarët e ONM mund të ndërmerrnin procese disiplinore.

34. Më 24 korrik 2020, pas nisjes së procesit penal ndaj Gjyqtarit L.D., proces që kishte nisur në mbështetje të një ankese penale të paraqitur nga Z.B. Cani (kërkues në kërkesën nr. 37474/20 përpara kësaj Gjykate), KPA-ja vendosi ta pezullojë L.D. nga detyra. Më pas, L.D. u dënua për falsifikim dokumentesh. Rezultoi se ai kishte dorëzuar informacione false në aplikimin e tij për pozicionin e gjyqtarit në KPA, pasi nuk kishte deklaruar se ishte shkarkuar nga detyra si gjyqtar në vitin 1997 (shih, për më tepër informacione për këtë çështje, vendimin *Besnik Cani kundër Shqipërisë*, nr. 37474/20, §§ 8–31, 4 tetor 2022 (jo i formës së prerë)).

35. Më 28 tetor 2022, Gjykata Kushtetuese prishi, mbi shkaqet për gjykim të drejtë, vendimin e Gjykatës së Lartë duke konfirmuar dënimin penal ndaj L.D., dhe urdhëroi ridëgjimin e çështjes nga Gjykata e Lartë.

KUADRI LIGJOR DHE PRAKTIKA LIGJORE PËRKATËSE

I. MATERIALET PËRKATËSE VENDËSE

A. Kuadri i përgjithshëm dhe funksionimi i procesit të rivlerësimit/*vetting*-ut në Shqipëri

36. Rivlerësimi tranzitor i gjyqtarëve dhe prokurorëve në Shqipëri udhëhiqet nga neni 179/b i Kushtetutës, aneksi i Kushtetutës dhe Ligji për Rivlerësimin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (ligji nr. 84/2016 – "Ligji i Rivlerësimit/*Vetting*-ut"), i cili hyri në fuqi më 8 tetor 2016. Neni 179/b i Kushtetutës parashikon rivlerësimin e të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë, që bëhet një herë, me qëllim garantimin e funksionimit të shtetit të së drejtës, pavarësisë së sistemit gjyqësor dhe rikthimit të besimit të publikut në institucionet e atij sistemi. Rivlerësimi bëhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ("KPK") në shkallë të parë, dhe Kolegji i Posaçëm i Apelimit ("KPA"), si një kolegj i veçantë pranë Gjykatës Kushtetuese, në apel. Rivlerësimi konsiston në vlerësimin e pasurisë, në kontrollin e figurës dhe integritetit, dhe në vlerësimin e kompetencës profesionale (shih nenin Ç § 1 të Aneksit të Kushtetutës, dhe nenin 4(1) të Ligjit të Rivlerësimit). Vendimi për vlerësimin mbështetet vetëm në njërin ose në disa prej këtyre komponentëve, ose në një vlerësim të përgjithshëm të të tre komponentëve dhe në një vlerësim të përgjithshëm të procesit (neni 4(2) i Ligjit të Rivlerësimit).

37. Kuadri dhe praktika ligjore përkatëse, në lidhje me procesin e rivlerësimit/*vetting*-ut të prezantuar në Shqipëri në vitin 2016,

përmblidhen në vendimin për çështjen *Xhoxhaj* (cituar më sipër, §§ 93–226). Parashikimet dhe praktika referuar çështjes konkrete janë, si më poshtë.

B. Parashikimet për vlerësimin e pasurive

38. Neni D i Aneksit të Kushtetutës, i cili rregullon vlerësimin e pasurive, parashikon si më poshtë:

Neni D – Vlerësimi i pasurive

"1. Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.

2. Subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave kontrollon deklaratën e pasurisë dhe i dorëzon Komisionit një raport për ligjshmërinë e pasurive, për saktësinë dhe plotësinë e deklarimit, sipas ligjit.

3. Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme, për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj.

4. Nëse subjekti i rivlerësimit ka një pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme, ai prezumohet fajtor për shkeljen disiplinore, përveçse kur ai paraqet prova që vërtetojnë të kundërtën.

5. Nëse subjekti i rivlerësimit nuk e dorëzon deklaratën e pasurisë në kohë sipas ligjit, ai shkarkohet nga detyra. Nëse subjekti i rivlerësimit përpiqet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën"."

39. Neni 3 i Ligjit të Rivlerësimit/*Vetting*-ut përmban përkufizimin e mëposhtëm për termin "persona të lidhur":

"13. "Person i lidhur" është rrethi i personave që kanë marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin dhe komisionerin publik, i përbërë nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët madhorë, si dhe çdo person tjetër të përmendur në certifikatën familjare të lëshuar nga zyra e gjendjes civile për subjektin e rivlerësimit, komisionerët, gjyqtarët dhe komisionerët publikë për periudhën e rivlerësimit..."

40. Pjesa përkatëse për procedurën e rivlerësimit, në nenin 33 të ligjit të *vetting*-ut, parashikon si më poshtë:

"5. Në përfundimin të kontrollit, Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, sipas rastit, konstaton se:

a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare dhe që nuk gjendet në situatë konflikti interesi;

b) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;

c) është kryer fshehje e pasurisë;

ç) është kryer deklarim i rremë;

d) subjekti [personi i rivlerësuar] gjendet në situatën e konfliktit të interesit.".

C. Sanksionet disiplinore

41. Neni Ë § 1 i Aneksit të Kushtetutës, dhe nenet 58 dhe 66 të Ligjit të Rivlerësimit parashikojnë, se në përfundim të procesit, organet e *vetting*-ut mund ta konfirmojnë në detyrë personin e rivlerësuar ose të vendosin njërin prej sanksioneve të mëposhtme disiplinore: pezullim nga detyra për një vit shoqëruar me detyrimin për të ndjekur një program trajnimi të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës, ose shkarkim nga detyra.

42. Sipas nenit 61 të Ligjit të Rivlerësimit, shkarkimi nga detyra mund të urdhërohet nëse rezulton, se:

"1. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar më shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë, përfshirë edhe personat e lidhur me të.

2. Ka probleme serioze gjatë kontrollit të figurës, sepse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar që bën të pamundur vazhdimin e detyrës.

3. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe pasurisë, sipas parashikimeve të neneve 39 dhe 33 të këtij ligji.

4. Kur rezulton se subjekti i rivlerësimit është i papërshtatshëm nga aspekti profesional, për sa ka të bëjë me vlerësimin e kompetencës profesionale.

5. Në rast se nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4(2) ... rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.".

D. Parashikimet dhe praktika në lidhje me kundërshtimet për përbërjen e KPA-së

43. Në lidhje me garancitë për paanshmëri, pjesët përkatëse të nenit 27 të Ligjit të Rivlerësimit parashikojnë, si më poshtë:

"1. Anëtari i institucioneve të rivlerësimit deklaron dhe shmang çdo situatë konflikti interesi, në respektim të ligjit "Mbi parandalimin e konfliktit të interesit". Çdo vendim i marrë në një situatë konflikti interesi, përveç pasojave ligjore në procesin e vendimmarrjes, përbën shkelje disiplinore, sipas këtij ligji.

2. Në rast se anëtari i institucioneve të rivlerësimit nuk mund të shqyrtojë një çështje që i është caktuar për shkaqet e përmendura në nenin 30 të Kodit të Procedurave Administrative ose të ligjit "Mbi parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike", ai njofton me shkrim menjëherë trupin gjykues. Përjashtimi i komisionerit, gjyqtarit ose Komisionerit Publik nga shqyrtimi i çështjes vendoset nga një tjetër trup gjykues që caktohet me short.

...".

44. Në mbështetje të praktikës së Gjykatës Kushtetuese në lidhje me ankesat për mosrespektim të kritereve statutore të përzgjedhshmërisë nga ana e anëtarëve të organeve të *vetting*-ut, më 20 prill 2020, kjo gjykatë rrëzoi si të papranueshme ankesën e paraqitur nga z. B. Cani (shih paragrafin 34 më sipër), i cili kërkonte që vendimi i Parlamentit për emërimin e L.D. në KPA të deklarohej jokushtetues.

45. Për sa ka të bëjë me ankesën e z. Cani bërë në mbështetje të nenit 131 § 1 (f) të Kushtetutës, me argumentin se emërimi i L.D. në KPA në shkelje me ligjin vendës kishte shkelur të drejtën e tij individuale për një "gjykatë të krijuar nga ligji" gjatë procesit të rivlerësimit, Gjykata Kushtetuese e rrëzoi këtë ankesë, duke arsyetuar si më poshtë:

"20. Në çështjen konkrete, Kolegji [i Gjykatës Kushtetuese] vëren se ankuesi pretendon të jetë cenuar e drejta e tij për një gjykim të drejtë për shkak të një veprimi të ndërmarrë nga një autoritet publik përpara përfundimit të procedurave në KPA, dhe, për pasojë nuk ngre asnjë pretendim kundër rezultatit përfundimtar të procesit [të *vetting*-ut]. Ai ka kundërshtuar... emërimin [e L.D. në KPA] dhe [ka kërkuar] pavlefshmërinë e pjesshme të vendimit të Parlamentit që caktonte L.D. si anëtar të KPA-së.

21. Gjykata Kushtetuese ka theksuar se e drejta për një gjykim të drejtë, duke përfshirë ankesat në lidhje me gjykatën e krijuar me ligj, garantohet gjatë një procesi ligjor ose gjyqësor në funksion të rezultatit përfundimtar, i cili sjell pasoja konkrete dhe të drejtpërdrejta për ankuesit si mbajtës i të drejtave kushtetuese procedurale dhe thelbësore. Kolegji vlerëson se edhe në procesin e rivlerësimit kalimtar, në procesin gjyqësor të kryer nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit duhet të garantohen të drejtat procedurale të subjekteve të rivlerësuar, në përputhje me kompetencat që përcaktohen nga Kushtetuta dhe ligji.

...

23. Për më tepër, Kolegji vëren se juridiksioni i Gjykatës Kushtetuese për shqyrtimin e ankimit individual kushtetues të kërkuesit, që lidhet me kryerjen e rivlerësimit kalimtar të tij, për shkak të detyrës së prokurorit, është i kufizuar nga juridiksioni që vetë Kushtetuta, në aneksin e saj, u ka dhënë organeve të rivlerësimit. Kështu, neni 179/b, paragrafi 2, i Kushtetutës parashikon se procesi i rivlerësimit, që realizohet nga KPK-ja dhe KPA-ja, do të kryhet mbi bazën e parimeve të procesit të rregullt ligjor, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të vlerësimit.

…

24. Kolegji thekson se të drejtat procedurale kushtetuese të subjekteve të rivlerësimit [...], duke përfshirë të drejtën për një "gjykatë të krijuar me

ligj", garantohen nga Kushtetuta, me anë të një procesi gjyqësor të kryer nga KPA-ja, dhe më pas, me anë të mundësisë për të ushtruar të drejtën ankim në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Duke pasur parasysh pushtetin e KPA-së për të gjykuar apelimet kundër vendimeve të KPK-së, gjykata vlerëson se ky proces [apelimi] përfshin shqyrtimin e pajtueshmërisë së procedurave me Kushtetutën..."

E. Parashikimet për rishikimin e vendimeve të formës së prerë

46. Në mbështetje të nenit 4(6) të Ligjit të Rivlerësimit, lexuar së bashku me nenin 1(2) të Ligjit për Gjykatat Administrative (ligji nr. 49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative"), organet e rivlerësimit, në rrethana të caktuara, mund të zbatojnë parashikimet e Kodit të Procedurës Civile. Neni 494 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se një palë mund të kërkojë rishikimin e një vendimi i cili është bërë i formës së prerë në rrethana të caktuara, më konkretisht, kur:

"a) zbulohen rrethana të reja apo prova të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk mund të diheshin nga pala gjatë shqyrtimit të saj;

b) vërtetohet se thëniet e dëshmitarëve apo mendimet e ekspertëve, mbi të cilat është bazuar vendimi, kanë qenë të rreme;

c) palët ose përfaqësuesit e tyre apo ndonjë anëtar i trupit gjykues, që ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes, kanë kryer vepra 214 të dënueshme penalisht, të cilat kanë ndikuar në dhënien e vendimit;

ç) vërtetohet se vendimi i dhënë është bazuar në dokumente të falsifikuara;

d) vendimi është bazuar në një vendim të gjykatës ose të një institucioni tjetër që më pas është prishur;

dh) vendimi është në kundërshtim të hapur me një vendim tjetër të formës së prerë të dhënë midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak.

e) kur Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut gjen shkelje të Konventës Evropiane, "Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore", dhe të protokolleve të saj, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.".

F. Parashikime në lidhje me statusin e prokurorëve

47. Sipas nenit 32 të ligjit të mëparshëm për Prokurorinë, i datës 12 shkurt 2001 (ligji nr. 8737/2001, "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë"), të ndryshuar, shkeljet disiplinore përfshinin, *inter alia,* veprime që diskreditonin seriozisht funksionin e prokurorit, ose veprime, që sipas ligjit, nuk ishin të pajtueshme me të. Sipas nenit 33 të atij ligji, shkelje të tilla ishin të dënueshme me anë të një vërejtjeje, paralajmërimi për shkarkim nga detyra, transferim në një pozicion më të ulët ose shkarkim nga detyra.

48. Gjykata Kushtetuese deklaroi se aktet serioze që diskreditonin funksionin zyrtar përfshinin sjelljen e papërshtatshme dhe të padenjë gjatë kryerjes së detyrave zyrtare ose jashtë atyre detyrave (vendimi nr. 75/2002).

49. Ligji "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve", i datës 6 tetor 2016 (ligji nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve") përcakton statusin e "magjistratëve", më konkretisht të gjyqtarëve dhe prokurorëve (neni 2 (gj)). Pjesa përkatëse e nenit 3 të këtij ligji, parashikon, si më poshtë për vlerat themelore:

"5. Sjellja e magjistratit gjatë ushtrimit të funksionit dhe jashtë tij garanton ruajtjen dhe forcimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, profesioni ligjor dhe palëve në proces. Magjistrati ushtron funksionet me drejtësi, në mënyrë korrekte, në kohë të arsyeshme, të ndërgjegjshme, të kujdesshme, të zellshme dhe sistematike, me objektivitet, vetëpërmbajtje dhe maturi.".

G. Parashikimet në lidhje me ushtrimin e profesionit të avokatëve

50. Sipas nenit 13(1) të Ligjit për Profesionin e Avokatit (ligji nr. 55/2018, i datës 23 korrik 2018, për profesionin e avokatit), një person është i kualifikuar për të vepruar si avokat, kur ai ose ajo ka fituar titullin "avokat" dhe është pranuar si avokat, sipas fuqisë së një certifikate (licence) të lëshuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë (më konkretisht "Shoqata e Avokatëve"). Neni 13(2) liston një sërë kërkesash të përgjithshme të cilat duhet të përmbushen në mënyrë që një person të pranohet si avokat, midis të cilave, më afër qëllimeve të kësaj

çështjeje, është kërkesa që "një person të mos jetë shkarkuar nga ushtrimi i detyrës ose funksionit publik, për arsye të integritetit etik, me vendim të organit kompetent, që ka marrë formë të prerë, me përjashtim të rasteve kur masa disiplinore është shuar sipas legjislacionit të posaçëm".

II. MATERIALET PËRKATËSE NDËRKOMBËTARE

51. Pjesët përkatëse të Udhëzimeve Evropiane për Etikën dhe Sjelljen për Prokurorët Publikë ("Udhëzimet e Budapestit"), të miratuara nga Konferenca e Prokurorëve të Përgjithshëm të Evropës, Këshilli i Evropës, e datës 31 maj 2005, parashikon:

IV. Sjellja private

"a) Prokurorët publikë nuk duhet të kompromentojnë integritetin, drejtësinë dhe paanshmërinë aktuale ose të perceptuar në mënyrë të arsyeshme, të shërbimit të prokurorisë publike me anë të aktiviteteve në jetën e tyre private.

b) Prokurorët publikë respektojnë dhe i binden ligjit gjatë gjithë kohës.

c) Prokurorët publikë duhet të sillen në mënyrë të tillë që të përforcojnë dhe të ruajnë besimin e publikut në profesionin e tyre.

...".

52. Pjesët përkatëse të opinionit nr. 13 (2018) për pavarësinë, llogaridhënien dhe etikën e prokurorëve, lëshuar nga Këshilli Konsultativ i Prokurorëve të Evropës, të Këshillit Evropian (CCPE) parashikojnë:

"22. Sjellja e prokurorëve, ashtu si edhe e gjyqtarëve, nuk mund të lihet vetëm në diskrecionin e tyre, si brenda edhe jashtë detyrës së tyre. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur vlerësohen veprimtaritë e prokurorëve dhe në proceset disiplinore ndaj tyre.

...".

51. Respektimi i shtetit të së drejtës kërkon standardet më të larta etike dhe profesionale në sjellje të prokurorëve, edhe të gjyqtarëve, si gjatë detyrës edhe jashtë saj, çka mundëson besimin e shoqërisë te drejtësia. Prokurorët veprojnë në emër të njerëzve dhe në interes të publikut. Për këtë arsye, ata duhet të ruajnë gjithmonë integritetin personal dhe të veprojnë në përputhje me ligjin në mënyrë të drejtë, të paanshme dhe objektive, duke respektuar dhe ruajtur të drejtat dhe liritë themelore, duke përfshirë prezumimin e pafajësisë, të drejtën për gjykim të drejtë, dhe parimet e barazisë së armëve, ndarjes së pushteteve, dhe forcën detyruese të vendimeve të gjykatës. Ata kanë detyrën të jenë të pavarur nga ndikimet politike, apo ndikime të tjera."

LIGJI

I. KUNDËRSHTIMI PARAPRAK I QEVERISË

53. Qeveria parashtroi se kërkuesja kishte shpërdorur të drejtën e saj për të paraqitur një kërkesë pasi ankesa e saj se ajo nuk e kishte pasur të mundur të ushtronte profesionin e saj pas përfundimit të procesit të rivlerësimit mbështetej në fakte të pavërteta. Veçanërisht, Qeveria argumentoi se ndryshe nga parashtrimet në kërkesën e saj pranë Gjykatës, aktualisht, ajo e ushtronte profesionin si avokate.

54. Kërkuesja e kundërshtoi këtë këndvështrim. Ajo pretendoi se kishte parashtruar në kërkesën e saj, dhe kishte mbështetur qëndrimin se, si rezultat i shkarkimit të saj në procesin e rivlerësimit ajo ndalohej në mënyrë të përhershme të praktikonte ligjin si avokate, në mbështetje të nenit 13(2) të Ligjit për Avokatët (shih paragrafin më sipër). Për këtë arsye, ajo rrezikonte t'i hiqej e drejta e avokatisë në çdo moment pa pasur mundësinë që të regjistrohej përsëri.

55. Gjykata përsërit se sipas nenit 35 § 3 (a) të Konventës, një kërkesë mund të kundërshtohet si shpërdorim i së drejtës për kërkesë individuale, nëse, midis të tjerash, ajo mbështetet me dashje në fakte të pavërteta (shih *Akdivar dhe të Tjerët kundër Turqisë*, 16 shtator 1996, §§ 53–54, *Raportet e Gjykimeve dhe Vendimeve* 1996-IV, dhe *Varbanov kundër Bullgarisë*, nr. 31365/96, § 36, GJEDNJ 2000-X). Parashtrimi i informacioneve të paplota, dhe për pasojë mashtruese, mund të shkaktojnë shpërdorim të së drejtës për të bërë një kërkesë, veçanërisht nëse informacionet kanë të bëjnë me vetë thelbin e çështjes dhe nëse nuk ofrohen shpjegime të mjaftueshme për mosdeklarimin e atyre informacioneve (shih *Gross kundër Zvicrës* [DHM], nr. 67810/10, § 28, GJEDNJ 2014). E njëjta gjë zbatohet nëse kanë ndodhur zhvillime të reja dhe të rëndësishme

gjatë procesit përpara Gjykatës, dhe në rastin kur, pavarësisht se kjo gjë kërkohet shprehimisht në rregullin 47 § 7 (më herët rregulli 47 § 6) i Rregullores së Gjykatës, kërkuesi nuk deklaron informacionet e kërkuara në Gjykatë, në këtë mënyrë duke e penguar atë të gjykojë për çështjen në dijeni të plotë të fakteve (shih *Mirolubovs dhe të Tjerët kundër Letonisë*, nr. 798/05, § 63, 15 shtator 2009, dhe *Centro Europa 7 S.r.l. dhe Di Stefano kundër Italisë* [DHM], nr. 38433/09, § 97, GJEDNJ 2012). Megjithatë, edhe në këto raste, qëllimi i kërkuesit për të mashtruar Gjykatën duhet të provohet me siguri të mjaftueshme (shih *Centro Europa 7 S.r.l. dhe Di Stefano*, § 97, dhe *Gross*, § 28, të dy cituar më sipër).

56. Pas shqyrtimit të dosjes së çështjes dhe të parashtrimeve të palëve në respektim të parimeve mësipërme, Gjykata shprehet se parashtrimet e kërkueses mund të kishin qenë më të qarta për sa ka të bëjë me faktin se në praktikë, ajo kishte filluar të punonte si avokate pas shkarkimit të saj si prokurore. Megjithatë, duke iu referuar shpjegimeve të dhëna prej saj, Gjykata nuk e gjykon si të provuar faktin se ajo nuk e dha atë informacion, i cili nuk përbën esencën e çështjes për shkarkimin e saj në procesin e rivlerësimit, si përpjekje të qëllimshme për të mashtruar Gjykatën. Për këtë arsye, në lidhje me këtë aspekt, kundërshtimi i Qeverisë duhet të rrëzohet.

II. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 8 TË KONVENTËS

57. Kërkuesja u ankua se shkarkimi i saj nga detyra si prokurore dhe më pas, ndalimi i përhershëm për të praktikuar ligjin si avokate kishin shkelur të drejtën për respektimin e jetës së saj private, sipas parashikimit të nenit 8 të Konventës, i cili parashikon, si më poshtë:

"1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private...

2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve."

A. Pranueshmëria

1. Ankesa në lidhje me shkarkimin e kërkueses nga detyra

58. Duke iu referuar kritereve të përcaktuara në vendimin e Gjykatës në çështjen *Denisov kundër Ukrainës* ([DHM], nr. 76639/11, §§ 123 dhe 125, 25 Shtator 2018), Qeveria parashtroi se neni 8 nuk ishte i zbatueshëm në rastin e ankesës së kërkueses për shkarkimin e saj. Ajo nuk kishte provuar se shkarkimi i saj nga detyra publike si prokurore kishte ndikuar në jetën e saj private në një masë mjaftueshëm serioze përderisa ajo tashmë po praktikonte ligjin si avokate.

59. Kërkuesja argumentoi se shkarkimi i saj si prokurore kishte ndikuar në mënyrë të konsiderueshme jetën e saj private dhe se, duke mbajtur në konsideratë kriteret e përcaktuara në çështjen *Denisov* (cituar më sipër, §§ 107 dhe 114), neni 8 do të ishte i zbatueshëm. Humbja e punës dhe e pagës kishte shkaktuar përkeqësimin e mirëqenies materiale të saj dhe të familjes së saj. Më pas, ajo kishte humbur mundësitë profesionale; reputacioni i saj ishte dëmtuar dhe ajo ishte stigmatizuar në sytë e shoqërisë për shkak të largimit të saj nga gjyqësori.

60. Gjykata u referohet kritereve të përcaktuara në praktikën gjyqësore për mosmarrëveshjet për punësimin që përfshihen në fushën e veprimit të jetës private sipas kuptimit të nenit 8, duke përfshirë nevojën e një kërkuesi të tregojë se është arritur pragu i gjendjes serioze të situatës në rastin kur, sipas nenit 8, lind një problematikë, për shkak të pasojave të shkaktuara nga masa e kundërshtuar për punësimin ndaj jetës së tij/saj private ("qasja me bazë pasojat", shih *Denisov*, cituar më sipër, §§ 115–17). Në vijim, Gjykata u referohet përfundimeve të saj në çështjen *Xhoxhaj* (cituar më sipër), ku konstatoi se neni 8 ishte i zbatueshëm për shkarkimin nga pozicioni në gjyqësor i kërkuesit, në mbështetje të Ligjit të Rivlerësimit (ibid., §§ 362–64).

61. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se kërkuesja ishte shkarkuar nga detyra si prokurore karriere në mbështetje të Ligjit të Rivlerësimit, duke humbur me efekt të menjëhershëm funksionin e saj në sistemin e drejtësisë dhe pagën e saj. Pa dyshim që një gjë e tillë kishte pasoja serioze për "rrethin e saj të brendshëm", që do të thotë, për mirëqenien e saj dhe të

familjarëve të saj. Sipas këndvështrimit të Gjykatës, fakti se në vijim, ajo pati mundësi të bënte një profesion tjetër ligjor dhe të praktikonte ligjin si avokate nuk vë në pikëpyetje këtë konstatim. Për më tepër, organet e rivlerësimit shqyrtuan kompetencën e saj profesionale dhe arritën në përfundimin se ajo kishte cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë (shih paragrafin 13 më sipër). Shkarkimi i saj, veçanërisht për atë shkak, dhe mbështetur në Ligjin e Rivlerësimit, që ishte miratuar për të luftuar korrupsionin, nënkuptonte se në sytë e shoqërisë, ajo ishte stigmatizuar si e padenjë për të kryer funksionin e prokurores.

62. Gjykata arrin në përfundimin se shkarkimi i saj nga detyra në prokurori kishte ndikim në jetën e saj private në një shkallë të konsiderueshme. Për këtë arsye, neni 8 është i zbatueshëm dhe kundërshtimi i Qeverisë në këtë aspekt duhet të rrëzohet.

63. Gjykata vëren se kjo pjesë e kërkesës nuk është as e pambështetur qartazi në fakte dhe as e papranueshme për ndonjë nga shkaqet e tjera të listuara në nenin 35 të Konventës. Për këtë arsye, ajo duhet të deklarohet e pranueshme.

2. Ankesa në lidhje me ndalimin e përhershëm të kërkueses për të praktikuar ligjin si avokate

64. Qeveria parashtroi se ankesa e kërkueses se ajo nuk kishte mundësi të ushtronte profesionin e saj pas përfundimit të procesit të rivlerësimit ishte qartazi e pambështetur në fakte. Aktualisht, ajo po praktikonte ligjin si avokate ne Tiranë, pasi Dhoma Kombëtare e Avokatisë e kishte regjistruar me kërkesën e saj (shih paragrafin 31 më sipër). As Ligji i Rivlerësimit dhe as ndonjë nga vendimet e marra nga organet e rivlerësimit nuk e kishin ndaluar atë të bënte këtë gjë. Qeveria konfirmoi se neni 13(2) i Ligjit për Avokatinë (shih paragrafin 50 më sipër) parashikonte se personat e shkarkuar me anë të një vendimi të formës së prerë nga një detyrë publike për probleme të lidhura me etikën në marrëdhëniet e punësimit nuk mund të praktikonin ligjin si avokatë. Megjithatë, kërkuesja nuk ishte shkarkuar për kryerjen e ndonjë krimi dhe as për arsye etike për qëllimet e atij parashikimi.

65. Kërkuesja parashtroi se ajo kishte një licencë nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë që prej datës 6 maj 2016, të cilën nuk e kishte fshehur, dhe se kishte filluar të praktikonte ligjin si avokate pas shkarkimit të saj si prokurore. Megjithatë, sipas nenit 13(2) të Ligjit të Avokatisë, ajo rrezikonte t'i hiqej e drejta për kryerjen e profesionit të avokatisë në çdo moment si rezultat i shkarkimit të saj në procesin e rivlerësimit pa mundësi për t'u regjistruar përsëri, dhe për këtë arsye ajo kishte statusin e viktimës, për shkak se ndikohej në mënyrë të drejtpërdrejtë nga ai ligj. Sipas debateve në Parlament, neni 13(2) do të zbatohej për gjyqtarët dhe prokurorët e shkaktuar nga proceset e rivlerësimit. Në vijim, ajo iu referua shembullit të një prokurori tjetër, znj. B. Nikehasani (kërkuesja në kërkesën nr. 58997/18 përpara kësaj Gjykate), kërkesa e së cilës për të nisur procesin për marrjen e licencës për të praktikuar ligjin si avokate, ishte refuzuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë për shkak të shkarkimit të saj në procesin e rivlerësimit.

66. Gjykata u referohet kërkesave të parashikuara në praktikën e saj gjyqësore, në mënyrë që një kërkues të mund të pretendojë të jetë viktimë e shkeljes së një të drejte të Konventës, sipas kuptimit të nenit 34 të Konventës (shih, *inter alia*, *Tănase kundër Moldavisë* [DHM], nr. 7/08, § 104, GJEDNJ 2010, me referenca të tjera, dhe *Michaud kundër Francës*, nr. 12323/11, § 51, GJEDNJ 2012). Ajo vëren se në çështjen konkrete, është i pakundërshtueshëm fakti se kërkuesja jo vetëm që kishte një licencë që e lejonte atë të praktikonte ligjin si avokate, por ajo edhe u regjistrua pas shkarkimit të saj si prokurore, dhe që prej atij momenti ka praktikuar ligjin si avokate (shih edhe paragrafin 31 më sipër). Organet e rivlerësimit nuk morën asnjë vendim në lidhje me të drejtën e saj për të praktikuar ligjin si avokate. Frika e saj se mund të bëhej viktimë e një shkeljeje të Konventës, duke iu hequr e drejta e avokatisë në të ardhmen nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë nuk është mjaftueshëm që ajo të pretendojë se rrezikon të ndikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 13(2) i Ligjit të Avokatëve, dhe se ajo ishte viktimë e shkeljes së të drejtave të saj të Konventës në këtë aspekt (krahaso edhe me *Xhoxhaj*, cituar më sipër, §§ 370–73).

67. Për këtë arsye, kjo pjesë e kërkesës është *ratione personae* e papajtueshme me parashikimet e

Konventës dhe duhet të rrëzohet në mbështetje të nenit 35 §§ 3 (a) dhe 4.

B. Meritat

1. Nëse shkarkimi i kërkueses nga detyra përbente një ndërhyrje

68. Duke përsëritur në esencë parashtrimet në lidhje me zbatueshmërinë e nenit 8 të shkarkimit të kërkueses nga detyra (shih paragrafët 58–59 më sipër), kërkuesja argumentoi se shkarkimi i saj kishte ndërhyrë në të drejtën e saj për respektim të jetës së saj private, ndërsa Qeveria parashtroi se nuk kishte ndodhur një ndërhyrje e tillë.

69. Gjykata është e mendimit se, sipas konstatimeve në lidhje me zbatueshmërinë e nenit 8 (shih paragrafët 61–62 më sipër), shkarkimi i kërkueses nga detyra, në fakt, përbënte një ndërhyrje në të drejtën e saj për respektim të jetës së saj private (krahaso edhe *Xhoxhaj*, cituar më sipër, § 377, me referenca të tjera).

2. Nëse ndërhyrja ishte e justifikuar

a) Në përputhje me ligjin

70. Kërkuesja parashtroi se vendimi për ta shkarkuar nga detyra nuk ishte në "përputhje me ligjin". Parashikimet ligjore mbi të cilat mbështetej ai vendim shpreheshin në terma aq të gjerë saqë ata nuk përmbushnin kërkesën për parashikueshmëri. Veçanërisht, autoritetet vendëse kishin interpretuar në mënyrë të gjerë nenin 61(3) të Ligjit të Rivlerësimit (shih paragrafin 42 më sipër) mbi të cilin ishte mbështetur shkarkimi i saj. Konstatimi për "deklarim të pamjaftueshëm", sipas nenit 61(3) të Ligjit të Rivlerësimit, lexuar së bashku me nenin 33, çka çonte në shkarkimin nga detyra, duhej të bëhej nëse një person nuk deklaronte plotësisht pasuritë e tij/saj – një konstatim të cilin autoritetet nuk e kishin bërë në çështjen e saj. Në çështjet në të cilat një person nuk justifikon plotësisht vetëm pasuritë e deklaruara – gjë të cilën autoritetet e kishin konstatuar në rastin e saj, pasi ajo nuk kishte mundur të paraqiste prova se bashkëshorti i saj kishte paguar tatimet për disa nga fitimet e tij në të shkuarën – duhet të zbatohet neni 61(1) i Ligjit të Rivlerësimit. Sipas këtij parashikimi, personi i rivlerësuar ishte subjekt shkarkimi nga detyra nëse ai ose ajo kishte deklaruar pasuri në total sa dyfishi i vlerës së pasurive të ligjshme, çka nuk kishte qenë rasti me të. Gjithashtu, neni 61(3) i Ligjit të Rivlerësimit nuk parashikonte se kur deklarimi i pasurive ishte "i pamjaftueshëm", duke arritur në këtë mënyrë pragun e caktuar si një situatë serioze për të justifikuar shkarkimin nga detyra. Interpretimi i KPA-së i nenit 61(3) të Ligjit të Rivlerësimit nënkuptonte se çdo mangësi mund të interpretohej si "deklarim i pamjaftueshëm". Kërkuesja iu referua edhe opinionit kundërshtues të Vëzhguesit Ndërkombëtar të ONM-së, në lidhje me këtë aspekt (shih paragrafët 27–28 më sipër).

71. Në vijim, kërkuesja argumentoi se neni 61(5) i Ligjit të Rivlerësimit, mbi të cilin ishte mbështetur shkarkimi i saj, ishte, gjithashtu, i paqartë, duke u dhënë në këtë mënyrë organeve të rivlerësimit diskrecion të pakufizuar për të shkarkuar nga detyra një person që rivlerësohej. Nuk ekzistonte një përcaktim për parashikimin që një person i rivlerësuar "cenonte besimin e publikut në sistemin e drejtësisë" dhe asnjë tregues se çfarë të metash profesionale arrinin nivelin e caktuar të seriozitetit të situatës për të justifikuar shkarkimin nga detyra. Ishte konstatuar se ajo i kishte përmbushur këto kërkesa pasi nuk kishte respektuar afatin për apelim në një çështje për arsye shëndetësore.

72. Qeveria mbështeti qëndrimin se edhe nëse supozohej se shkarkimi kishte ndërhyrë në të drejtën e kërkueses për respektim të jetës së saj private, ajo ndërhyrje ishte parashikuar nga Kushtetuta dhe Ligji i Rivlerësimit, ku parashikohej qartë procedura e rivlerësimit dhe pasojat e mundshme, duke qenë në këtë mënyrë "në përputhje me ligjin" sipas kuptimit të nenit 8 § 2.

73. Gjykata i referohet praktikës së saj gjyqësore të mirëpërcaktuar në lidhje me kushtet që nevojiten që një masë të jetë "në përputhje me ligjin", duke përfshirë veçanërisht, kërkesën e parashikueshmërisë, që do të thotë se ligji konkret duhet të parashikojë me saktësi të mjaftueshme kushtet sipas të cilave mund të zbatohet masa (shih, *inter alia, Maestri kundër Italisë* [DHM], nr. 39748/98, § 30, GJEDNJ 2004-I, dhe *Fernández Martínez kundër Spanjës* [DHM], nr. 56030/07, § 117, GJEDNJ 2014 (ekstrakte)).

74. Në vendimin *Xhoxhaj* (cituar më sipër, §§ 385–88), Gjykata vendosi se shkarkimi i kërkuesit në atë çështje, mbështetur në nenin 61(3) dhe (5)

të Ligjit të Rivlerësimit, ishte në mbështetje të ligjit sipas kuptimit të nenit 8 § 2.

75. Gjykata vëren se në çështjen konkrete, shkarkimi i kërkueses ishte mbështetur në të njëjtat parashikime të Ligjit të Rivlerësimit. Në vijim, ajo konstaton se sipas praktikës gjyqësore të mirëpërcaktuar të organeve të rivlerësimit, neni 61(3) i Ligjit të Rivlerësimit, duhet të lexohet së bashku me nenin 33(5) dhe nenin D §§ 1 dhe 3 të aneksit të Kushtetutës (shih paragrafët 40 dhe 38 më sipër). Nga këto parashikime, është e qartë se për qëllime të rivlerësimit, të ardhurat ose burimet e fitimeve të një individi do të konsiderohen të ligjshme vetëm nëse deklarohen në mënyrën e duhur, dhe nëse për to janë paguar tatimet. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se parashikimet ligjore tek të cilat ishte mbështetur shkarkimi i kërkueses përmbushnin kërkesën e parashikueshmërisë. Për këtë arsye, vendimi për ta shkarkuar atë ishte "në përputhje me ligjin".

b) Qëllim legjitim

76. Sipas këndvështrimit të kërkueses, ndërhyrja në të drejtën e saj për respektim të jetës së saj private, nuk kishte shërbyer për ndonjë qëllim legjitim për qëllime të nenit 8 § 2. Ajo parashtroi, se në praktikë procesi i rivlerësimit ishte përdorur si mjet për t'i shërbyer interesave politikë, duke i frikësuar në mënyrë konstante gjyqtarët dhe prokurorët, gjë e cila dobësonte pavarësinë e tyre.

77. Qeveria argumentoi se ndërhyrja kishte ndjekur qëllimin legjitim për të luftuar korrupsionin në sistemin gjyqësor.

78. Në çështjen *Xhoxhaj*, Gjykata konstatoi se masat e parashikuara nga Ligji i Rivlerësimit, i cili ishte miratuar për të siguruar funksionimin e shtetit të së drejtës, pavarësinë e sistemit gjyqësor dhe rikthimin e besimit të publikut në atë sistem (shih paragrafin 36 më sipër), në përgjithësi u shërbente interesave të sigurisë kombëtare, sigurisë publike dhe mbrojtjes të së drejtave dhe lirive të të tjerëve, sipas kuptimit të nenit 8 § 2. Për të arritur në atë përfundim, Gjykata iu referua si raporteve vendëse, edhe atyre ndërkombëtare (veçanërisht atyre të Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO)), duke arritur në përfundimin se ekzistonte një nivel i lartë korrupsioni në sistemin e drejtësisë. Në vijim, ajo mori në konsideratë konstatimet e Gjykatës Kushtetuese dhe të Komisionit Evropian për Demokraci me anë të Ligjit ("Komisioni i Venecias"), se rivlerësimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve ishte i nevojshëm për të mbrojtur sistemin e drejtësisë në Shqipëri nga korrupsioni dhe sfidat e tjera të integritetit dhe profesionalizmit (ibid., §§ 391–93, me referenca të tjera).

79. Gjykata nuk gjen asnjë arsye për të dyshuar se ndërhyrja në të drejtën e kërkueses për të respektuar jetën e saj private duke e shkarkuar atë nga detyra, kishte objektiva të ngjashëm dhe në këtë mënyrë ndiqte qëllimet e mbrojtjes së sigurisë kombëtare, sigurisë publike dhe të drejtave dhe lirive të të tjerëve sipas kuptimit të nenit 8 § 2.

c) I nevojshëm në një shoqëri demokratike

i. Parashtrimet e palëve dhe ndërhyrësi si palë e tretë

80. Kërkuesja parashtroi se shkarkimi i saj ishte qartazi joproporcional me qëllimin e ndjekur. Ligji i Rivlerësimit (veçanërisht neni 58, shih paragrafin 41 më sipër) nuk parashikonte një nivel sanksionesh dhe rregullash për të garantuar se sanksioni i shkarkimit nga detyra ishte zbatuar në përputhje me parimin e proporcionalitetit (ajo u referua *Oleksandr Volkov kundër Ukrainës*, nr. 21722/11, § 182, GJEDNJ 2013). Për më tepër, nuk ekzistonte asnjë masë mbrojtëse procedurale për të parandaluar zbatimin arbitrar të Ligjit të Rivlerësimit (ajo iu referua *Oleksandr Volkov*, cituar më sipër, § 170). Shkarkimi i saj kishte qenë joproporcional në rrethanat e çështjes, duke pasur parasysh argumentet në të cilat ishte mbështetur. Vlerësimi i pasurive ishte mbështetur në faktin se ajo nuk kishte mundur jepte të dhëna se bashkëshorti i saj kishte paguar rregullisht tatimet mbi fitimet e tij në Greqi dhe në Arabinë Saudite, duke përfshirë edhe periudhat në të cilat ajo nuk kishte qenë në marrëdhënie martesore me të. Gjithashtu, në lidhje me këtë aspekt, duhej të mbahej në konsideratë fakti se ligjet shqiptare për tatimet mbi të ardhurat e fituara jashtë vendit nuk kishin qenë të qartë në periudhën përkatëse dhe se bashkëshorti i saj kishte vepruar në mirëbesim. Në lidhje me vlerësimin e kompetencës profesionale, ajo ishte qortuar për mosrespektimin e afatit për apelim në një çështje për arsye shëndetësore.

81. Qeveria argumentoi se shkarkimi i kërkueses nga detyra kishte qenë i nevojshëm në një shoqëri demokratike. Qeveria theksoi se në lidhje me vlerësimin e pasurive, kërkuesja nuk kishte mundur të provonte burimin e ligjshëm të ALL 3,000,000 dhe EUR 12,000, pasi ajo nuk mund të tregonte se paratë kishin ardhur nga punësimi legjitim dhe se detyrimet e tatimeve ishin shlyer. Në vijim, ajo nuk kishte provuar burimin e ligjshëm të USD 20,000 pasi bashkëshorti i saj nuk kishte paguar tatimet përkatëse. Në vijim, për sa i përket vlerësimit të kompetencës profesionale, ajo nuk kishte apeluar ndaj një vendimi gjykate për të rrëzuar akuzat ndaj një zyrtari të lartë i cili ishte pezulluar për mosdeklarim të pasurive. Në atë kontekst, duhej të mbahej në konsideratë fakti se kërkuesja, si prokurore, kishte qenë drejtuesja e seksionit të krimit ekonomik me fokus evazionin fiskal. Në këtë mënyrë cenohej besimi në sistemin e drejtësisë, nëse një prokurore që akuzonte të tjerët për evazion fiskal apo që nuk apelonte ndaj një vendimi për shfajësimin e një zyrtari të lartë për evazion fiskal, konstatohej të mos kishte shlyer detyrimet e saj të taksave.

82. *Res Publica,* një organizatë joqeveritare e cila promovonte mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut, argumentonte, veçanërisht, se parashikimi i vetëm dy masave disiplinore në Ligjin e Rivlerësimit, konkretisht shkarkimi nga detyra ose detyrimi për të ndjekur një trajnim, demonstronte mungesën strukturore të proporcionalitetit të sanksioneve disiplinore. Gjithashtu, ndërhyrësi si palë e tretë theksoi se interpretimi i KPA-së i Ligjit të Rivlerësimit nuk linte vend për vlerësimin e proporcionalitetit të sanksioneve në rastin e deklarimeve të parregullta të pasurisë, krahasuar me deklarimet në të cilat pasuritë fshiheshin me qëllim.

ii. Vlerësimi i Gjykatës

83. Gjykata përsërit se çdo ndërhyrje me të drejtën për të respektuar jetën private do të konsiderohej "e nevojshme në një shoqëri demokratike", për një qëllim legjitim, nëse i përgjigjet "një nevoje sociale urgjente" dhe, veçanërisht, nëse është proporcionale me qëllimin legjitim të ndjekur, dhe nëse arsyet e dhëna nga autoritetet vendëse për ta justifikuar atë janë "relevante dhe të mjaftueshme" (shih, për shembull, *Fernández Martínez*, cituar më sipër, § 124, dhe *Ivanovski kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë*, nr. 29908/11, § 180, 21 janar 2016).

84. Duke iu referuar konstatimeve të organeve vendëse dhe ndërkombëtare, të cilat arrinin në përfundimin se ekzistonte një nivel i lartë korrupsioni në sistemin shqiptar të drejtësisë (shih paragrafin 78 më sipër dhe referencat cituar në të), Gjykata thekson se reforma në sistemin e drejtësisë, e cila solli rivlerësimin e jashtëzakonshëm të të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në detyrë, dhe potencialisht shkarkimin e tyre, erdhi si përgjigje ndaj një "nevoje sociale urgjente" (krahaso edhe *Xhoxhaj*, cituar më sipër, § 404).

85. Gjykata vëren se dështime të caktuara nga ana e zyrtarëve publikë për të respektuar detyrimet në lidhje me deklarimet e pasurive, përgjithësisht, mund të konsiderohen serioze. Këto mund të përfshijnë, midis të tjerash, mosdeklarimet e pasurive të mëdha ose të burimeve të të ardhurave, ose përpjekjet e qëllimshme për t'i fshehur ato nga autoritetet; pamundësinë për të justifikuar blerjet e mëdha të bëra me kursime dhe burime legjitime dhe të mjaftueshme në zotërim gjatë kohës së përvetësimit; apo pamundësinë për të justifikuar një stil jetese të tepruar apo shpenzime ekstravagante që janë qartazi përtej mjeteve të ligjshme të deklaruara të zyrtarit përkatës dhe të familjes së tij. Gjithashtu, në lidhje me këtë aspekt, Gjykata pranoi se mund të jetë legjitime që të merren në konsideratë edhe të ardhurat dhe deklarimet e bashkëshortit, partnerit apo anëtarëve të tjerë të familjes së ngushtë të zyrtarit/zyrtares gjatë vlerësimit të respektimit nga ana e zyrtarit/zyrtares të ligjeve antikorrupsion (shih *Samoylova kundër Rusisë*, nr. 491088/11, §§ 85–86, 14 dhjetor 2021). Në të njëjtën kohë, jo çdo rast i vogël mosrespektimi i regjimeve të deklaratave të pasurive, apo çdo mospërputhje e parëndësishme midis shpenzimeve dhe burimeve të ligjshme duhet t'u japë jetë sanksioneve disiplinore të rënda, të tilla si shkarkimi nga detyra.

86. Për sa ka të bëjë me proporcionalitetin midis shkarkimit të kërkueses dhe qëllimeve legjitime të ndjekura, Gjykata thekson se shkarkimi i saj nga detyra – kryesisht i gjyqtarëve ose i prokurorëve me status jetëgjatë në sistem – është një sanksion i rëndë, në mos më seriozi, që

mund të merret ndaj një individi. Vendosja e një mase të tillë, e cila ndikon negativisht në jetën private të një individi, kërkon marrjen në konsideratë të provave të forta në lidhje me etikën, integritetin dhe kompetencën profesionale të individit (krahaso *Xhoxhaj*, cituar më sipër, § 403).

87. Në lidhje me argumentin e kërkueses se Ligji i Rivlerësimit, në përgjithësi nuk parashikonte një normë sanksionesh dhe rregullash për të garantuar se sanksioni i shkarkimit nga detyra zbatohej në përputhje me parimin e proporcionalitetit, Gjykata vëren se neni Ë § 1 i Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 58 dhe 66 të Ligjit të Rivlerësimit në të vërtetë parashikonin vetëm dy lloje sanksionesh disiplinore: shkarkimin nga detyra ose pezullimin me detyrimin për të ndjekur një program trajnimi (shih paragrafin 41 më sipër). Në këtë mënyrë, Gjykata i referohet gjykimit të saj në vendimin *Xhoxhaj* (cituar më sipër, § 412) se, duke marrë në konsideratë rrethanat e jashtëzakonshme të cilat paraprinë hyrjen në fuqi të Ligjit të Rivlerësimit, është në harmoni me frymën e procesit të rivlerësimit që të ekzistonte një normë më e kufizuar sanksionesh në rastin kur një person nuk përmbushte një nga tri kriteret e vlerësimit të parashikuara në Ligjin e Rivlerësimit. Megjithatë, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse në rrethanat konkrete të çështjes së kërkueses, zbatimi i këtyre parashikimeve që çonin në vendosjen e sanksionit më të rëndë, ishte proporcional me qëllimet e ndjekura.

88. Shkarkimi i kërkueses mbështetej në vlerësimin e pasurive të saj dhe në vlerësimin e kompetencës së saj profesionale. Në lidhje me vlerësimin e pasurive, në fillim Gjykata vëren se të gjitha rastet e mosdeklarimit të mjaftueshëm ose të mosjustifikimit të pasurive për qëllime të nenit 61(3) të Ligjit të Rivlerësimit të konstatuara nga KPA-ja kishin lidhje në mënyrë ekskluzive me të ardhurat e fituara nga bashkëshorti i saj nga punësimi jashtë vendit dhe jo me të ardhurat e saj personale. Ajo gjykon se në këto rrethana, është i nevojshëm një kujdes i veçantë për vlerësimin e proporcionalitetit në shkarkimin e saj.

89. Gjykata vëren, se KPA-ja gjykonte se kërkuesja nuk kishte deklaruar mjaftueshëm pasuritë sipas kuptimit të nenit 61(3) të lexuar së bashku me nenin 33(5)(b) të Ligjit të Rivlerësimit (shih paragrafët 42 dhe 40 më sipër), pasi ajo nuk kishte provuar ligjshmërinë e burimeve financiare të përdorura për të përftuar një pjesë të pasurive të paluajtshme të çiftit (shih paragrafët 13–22 më sipër). Sipas gjykimit të KPA-së, ajo nuk kishte mundur të provonte ligjshmërinë e burimeve të mëposhtme të të ardhurave të përdorura për të blerë një pronë të paluajtshme: ALL 3,000,000 (rreth EUR 22,000 në atë kohë) të fituara nga bashkëshorti i saj i ardhshëm si emigrant në Greqi nga viti 1997 në vitin 2000; EUR 12,000 të fituara nga bashkëshorti i saj në Arabinë Saudite në vitin 2003; dhe USD 20,000 të fituara nga bashkëshorti i saj në Arabinë Sauditë ne vitin 2006.

90. Për sa u përket parregullsive në lidhje me ALL 3,000,000 të fituara nga bashkëshorti i ardhshëm i kërkueses si emigrant në Greqi gjatë viteve 1997–2000, sipas gjykimit të KPA-së, kërkuesja nuk kishte paraqitur prova për punësimin e tij në Greqi në atë kohë, dhe as nuk kishte paraqitur shumën e saktë të të ardhurave të gjeneruara nga puna e tij (shih paragrafët 15–17 më sipër). Në lidhje me këtë aspekt, Gjykata vëren se ndryshe nga KPK-ja, KPA-ja shqyrtoi të ardhurat që bashkëshorti i ardhshëm i kërkueses i kishte fituar pesëmbëdhjetë–njëzet vjet përpara deklarimit të saj në procesin e rivlerësimit, në një periudhë kur ai nuk ishte martuar ende me të, gjithashtu, Gjykata vëren se është i rëndësishëm fakti se ajo nuk ishte bërë ende prokurore apo zyrtare publike i një roli tjetër që t'u nënshtrohej ligjeve për deklarimin e pasurive.

91. Për sa u përket parregullsive në lidhje me EUR 12,000 të fituara nga bashkëshorti i kërkueses në Arabinë Saudite në vitin 2003, sipas gjykimit të KPA-së, kishte indicie për punësimin e tij në Arabinë Saudite në atë periudhë. Megjithatë, kërkuesja nuk i kishte deklaruar këto të ardhura më herët në deklaratën e saj të rivlerësimit dhe as nuk kishte provuar se bashkëshorti i saj kishte paguar tatimet për këto të ardhura (shih paragrafin 18 më sipër). Gjykata mban në konsideratë faktin se kërkuesja nuk e kishte deklaruar këtë shumë në vitin 2004 në deklaratën e përvitshme të pasurisë, përpara se ta deklaronte në deklaratën e rivlerësimit. Në lidhje me këtë aspekt, ajo gjykon se ky mosdeklarim ka të bëjë me deklarimin e parë të pasurisë së

kërkueses, e cila kishte nisur të praktikonte ligjin si prokurore vetëm në tetor 2003. Në lidhje me materialet përpara saj, në vijim, ajo gjykon se nuk ekziston asgjë që të tregojë se të ardhurat e bashkëshortit nuk vinin nga një aktivitet fitimprurës i ligjshëm.

92. Në lidhje me parregullsitë me paratë e fituara nga bashkëshorti i ankueses në Arabinë Saudite në vitin 2006 (USD 20,000), kërkuesja ofroi prova të besueshme se ai kishte qenë i punësuar në atë periudhë në Arabinë Saudite dhe deklaroi shumën e fituar në deklaratën e saj të përvitshme të pasurisë për vitin 2006 dhe në deklaratën e saj të rivlerësimit, por nuk ofroi prova të dokumentuara se ai i kishte paguar tatimet mbi të ardhurat në Shqipëri ose në Arabinë Saudite (shih paragrafët 19–21 më sipër). Gjithashtu, Gjykata vëren se në lidhje me këto të ardhura nuk ka asgjë për të treguar se ato nuk vinin nga një aktivitet i ligjshëm fitimprurës.

93. Në lidhje me konstatimet e mësipërme, Gjykata thekson se kërkuesja ishte shkarkuar nga detyra, pasi ishte konstatuar se ajo nuk kishte mjaftueshëm burime të ligjshme për të justifikuar përvetësimin e pasurisë së paluajtshme. Vlerësimi i burimeve – ekskluzivisht të ardhurat e bashkëshortit të saj – përfshinin të ardhurat e fituara prej tij në kohën kur kërkuesja nuk ishte as e martuar me të dhe as një prokurore. Burimet e tjera nuk ishin konsideruar të ligjshme, kryesisht pasi kërkuesja nuk kishte mundur të provonte se bashkëshorti i saj kishte paguar taksat për të ardhurat e tij nga një punësim i ligjshëm jashtë vendit. Gjykata vëren se, teksa evazioni i mundshëm fiskal është një çështje serioze, për qëllimet e procedurave të rivlerësimit të kërkueses, është me rëndësi për çështjen që shumat e të ardhurave të bashkëshortit për të cilat nuk u provua nëse tatimet ishin paguar, përfaqësonin një përqindje relativisht të vogël të shumës në total të të ardhurave të bashkëshortit në periudhën konkrete, dhe se nuk u konstatua asnjë parregullsi në lidhje me të ardhurat e bashkëshortit nga burimet vendëse gjatë një sërë vitesh.

94. Në lidhje me vlerësimin e kompetencës profesionale të kërkueses, qasja e vetme që KPA-ja kishte kundër saj ishte fakti se ajo nuk kishte respektuar një afat për dorëzimin e apelimit në një çështje. E teksa vetë KPA-ja e kishte konsideruar këtë rast një incident të izoluar në karrierën e kërkueses, sidoqoftë, ajo gjykoi se duke qenë se çështja konkrete kishte të bënte me deklarimin e pasurive të një zyrtari publik, mosdorëzimi nga ana e saj i një apelimi ndikonte në cenimin e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, për qëllimet e nenit 61(5) të Ligjit të Rivlerësimit (shih paragrafët 23–25 më sipër). Gjykata nuk nënvlerëson në këtë këndvështrim rëndësinë e ndjekjes penale të veprave penale të pretenduara me natyrë ekonomike nga zyrtarët publikë për ruajtjen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë. Megjithatë, ajo gjykon se, për sa më sipër, në këndvështrimin e KPA-së, mosdorëzimi nga ana e kërkueses e një apelimi kishte qenë një incident i izoluar në karrierën e saj si prokurore, e cila kryesisht trajtonte rastet e krimeve ekonomike. Nuk është argumentuar nëse çështja konkrete, e cila përfshinte një ish-zyrtar të qeverisë lokale, ishte e një profili veçanërisht të lartë. Gjithashtu, në lidhje me këtë aspekt, Gjykata i referohet opinionit të vëzhguesit ndërkombëtar, se apelimi konkret do të duhej të dorëzohej duke pasur në konsideratë udhëzimet e përgjithshme për paraqitjen e apelimeve të prokurorisë, por ky apelim nuk kishte pasur ndonjë perspektivë të arsyeshme për të pasur sukses.

95. Në vijim, Gjykata i referohet faktit se sipas ligjit vendës (krahaso paragrafët 47–49 më sipër) dhe standardeve evropiane, duke përfshirë Udhëzimet Evropiane për Etikën dhe Sjelljen për Prokurorët Publikë ("Udhëzimet e Budapestit", shih paragrafin 51 më sipër) si edhe opinioni vijues nr. 13 (2018) për pavarësinë, llogaridhënien dhe etikën e profesorëve, lëshuar nga Këshilli Konsultativ i Prokurorëve të Evropës, të Këshillit të Evropës (CCPE) (shih paragrafin 52 më sipër), prokurorët duhet të përmbushin standarde të larta integriteti në trajtimin e çështjeve të tyre private jashtë profesionit për të ruajtur besimin e publikut në integritetin e sistemit të drejtësisë. Për këtë arsye, është e rëndësishme që kërkuesja, si prokurore përgjegjëse për ndjekjen penale, *inter alia*, të kundërvajtjeve tatimore, të provojë se pjesëtarët e familjes së saj të ngushtë kishin respektuar legjislacionin e zbatueshëm tatimor. Gjykata nuk mund të anashkalojë faktin se një formë më pak e rëndë për përgjegjësinë tatimore, jashtë procesit

të rivlerësimit, mund të ishte marrë në konsideratë në një rast të tillë. Për më tepër, çdo indicie për evazion fiskal do të ishte hetuar nga autoritetet përkatëse. Megjithatë, rrethanat konkrete të çështjes duhet të merren në konsideratë për të vlerësuar proporcionalitetin e sanksionit më të rëndë: shkarkim nga detyra. Në rastin e kërkueses, sanksioni konkret, sipas Ligjit për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, sillte edhe ndalimin e përhershëm për t'u rikthyer në sistemin e drejtësisë (krahaso *Xhoxhaj*, cituar më sipër, §§ 413, 245 dhe 206-07).

96. Për sa më sipër, Gjykata gjykon se referuar një vlerësimi të përgjithshëm të rrethanave specifike të çështjes, shkarkimi i kërkueses, mbështetur kryesisht në faktin se ajo nuk kishte mundur të provonte se bashkëshorti i saj i kishte paguar tatimet për një pjesë të të ardhurave të tij nga aktivitete të ligjshme gjatë dy dekadave të mëparshme, dhe në mungesë të ndonjë indicie të keqbesimit apo të shkeljeve të qëllimshme nga vetë kërkuesja, ishte joproporcional me qëllimet legjitime të procesit të rivlerësimit.

97. Sipas këtyre rrethanave, me shkarkimin e kërkueses nga detyra është shkelur neni 8 i Konventës.

III. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 6 TË KONVENTËS

98. Kërkuesja u ankua se procedurat e rivlerësimit që kishin rezultuar në shkarkimin e saj nga posti i prokurores kishin qenë të padrejta. Ajo argumentoi se çështja e saj nuk ishte gjykuar nga një "gjykatë e krijuar nga ligji" për shkak të mospërshtatshmërisë së njërit apo më shumë anëtarëve të KPA-së, se KPA-ja që kishte gjykuar çështjen e saj nuk kishte pavarësi dhe paanshmëri, dhe se të meta të rënda procedurale kishin ndikuar në drejtësinë e procesit. Ajo u mbështet në nenin 6 të Konventës, pjesët përkatëse të të cilit parashikojnë, si më poshtë:

"1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij..."

A. Zbatueshmëria e nenit 6

99. Qeveria pranoi se neni 6 § 1 i Konventës ishte i zbatueshëm për proceset e rivlerësimit në aspektin e tij civil. Kërkuesja ishte e mendimit se neni 6 ishte i zbatueshëm për ato procese si në aspektin e tij civil edhe atë penal.

100. Në vendimin *Xhoxhaj* (cituar më sipër), Gjykata konstatoi se neni 6 ishte i zbatueshëm në procesin e rivlerësimit të prezantuar në Shqipëri në vitin 2016, në aspektin e tij civil (ibid., §§ 236-39 dhe 288), por jo në aspektin e tij penal (ibid., §§ 240-46). Ajo nuk sheh asnjë arsye të arrijë një përfundim ndryshe në këtë çështje.

B. Ankesa në lidhje me përcaktimin e të drejtave nga një "gjykatë e krijuar nga ligji"

1. Parashtrimet e palëve

101. Qeveria parashtroi se ankesa e kërkueses ku pretendohej për papërshtatshmërinë e një sërë gjyqtarësh të KPA-së për detyrën e gjyqtarit dhe, për pasojë, për mungesën e një "gjykate të krijuar nga ligji", duhet të rrëzohej për mosshfrytëzim të mjeteve vendëse në përputhje me nenin 35 § 1 të Konventës. Qeveria parashtroi se ajo nuk kishte paraqitur asnjë kundërshtim për përbërjen e KPA-së gjatë procesit përpara atij kolegji, dhe për këtë arsye, nuk u kishte dhënë gjykatave vendëse mundësinë të korrigjonin një gabim të mundshëm.

102. Qeveria argumentoi se sipas nenit 27 të Ligjit të Rivlerësimit (shih paragrafin 43 më sipër), kërkuesja kishte pasur mundësinë të kundërshtonte praninë në proces të gjyqtarëve, të cilët ishin në konflikt interesi ose nuk kishin mundësi të ushtronin detyrën për shkak të ndalimeve të caktuara. Sipas nenit 27(2) të Ligjit të Rivlerësimit, në rastin e një kundërshtimi, vendimi do të merrej nga një tjetër trup gjykues i KPA. Në vijim, Qeveria argumentoi se edhe një person tjetër subjekt i procesit të rivlerësimit kishte paraqitur një ankesë penale ndaj njërit prej gjyqtarëve të KPA, L.D., i cili ishte pezulluar nga detyra nga KPA pasi ishte akuzuar për falsifikim të dokumenteve (shih paragrafin 34 më sipër).

103. Kërkuesja parashtroi se ajo nuk kishte pasur mjete efektive në dispozicion për të kundërshtuar përbërjen e KPA-së gjatë procesit të rivlerësimit. Vendimet e KPA-së ishin të formës së prerë. Vetëm tre muaj pas vendimit të KPA-së për ta shkarkuar nga detyra, u zbulua se dy ose më shumë gjyqtarë të KPA nuk kishin

qenë të kualifikueshëm për të shërbyer si gjyqtarë të këtij kolegji. Njëri prej gjyqtarëve, L.D. më pas ishte shpallur fajtor pasi kishte fshehur faktin që çonte në papërshtatshmërinë e tij, më konkretisht faktin se ishte shkarkuar nga detyra si gjyqtar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë në vitin 1997. Në vijim, ai ishte skualifikuar nga kandidimi për një tjetër pozicion në gjyqësor nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë në fund të vitit 2016.

104. Në vijim, kërkuesja parashtroi se nuk kishte pasur asnjë mjet efektiv për të kundërshtuar mosrespektimin e kritereve të kualifikimit nga ana e anëtarëve të KPA-së. Një person tjetër, subjekt i procesit të rivlerësimit, kishte kundërshtuar pjesëmarrjen e gjyqtarëve L.D. dhe A.H. në çështjen e tij pasi ata nuk përmbushnin kriteret përzgjedhëse për të qenë anëtarë të KPA. Megjithatë, KPA-ja kishte gjykuar se pyetjet në lidhje me mandatin e këtyre gjyqtarëve nuk ishin në juridiksionin e saj, sipas parashikimeve kushtetuese të zbatueshme. Edhe ankesa kushtetuese e këtij personi nuk kishte pasur ndonjë dobi (shih paragrafët 44–45 më sipër). Kërkesat e saj për hapjen e një procesi disiplinor ndaj gjyqtarëve L.D. dhe A.H., dhe heqja e tyre nga detyra për arsye mospërshtatshmërie në KPA dhe ONM, pasi ajo ishte vërë në dijeni për problemet me mospërshtatshmërinë e tyre, nuk kishin pasur dobi (shih paragrafët 32–33 më sipër).

2. Vlerësimi i Gjykatës

105. Gjykata përsërit se një tipar themelor i mekanizmit për mbrojtjen e krijuar nga Konventa është delegimi te sistemet vendëse që të ruajnë të drejtat e njeriut. Gjykata nuk duhet të marrë rolin e Shteteve Kontraktuese, përgjegjësia e të cilave është të garantojnë respektimin dhe mbrojtjen në nivel vendës të të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Konventë. Rregulli për shterimin e mjeteve vendëse mbështetet në prezumimin – reflektuar në nenin 13 të Konventës, me të cilin ka më shumë ngjashmëri – se ekziston një mjet efektiv i disponueshëm për shkeljen e pretenduar. Për këtë arsye, rregulli është një pjesë e rëndësishme e funksionimit të këtij sistemi mbrojtjeje (shih *Vučković dhe të Tjerët kundër Serbisë* (kundërshtimi paraprak) [DHM], nr. 17153/11 dhe 29 të tjerë, § 69, 25 mars 2014).

106. Shtetet nuk përgjigjen përpara një organi ndërkombëtar për veprimet e tyre përpara se të kenë pasur mundësinë t'i zgjidhin problemet me anë të sistemit të tyre ligjor, dhe ato shtete që dëshirojnë të kërkojnë juridiksionin mbikëqyrës të Gjykatës për sa u përket ankesave kundër një Shteti kanë detyrimin të përdorin fillimisht mjetet e ofruara nga sistemi vendës ligjor (shih, midis shumë autoritetesh, *Akdivar dhe të Tjerët*, § 65, dhe *Vučković dhe të Tjerët*, § 70, të dy cituar më sipër).

107. Dyshimet mbi rolin e kërkuesit/kërkueses në lidhje me efikasitetin e një mjeti të caktuar nuk e çlirojnë atë nga detyrimi që ta provojë atë (shih *Milošević kundër Holandës* (vendim) nr. 77631/01, 19 Mars 2002; *Vučković dhe të Tjerët*, cituar më sipër, §§ 74 dhe 84; dhe *Zihni kundër Turqisë* (vendim), nr. 59061/16, §§ 23 dhe 30, 29 nëntor 2016). Kjo është e vërtetë veçanërisht në kontekstin në të cilin efikasiteti i një mjeti nuk është testuar ende ose testohet rrallë përpara gjykatave vendëse, dhe në kontekstin në të cilin Gjykata ka vendosur se kërkuesit do të duhej të shteronin mjetet të cilat ishin të aksesueshme dhe që ofronin perspektiva të arsyeshme suksesi (krahaso *Zihni*, cituar më sipër, §§ 24–31). Në një sistem ligjor ku ofrohet mbrojtje nga Kushtetuta ose ligji për të drejtat themelore, është detyra e individit të dëmtuar të testojë atë mbrojtje dhe t'i lejojë gjykatat vendëse t'i mbrojnë ato të drejta me anë të interpretimit (krahaso, *A, B dhe C kundër Irlandës* [DHM], nr. 25579/09, § 142, GJEDNJ 2010; shih edhe *Vučković dhe të Tjerët*, § 84, dhe *Zini*, § 30, të dy cituar më sipër).

108. Në lidhje me vendimet e formës së prerë shpallur nga gjykatat vendëse, Gjykata ka vendosur vazhdimisht se një kërkesë për rihapjen e proceseve mbi bazën e fakteve të reja nuk është një mjet efektiv për qëllimet e respektimit të kritereve të pranueshmërisë sipas nenit 35 § 1 të Konventës (shih *Vainio kundër Finlandës* (vendim), nr. 62123/09, 3 maj 2011; *Riedl-Riedenstein dhe të Tjerët kundër Gjermanisë* (vendim), nr. 48662/99, 22 janar 2002; dhe *Dinchev kundër Bullgarisë* (vendim), nr. 17220/09, § 27, 21 nëntor 2017). Megjithatë, Gjykata ka vendosur edhe se në disa situata të caktuara përjashtuese, duhet të rivendosen mjete të jashtëzakonshme, për shembull, në rastin kur rrëzimi i një vendimi i cili ka hyrë në fuqi, është i vetmi mjet me anë të të cilit Shteti përgjegjës mund të zgjidhë çështjet me anë të sistemit të tij ligjor (shih *Kiiskinen dhe*

Kovalainen kundër Finlandës (vendim), nr. 26323/95, 1 qershor 1999, ku ankimi përpara Gjykatës kishte të bënte me paanshmërinë e një gjyqtari dhe nuk do të mund të ishte bërë përpara përfundimit të procesit vendës; dhe *Nikula kundër Finlandës* (vendim), nr. 31611/96, 30 nëntor 2000). Në mënyrë të ngjashme, në rrethana specifike, Gjykata ka vendosur se një kërkesë për rihapjen e proceseve mund të jetë i vetmi mjet përmes së cilit ankesa specifike mund të ngrihet përpara gjykatave vendëse dhe në rrethana të tilla, kjo do të përbënte një mjet efektiv (shih *Sobczyk kundër Polonisë* (vendim), nr. 73446/10, §§ 40 dhe 48, 25 gusht 2015, dhe *Dinchev*, cituar më sipër, § 28).

109. Gjykata vëren se është i pakundërshtueshëm fakti se ankuesja nuk e bëri ankesën e saj në lidhje me faktin se një apo më shumë gjyqtarë të KPA-së nuk përmbushnin kriteret kualifikuese për të shërbyer si gjyqtarë të atij kolegji në procesin e rivlerësimit përpara atij kolegji. Në lidhje me këtë aspekt, Gjykata gjykon se Gjykata Kushtetuese, në vendimin e saj të datës 29 prill 2020, në çështjen *Besnik Cani* (shih paragrafët 44–45 më sipër), konfirmoi se e drejta kushtetuese për "një gjykatë të krijuar nga ligji" duhej të garantohej nga KPA-ja gjatë proceseve përpara tij (ibid, m §§ 21 dhe 24). Në vijim, ajo vëren se diku pas vendimit të KPA-së për çështjen e saj, KPA-së e pezulloi Gjyqtarin L.D. nga detyra, kur ndaj tij nisi procesi penal për falsifikim dokumentesh në lidhje me aplikimin e tij për pozicionin në KPA, pas një ankese penale nga një person tjetër që po rivlerësohej (shih paragrafin 34 më sipër).

110. Gjykata vëren se një palë në një proces gjyqësor e cila ka dyshime për ligjshmërinë e emërimit të një gjyqtari që merr pjesë në seancën e çështjes së tij/saj, çka mund të ndikojë negativisht në cilësinë e parimit "të themeluar nga ligji" të asaj gjykate, përgjithësisht pritet t'i drejtojë ato pyetje përpara gjykatës dhe/ose të ndjekë çdo mjet tjetër efektiv të parashikuar nga ligji vendës teksa procesi është ende në pritje (krahaso faktet në vendimin *Besnik Cani*, cituar më sipër, §§ 35–42). Faktet referuar nga kërkuesja në fjalë në lidhje me përshtatshmërinë e L.D. për të shërbyer si gjyqtar i KPA, dhe veçanërisht shkarkimi i tij i mëparshëm nga detyra në gjyqësor, ishin publike. Kërkuesja ka referuar vendimet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili e shkarkoi L.D. nga detyra në vitin 1997 dhe, gjithashtu, e skualifikonte atë nga kandidimi për një pozicion tjetër në gjyqësor në fund të vitit 2016, dokumente të cilat ajo i mori brenda disa muajsh pas shkarkimit të saj në procesin e rivlerësimit. Edhe anëtarët e komisionit parlamentar që shqyrtuan aplikimin e L.D. për pozicionin në KPA ngritën pyetje gjatë seancës parlamentare për situatat e tij të mëparshme (shih *Besnik Cani*, cituar më sipër, § 13). Në këto rrethana, kërkuesja nuk provoi bindshëm se nuk mund të kishte dijeni gjatë procesit të saj të rivlerësimit për faktet kyçe në lidhje me largimin e mëparshëm të L.D. nga gjyqësori.

111. Gjithashtu, si konsideratë shtesë, kërkuesja nuk paraqiti, pas vënies në dijeni për dyshimet në lidhje me përshtatshmërinë e L.D. për pozicionin e tij, një kërkesë për rishikim përjashtimor të vendimit të formës së prerë të KPA-së në çështjen e saj mbështetur në faktet e zbuluara rishtazi, apo për ndonjë shkak tjetër të parashikuar në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile (shih paragrafin 46 më sipër dhe vendimin *Besnik Cani*, cituar më sipër, §§ 148–49). Kjo do t'i kishte dhënë kërkueses një mundësi për të bërë parashtrime përpara KPA pas hedhjes dritë mbi të dhënat e reja dhe vendimtare, dhe për të shprehur vëmendjen ndaj këtij aspekt (më konkretisht, se këto fakte "nuk mund të ishin bërë të njohura nga pala gjatë shqyrtimit të çështjes"), si edhe për t'i dhënë KPA-së një mundësi për t'i marrë në konsideratë ato parashtrime.

112. Gjykata nuk e anashkalon faktin se përderisa çështja e kundërshtimit të përshtatshmërisë së gjyqtarëve të KPA ishte një çështje e re në proceset e rivlerësimit, nuk ekzistonte ende ndonjë praktikë e mirëpërcaktuar gjyqësore, sipas së cilës kërkuesi mund të përdorte ndonjë mjet apo mjete. Për më tepër, Gjykata i referohet konstatimeve të saj në çështjen *Besnik Cani* (cituar më sipër, §§ 35–36), ku KPA u vetëdeklarua jokompetente për të marrë një vendim për ankesën e kërkuesit – një çështje e paraqitur pasi vendimi i KPA-së për të shkarkuar kërkuesen nga detyra e saj ishte bërë i formës së prerë – se mandati i L.D. duhet të ndërpritet për shkak të papërshtatshmërisë së tij

për detyrën në KPA. Megjithatë, Gjykata është e mendimit se këto zhvillime të mëpasshme, për të cilat ankuesja nuk kishte dijeni në kohën përkatëse, nuk e përjashtonin atë nga detyra për të ngritur pikëpyetjet përkatëse ose gjatë procesit të saj të rivlerësimit, apo nëse kjo nuk ishte e mundur objektivisht pavarësisht kujdesit të saj, me anë të nisjes së procesit për rishikim të vendimit të formës së prerë të KPA-së. Në këtë aspekt, Gjykata nuk mund të përjashtojë se pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese të datës 29 prill 2020 (shih paragrafët 44–45 më sipër), KPA-së do të mund ta kishte rishqyrtuar – nëse do t'i kërkohej ta bënte këtë gjë në proces formal – pozicionin e saj të mëparshëm për mungesën e kompetencës për të dëgjuar kundërshtimet ndaj përshtatshmërisë së njërit prej anëtarëve të saj për një pozicion në gjyqësor. Si përfundim, kërkuesja nuk përdori ndonjë mjet vendës për garantimin e të drejtës së saj që procesi i saj i rivlerësimit të gjykohej nga një "gjykatë e krijuar nga ligji". Gjatë procesit përpara KPA-së, ajo nuk e ngriti kundërshtimin e saj për përbërjen e KPA, sipas rregullave të zakonshëm të procedurës civile, apo mbi ndonjë shkak tjetër (krahaso faktet në vendimin *Besnik Cani*, cituar më sipër, § 35–39). Në vijim, Gjykata vlerëson se kërkesat e dorëzuara për informacion dhe procedurat disiplinore të kërkuara nga kërkuesja ndaj gjyqtarëve në fjalë pas përfundimit të procesit të rivlerësimit ndaj saj me anë të një vendimi të formës së prerë nuk ishin një mjet efektiv për të garantuar se çështja e saj do të gjykohej nga një "gjykatë e krijuar me ligj".

113. Në këto rrethana, kundërshtimi i Qeverisë duhet të lejohet dhe kjo pjesë e kërkesës duhet të rrëzohet për mosshfrytëzim të mjeteve vendëse sipas nenit 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës.

C. Ankesat në lidhje me pavarësinë dhe paanshmërinë e KPA-së

114. Qeveria parashtroi se kërkuesja nuk ishte ankuar për mungesë pavarësie dhe paanshmërie të KPA-së në vendimmarrjen ndaj çështjes së saj në procesin përpara gjykatës, dhe në këtë mënyrë nuk kishte shteruar mjetet vendëse për këtë aspekt sipas qëllimeve të nenit 35. Në vijim, Qeveria parashtroi se, për çdo rast, për sa i përket mënyrës së zgjedhjes, përbërjes dhe garancive procedurale, KPA-ja kishte përmbushur kërkesat për një gjykatë të pavarur dhe të paanshme. Shumica e anëtarëve të KPA-së, të përzgjedhur si gjyqtarë të nivelit të Gjykatës Kushtetuese nga Parlamenti shqiptar, në të shkuarën kishin ushtruar funksione gjyqësore.

115. Kërkuesja parashtroi se KPA-së i mungonte pavarësia dhe paanshmëria kryesisht për tri arsye: së pari, nuk kishte përfaqësim substancial të gjyqtarëve në KPA, dhe anëtarët e KPA-së nuk ishin mjaftueshëm të kualifikuar për të trajtuar proceset komplekse të rivlerësimit; së dyti, për sa ka të bëjë me procesin e emërimit, KPA-ja përbëhej nga anëtarë të përzgjedhur nga një organ parlamentar i posaçëm dhe të emëruar nga Parlamenti, pa përfshirjen e gjyqësorit, dhe për këtë arsye, ishin të ekspozuar ndaj presionit politik. Së treti, ekzistonte një konfuzion midis rolit të organeve të rivlerësimit në hetime dhe rolit të tyre në vendimin pasues për meritat e akuzave, gjë e cila krijonte pasiguri objektivisht të justifikueshme për paanshmërinë e KPA-së.

116. Edhe ndërhyrësi si palë e tretë, *Res Publica*, ishte i mendimit se anëtarët e organeve të rivlerësimit nuk kishin të gjithë trajnimin juridik dhe eksperiencën e nevojshme për të trajtuar procese disiplinore shumë komplekse ndaj gjyqtarëve.

117. Në vendimin e saj udhëheqës, në çështjen *Xhoxhaj* (cituar më sipër), Gjykata vendosi, së pari, se mospërfaqësimi i gjyqtarëve në detyrë në KPA, duke marrë në konsideratë natyrën e jashtëzakonshme të proceseve të rivlerësimit, ku shenjestrohen të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët në detyrë për të luftuar korrupsionin, si edhe masat statutore mbrojtëse për pavarësinë e anëtarëve të KPA, nuk përbënte mungesë pavarësie në atë kolegj (shih *Xhoxhaj*, cituar më sipër, §§ 314 dhe 316, lexuar së bashku me §§ 299–300). Së dyti, Gjykata arriti në përfundimin se përgjithësisht nuk kishte arsye për të dyshuar në pavarësinë e organeve të rivlerësimit duke iu referuar mënyrës së emërimit të anëtarëve të tyre, më konkretisht zgjedhja e tyre nga Parlamenti (ibid., §§ 311 dhe 295–96). Së treti, Gjykata arriti në përfundimin se, duke marrë në konsideratë funksionimin e proceseve të rivlerësimit, nuk kishte konfuzion midis detyrimit të organeve të rivlerësimit (dhe veçanërisht të KPK-së) për të nisur një hetim, dhe detyrës së tyre për të marrë një vendim për

përgjegjësinë disiplinore të personit të rivlerësuar, dhe për pasojë, nuk kishte pasiguri të justifikuara objektivisht në lidhje me paanshmërinë e organeve të rivlerësimit (shih *Xhoxhaj*, cituar më sipër, §§ 315 dhe 305–308).

118. Duke pasur parasysh këto konstatime, rrethanat e çështjes së kërkuesit dhe parashtrimet e saj, të cilat janë të krahasueshme me ato të bëra në çështjen *Xhoxhaj*, Gjykata, duke marrë në konsideratë edhe shterimin e mjeteve vendëse në këtë aspekt, gjykon se nuk rezulton të ketë mungesë të pavarësisë dhe paanshmërisë në KPA në rastin e çështjes së kërkueses.

119. Për pasojë, kjo pjesë e kërkesës duhet të kundërshtohet si qartazi e pambështetur në fakte, në mbështetje të nenit 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

D. Ankesë në lidhje me kohën e nevojshme dhe lehtësitë për të paraqitur çështjen

120. Në vijim, kërkuesja u ankua se kishte pasur mangësi të rënda procedurale në procesin e rivlerësimit ndaj saj. Veçanërisht, asaj nuk i ishte ofruar mjaftueshëm mundësi dhe kohë për ta paraqitur çështjen dhe provat e saj përpara KPA-së për të kundërshtuar shkarkimin.

121. Qeveria e kontestoi këtë qëndrim. Ajo parashtroi veçanërisht se kërkuesja kishte pasur mundësi ta paraqiste çështjen e saj, të caktonte dëshmitarë apo ekspertë dhe të dorëzonte prova të reja në seancat përpara KPA-së. Ajo nuk kishte kërkuar kohë shtesë apo shtyrje të seancës për të paraqitur argumentet e saj.

122. Në lidhje me këtë aspekt, Gjykata vëren se pas apelimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit të KPK-së, kërkueses i ishte ofruar akses në dosjen e çështjes dhe kishte pasur mundësi të bënte parashtrime dhe të paraqiste prova gjatë seancave dëgjimore publike përpara KPA-së (shih paragrafin 12 më sipër). Duke pasur parasysh materialet përpara saj, gjykata nuk gjen indicie se kërkuesja nuk pati kohën dhe lehtësitë për të paraqitur në mënyrën e duhur argumentet e saj.

123. Për këtë arsye, kjo pjesë e kërkesës duhet të kundërshtohet si qartazi e pambështetur në fakte, në mbështetje të nenit 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

E. Ankesë në lidhje me zbatimin e ligjit vendës

124. Kërkuesja u ankua edhe për faktin se KPA-ja kishte zbatuar ligjin vendës në një mënyrë dukshëm të gabuar. Qeveria e kontestoi këtë qëndrim.

125. Gjykata përsërit se nuk është detyra e saj të marrë rolin e gjykatave vendëse. Kryesisht u takon autoriteteve vendëse, veçanërisht gjykatave, të zgjidhin problemet me interpretimin e legjislacionit vendës. Roli i saj është të verifikojë nëse efektet e një interpretimi të tillë janë në përputhje me Konventën. Thënë kjo, me përjashtim të rasteve të një arbitrariteti të dukshëm, nuk është roli i Gjykatës që të verë në pikëpyetje interpretimin e ligjit vendës nga gjykatat vendëse (shih *Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë* [DHM], nr. 13279/05, §§ 49–50, 20 tetor 2011, në referenca të mëtejshme, dhe *Anđelković kundër Serbisë*, nr. 1401/08, § 24, 9 prill 2013).

126. Gjykata vëren se, teksa ajo ka konstatuar se zbatimi i ligjeve të rivlerësimit nga gjykatat vendëse në rrethanat e kësaj çështje çonin në shkelje të nenit 8 të Konventës (shih paragrafët 83–97 më sipër), ky zbatim nuk mund të konsiderohet si qartazi arbitrar.

127. Më tej, ajo vijon se kjo pjesë e kërkesës duhet të kundërshtohet si qartazi e pambështetur në fakte, në mbështetje të nenit 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

F. Ankesë në lidhje me barrën e provës

128. Në vijim, kërkuesi u ankua se barra e provës ndaj saj në procesin e rivlerësimit ishte e paarsyeshme.

129. Qeveria e kontestoi atë këndvështrim.

130. Për sa i përket ankesës së kërkueses, në lidhje me barrën e provës ndaj saj, Gjykata përsërit se neni 6 i Konventës nuk parashikon ndonjë rregull për pranueshmërinë e provave, apo për mënyrën se si provat duhet të vlerësohen, çka janë kryesisht çështje që duhet të rregullohen nga ligji vendës dhe gjykatat vendëse (shih, midis shumë autoriteteve të tjera, *García Ruiz kundër Spanjës* [DHM], nr. 30544/96, § 28, GJEDNJ 1999-I). U takon gjykatave vendëse të vlerësojnë relevancën e të dhënave të propozuara, vlerën e tyre provuese dhe barrën e provës (shih *Centro Europa 7 S.r.l. dhe Di Stefano*, cituar më sipër, § 198; *Lady S.R.L. kundër*

Republikës së Moldavisë, nr. 39804/06, § 27, 23 tetor 2018; dhe *Xhoxhaj*, cituar më sipër, § 325). Në vijim, ajo u referohet konstatimeve të saj në çështjen *Xhoxhaj,* se në përgjithësi, rregullat e barrës së provës në procedura sipas Ligjit të Rivlerësimit, duke përfshirë mungesën e kufijve të rreptë kohor për vlerësimin e pasurive, nuk paraqesin një shkelje të nenit 6 sipas aspektit të parimit të sigurisë ligjore, por se interpretimi i këtyre parashikimeve për siguri ligjore dhe të drejtat e një kërkuesi sipas nenit 6 § 1 duhet të shqyrtohen rast pas rasti (ibid., §§ 348–53).

131. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se ngjarjet në lidhje me punësimin e bashkëshortit të ardhshëm të ankueses në Greqi faktikisht kthehen ndjeshëm pas në kohë. Megjithatë, ato konsiderohen të provuara të paktën deri në një masë të caktuar. Në lidhje me ligjshmërinë e të ardhurave të bashkëshortit nga dy periudha punësimi në Arabinë Saudite, nuk duhet të konsiderohet e tepruar që kërkuesja, si prokurore me eksperiencë e krimeve financiare, pritej të tregonte se tatimi mbi të ardhurat ishte paguar në kohën përkatëse, sipas ligjeve tatimore shqiptare në vendin e origjinës (Arabia Saudite), në Shqipëri ose një kombinim i të dy vendeve – duke ruajtur dokumentacionin origjinal ose duke marrë verifikime të kohëve të fundit për pagesa të mëparshme të tatimeve. Për çdo rast, i takonte kërkueses të argumentonte, në përputhje me Ligjin e Rivlerësimit, se kishte qenë objektivisht e pamundur t'i merrte këto prova, për shembull, sepse të dhënat zyrtare ishin shkatërruar ndërkohë. KPA-ja nuk ishte bindur se kërkuesja e kishte përmbushur këtë barrë, dhe Gjykata nuk konstaton asnjë arsye për ta diskutuar këtë konstatim vendës.

132. Më tej ajo vijon se kjo pjesë e kërkesës duhet të kundërshtohet në të njëjtën mënyrë si qartazi e pambështetur në fakte, sipas nenit 35 §§ 3 (a) dhe 4 të Konventës.

IV. SHKELJE E PRETENDUAR E NENIT 13 TË KONVENTËS

133. Kërkuesja u ankua se ajo nuk kishte pasur një mjet efektiv në dispozicion për ankesat e saj në mbështetje të nenit 6 § 1 dhe nenit 8 të Konventës. Ajo u mbështet në nenin 13 të Konventës, i cili parashikon, si më poshtë:

"Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare."

134. Qeveria shprehu qëndrimin se kërkuesja kishte pasur një mjet efektiv për qëllime të nenit 13 për të ngritur ankesat e saj në mbështetje të neneve 6 dhe 8. Ajo kishte mundur t'i parashtronte këto ankesa fillimisht përpara KPK-së dhe më pas, përpara KPA-së.

135. Kërkuesja argumentoi se ajo nuk kishte pasur një mjet efektiv për të kundërshtuar shkeljen e të drejtave të saj themelore në procesin e rivlerësimit, sipas interpretimit të nenit 13, lexuar së bashku me nenet 6 dhe 8 të Konventës, sepse ajo nuk mund të kundërshtonte shkarkimin e saj përpara gjykatave vendëse apo të paraqiste një ankesë kushtetuese ndaj vendimit të KPA-së.

136. Edhe nëse prezumohet se kërkuesja kishte një "pretendim të argumentueshëm" për qëllimet e nenit 13 të Konventës, në të gjitha aspektet, Gjykata përsërit se nuk është e nevojshme që "autoriteti" referuar në nenin 13 të jetë një autoritet gjyqësor në të gjitha shkallët në kuptimin e ngushtë (shih *Rotaru kundër Rumanisë* [DHM], nr. 28341/95, § 69, GJEDNJ 2000-V, dhe *Driza kundër Shqipërisë*, nr. 33771/02, § 116, GJEDNJ 2007-V (ekstrakte)). Për çdo rast, siç edhe u vendos në çështjen *Xhoxhaj* (cituar më sipër, § 288), si KPK-ja dhe KPA-ja, një kolegj i posaçëm i Gjykatës Kushtetuese, ishin "gjykata", sipas qëllimeve të nenit 6. Kërkuesja ishte në pozitat për të ngritur ankesën e saj, në lidhje me nenet 6 dhe 8 përpara këtyre organeve të rivlerësimit.

137. Më tej ajo vijon se kjo pjesë e kërkesës është qartazi e pambështetur në fakte sipas kuptimit të nenit 35 § 3 (a) të Konventës dhe duhet të kundërshtohet në përputhje me nenin 35 § 4.

V. ZBATIMI I NENEVE 46 DHE 41 TË KONVENTËS

138. Pjesët përkatëse të nenit 46 të Konventës parashikojnë si më poshtë:

"1. Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të respektojnë vendimin e formës së prerë të Gjykatës në çdo çështje ku ato janë palë.

2. Vendimi i formës së prerë i Gjykatës i përcillet Komitetit të Ministrave, i cili mbikëqyr ekzekutimin e tij.

...”

139. Neni 41 i Konventës parashikon si më poshtë:

“Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe, nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar.”

A. Tregues për masat e përgjithshme dhe individuale

140. Kërkuesja mendonte, referuar nenit 46 § 1 të Konventës, se Shteti përgjegjës duhej të urdhërohej të korrigjonte papërshtatshmëritë themelore në legjislacionin vendës të rivlerësimit dhe të siguronte rikthimin e saj si prokurore dhe anëtare e KLP-së.

141. Qeveria argumentoi se parashikimet ligjore për rivlerësimin ishin në përputhje me Konventën. Gjithashtu, ajo parashtroi se duke qenë se kërkuesja nuk kishte përmbushur detyrimet e saj sipas Ligjit të Rivlerësimit, që përbënin edhe arsyet për nisjen e procedurave disiplinore ndaj saj, ajo nuk mund të rikthehej në detyrë.

142. Parimet e përgjithshme në lidhje me detyrimet e Shtetit të paditur sipas nenit 46 të Konventës në kontekstin e ekzekutimit të vendimeve ku Gjykata ka konstatuar shkelje të Konventës, përcaktohen, *inter alia*, në vendimin e Gjykatës në çështjen *Oleksandr Volkov* (cituar më sipër, §§ 193–95, me shumë referenca të tjera). Vendimet e Gjykatës janë kryesisht deklarative në natyrë. Neni 46 përfshin kryesisht detyrimin ligjor për të zgjedhur, nën mbikëqyrjen e Komitetit të Ministrave, masat e përgjithshme dhe/ose, nëse është me vend, individuale, që do të miratohen në urdhrin e tij juridik vendës për t’i dhënë fund shkeljes së konstatuar nga Gjykata dhe për të bërë të gjithë korrigjimin e mundshëm për pasojat në mënyrë të tillë që të rikthehet sa më shumë të jetë e mundur situata që ekzistonte përpara shkeljes (ibid.).

143. Gjykata shprehet se ka konstatuar një shkelje të së drejtës së kërkueses për të respektuar jetën e saj private sipas nenit 8 të Konventës për shkarkimin e saj, sepse, në rrethanat specifike të çështjes së saj, shkarkimi nuk ishte proporcional me qëllimet legjitime të ndjekura. Megjithatë, ajo nuk mendon se funksionimi i procesit aktual të rivlerësimit në përgjithësi në Shqipëri, mbështetur në Kushtetutë dhe në Ligjin e Rivlerësimit, paraqet problematika sistematike në respektimin e kërkesave të Konventës (shih tashmë *Xhoxhaj*, cituar më sipër, §§ 230 e në vijim). Për këtë arsye, Gjykata nuk e vlerëson si të nevojshme që ajo të përcaktojë në mënyrë përjashtimore ndonjë masë të përgjithshme që mund të ndërmerret për t’i dhënë fund shkeljes në fjalë (krahaso, *a contrario*, *Oleksandr Volkov*, cituar më sipër, §§ 199–202).

144. Për sa ka të bëjë me masat individuale që do të ishin më të përshtatshme për t’i dhënë fund shkeljes së konstatuar në çështjen konkrete, Gjykata përsërit se, në shumë çështje ku ishte konstatuar se procedurat vendëse shkelnin Konventën, ajo ka gjykuar se forma më e përshtatshme për korrigjimin e shkeljeve të konstatuara mund të ishte rihapja e procedurave vendëse (krahaso, për shembull, *Oleksandr Volkov*, cituar më sipër, §§ 205–206, në lidhje me një shkelje të neneve 6 dhe 8).

145. Duke iu referuar konstatimeve të saj në çështjen *Besnik Cani* (cituar më sipër, § 149), Gjykata konstaton se mund të ketë një rrugë ligjore për kërkuesen që të kërkojë rihapjen e procedurave pas konstatimit nga ana e Gjykatës së një shkeljeje të Konventës. Në këtë mënyrë, duke marrë në konsideratë rrethanat e çështjes konkrete dhe për sa mund të ishte e mundur sipas ligjit vendës, një formë e përshtatshme korrigjimi për shkeljen e të drejtës së kërkueses për respektim të jetës së saj private sipas nenit 8 të Konventës, do të ishte rihapja e procesit, nëse kërkuesja e kërkonte një rihapje të tillë, si edhe rishqyrtimi i çështjes në mënyrë të tillë që është në përputhje me parashikimet e nenit 8 të Konventës, ashtu siç përcaktohet në këtë vendim.

B. Dëmshpërblimi

146. Kërkuesja kërkoi, në lidhje me dëmin pasuror, shumat që përkonin me humbjen e pagës së saj si prokurore gjatë periudhës së shkarkimit të saj nga detyra më 28 shkurt 2019 deri në rikthimin e saj, paga e saj mujore bruto në vlerën ALL 281,078 (rreth 2,267 euro (EUR)). Nëse nuk rikthehej në detyrë, ajo kërkoi shumën

që përkonte me pagën që do të kishte fituar deri në moshën e pensionit dhe shumën që përkonte me pensionin e saj. Në vijim, ajo kërkoi që kjo shumë duhej të përshtatej me normën e inflacionit duke shtuar interesin dhe tatimet e pagueshme.

147. Në vijim, kërkuesja kërkoi 150,000 euro, plus çdo taksë që mund të ishte e tarifueshme për dëmin jopasuror shkaktuar nga ankthi, humbja e reputacionit dhe e mundësive që i kishte vuajtur si pasojë e shkarkimit të saj të menjëhershëm në kulmin e karrierës së saj ligjore si prokurore.

148. Qeveria parashtroi se kërkuesja nuk mund të pretendonte kompensim për humbjen e pagës pasi shkarkimi i saj nuk ishte në shkelje me Konventën. Në vijim, Qeveria parashtroi se pretendimi i saj për kompensim për dëmin jopasuror ishte i tepruar dhe i paargumentuar.

149. Gjykata vlerëson se kërkuesja filloi të praktikonte ligjin si avokate shumë shpejt pas shkarkimit të saj; megjithatë, kalimi i menjëhershëm në atë linjë të re pune nën ato rrethana duhet të ketë shkaktuar dëm pasuror. Duke bërë një vlerësim të drejtë dhe sipas të gjitha informacioneve në zotërimin e saj, Gjykata vlerëson si të arsyeshme që t'i akordojë kërkueses EUR 13,600 për dëm pasuror, plus çdo taksë që mund të jetë e tarifueshme për kërkuesen për atë shumë. Gjithashtu, ajo vlerëson se kërkuesja duhet të ketë pësuar dëm jopasuror, për të cilin konstatimi i shkeljes së Konventës në vendimin e Gjykatës nuk do të mjaftonte për korrigjim, dhe i akordon asaj EUR 6,000 (gjashtë mijë euro), plus çdo taksë që mund të jetë e tarifueshme për këtë shumë.

C. Kostot dhe shpenzimet

150. Pasi dorëzoi provat dokumentare, kërkuesja kërkoi edhe EUR 5,155 (duke përfshirë taksat) për kostot dhe shpenzimet e bëra përpara Gjykatës.

151. Qeveria parashtroi se, edhe nëse prezumohet se ka pasur një shkelje të Konventës, kostot dhe shpenzimet e pretenduara nga kërkuesja nuk ishin të nevojshme për kuant, duke pasur parasysh kostot dhe shpenzimet e zakonshme të një avokateje që e praktikon ligjin në Shqipëri.

152. Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës, një kërkues ka të drejtë të rimbursohet për kostot dhe shpenzimet vetëm për aq sa është provuar se këto kosto dhe shpenzime janë bërë aktualisht, kanë qenë të nevojshme dhe janë të arsyeshme për kuant. Në çështjen konkrete, për sa u përket dokumenteve që zotëron Gjykata si edhe kritereve të mësipërme, Gjykata e konsideron të arsyeshme që t'i akordojë kërkueses EUR 5,000 (duke përfshirë taksat) për procesin përpara Gjykatës.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA

1. E deklaron, unanimisht, të pranueshme ankesën për shkarkimin e kërkueses në mbështetje të nenit 8 të Konventës;

2. E deklaron, me shumicë, pjesën tjetër të kërkesës të papranueshme;

3. Gjykon, unanimisht, se është shkelur neni 8 i Konventës për sa i përket shkarkimit të kërkueses;

4. Gjykon, unanimisht,

a) se Shteti përgjegjës duhet t'i paguajë kërkueses, brenda tre muajve nga data në të cilën vendimi bëhet i formë së prerë, në përputhje me nenin 44 §§ 2 të Konventës, shumat e mëposhtme, që duhet të konvertohen në monedhën e Shtetit përgjegjës në normën e zbatueshme në datën e pagesës;

i. EUR 13,600 (trembëdhjetë mijë e gjashtëqind euro), plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kërkueses, në lidhje me dëmin pasuror;

ii. EUR 6,000 (gjashtë mijë euro), plus çdo taksë që mund të tarifohet, për dëmin jopasuror;

iii. EUR 5,000 (pesë mijë euro) për kostot dhe shpenzimet;

b) se nga përfundimi i periudhës së sipërpërmendur tremujore deri në pagesë, interesi i thjeshtë duhet të paguhet për shumat e mësipërme në një normë të barabartë me normën margjinale huadhënëse të Bankës Qendrore Evropiane plus tre pikë përqindje;

5. Rrëzon, unanimisht, pjesën tjetër të kërkesës së kërkueses për shpërblim të drejtë.

Hartuar në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më datë 13 dhjetor 2022, sipas Rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Pere Pastor Vilanova
KRYETAR

Milan Blaško
SEKRETAR

Në përputhje me nenin 45 § 2 të Konventës dhe Rregullit 74 § 2 të Rregullores së Gjykatës, opinioni i veçantë i Gjyqtarit Serghides i aneksohet këtij vendimi.

P.P.V.
M.B.

OPINIONI PJESËRISHT MOSPAJTUES I GJYQTARIT SERGHIDES

1. Unë jam dakord me paragrafin 1 të masave operative të vendimit ku gjykohet se ankesa – sipas nenit 8 të Konventës, për sa ka të bëjë me shkarkimin nga detyra të kërkueses si prokurore – është e pranueshme; dhe, gjithashtu, unë jam dakord me paragrafin 3 të masave operative se me shkarkimin e kërkueses është shkelur neni 8 i Konventës. Gjithashtu, unë jam dakord me paragrafin 4 të masave operative, në lidhje me akordimet për dëmin pasuror dhe jopasuror dhe kostot dhe shpenzimet, dhe me paragrafin 5 të masave operative në lidhje me rrëzimin e pjesës tjetër të kërkesës së kërkueses për shpërblim të drejtë.

2. Megjithatë, nuk jam dakord me paragrafin 2 të masave operative të vendimit sipas së cilit pjesa tjetër e kërkesës është e papranueshme. Veçanërisht, unë jam i mendimit se ankesa sipas nenit 6 të Konventës jo vetëm që është e pranueshme, por madje ky nen është shkelur pasi procesi i rivlerësimit i cili rezultoi në largimin e kërkueses nga pozicioni i saj si prokurore nuk ishte i drejtë sipas kuptimit të nenit 6 § 1.

3. Ky opinion merr formën e një deklarate mosdakordësie me vendimin ("një deklaratë e drejtpërdrejtë mospajtimi"), në lidhje me paragrafin 2 të masave të tij operative (në lidhje me ankesën sipas nenit 6 të Konventës), dhe për këtë arsye, nuk merr formën e një opinioni të veçantë të plotë apo formën e një vote të thjeshtë anonime kundër këtyre paragrafëve. Një deklaratë e thjeshtë mosdakordësie me vendimin ose me një pjesë të tij është një zgjedhje alternativ e parashikuar nga Rregulli 74 § 2 i Rregullores së Gjykatës për gjyqtarët të cilët dëshirojnë të shprehin mospajtim. Kjo zgjedhje është veçanërisht e përshtatshme për mua për t'u bërë për çështjen konkrete, pasi unë kam shprehur mendimet e mia për dy kërkesa të ngjashme ose relevante kundër Shqipërisë (shih, *mutatis mutandis*, qasjen time në opinionin tim mospajtues në vendimin *Xhoxhaj kundër Shqipërisë*, nr. 15227/19, 9 shkurt 2021, dhe opinionin tim pjesërisht pajtues dhe pjesërisht mospajtues në vendimin *Besnik Cani kundër Shqipërisë*, nr. 37474/20, 4 tetor 2022 (i cili nuk është ende i formës së prerë)).

VENDIM
Nr. 10, datë 7.3.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Marsida Xhaferllari	kryesuese;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahimi	anëtar;
Marjana Semini	anëtare,

me sekretare Blerina Basha, në datën 7.3.2023 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 3 (N) 2022 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Ndue Gjeta

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, Tiranë

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 00-2022-738, datë 26.4.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë; nr. 965, datë 12.5.2015, të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 1125, datë 20.3.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Dhënia e pensionit të pleqërisë dhe e pensionit suplementar si ushtarak në përputhje me legjislacionin e kohës.

BAZA LIGJORE: Nenet 3, 4, pikat 1 dhe 2, 5, 15, pika 1, 18, pikat 1 dhe 2, 44, 52, pika 2, 122, pikat 1 dhe 2, 131, shkronjat "a" dhe "f", 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, 141, pika 2 dhe 155 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6, 13 dhe 14 të Konventës Evropiane për

të Drejtat e Njeriut; nenet 27, 45, 49, pika 3, shkronjat "c" dhe "e" dhe 80, pika 1, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuesit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjekteve të interesuara, Institutit të Sigurimeve Shoqërore (*ISSH*) dhe Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore *(DRSSH*), Tiranë, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Ndue Gjeta ka ushtruar detyrën e ushtarakut në strukturat e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, për periudhën 30.12.1970–1.8.2003, pas së cilës ka dalë në rezervë dhe është trajtuar me pagesë kalimtare për dy vjet. Prej datës 1.8.2005 ai ka përfituar pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi në masën fillestare 15,693 lekë në muaj.

2. Kërkuesi ka ngritur padi në gjykatë për kundërshtimin e mënyrës së llogaritjes dhe masës së pensionit të parakohshëm. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 684, datë 6.2.2007, ka vendosur rrëzimin e padisë. Mbi ankimin e kërkuesit, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 899, datë 8.5.2008, ka vendosur ndryshimin e vendimit dhe detyrimin e DRSSH-së, Tiranë të rillogarisë masën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, si dhe t'i paguajë kërkuesit diferencën e masës së këtij pensioni prej datës 1.8.2005 e në vazhdim. Rekursi i ushtruar nga DRSSH-ja, Tiranë nuk është pranuar nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2011-96, datë 4.3.2011. Sipas kërkuesit, vendimi gjyqësor përfundimtar i vitit 2008 është ekzekutuar dhe ai ka përfituar pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi në vlerën 57,593 lekë, të llogaritur mbi pagën referuese 74,743 lekë.

3. Në vijim, DRSSH-ja, Tiranë me vendimin nr. 2405, datë 19.8.2010, i ka caktuar kërkuesit pension të plotë pleqërie në vlerën 20,189 lekë, kategoria e dytë si ushtarak për një periudhë sigurimi prej 37 vjetësh e 8 muajsh, duke filluar prej datës 8.2.2010. Ky vendim është nxjerrë bazuar në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 7703/1993*). Caktimi i masës së pensionit të pleqërisë ka ndikuar në masën e pensionit suplementar të pleqërisë në vlerën 10,276 lekë, pasi sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm", të ndryshuar (*ligji nr. 10142/2009*), pensioni suplementar është përfitim shtesë që jepet mbi pensionin e pleqërisë dhe llogaritet me 1% të pagës mesatare referuese mujore për çdo vit shërbimi, por jo më shumë se 50% e pensionit të pleqërisë, që përfituesi gëzon në çastin e lindjes së të drejtës për pension suplementar (*nenet 1, 4, 15 dhe 16*).

4. Me kërkesë të kërkuesit, DRSSH-ja, Tiranë me vendimin nr. 2405/1, datë 11.4.2011, ka rishqyrtuar pensionin e pleqërisë nga data 8.2.2010, mbi bazën e koeficienteve të vitit 2010, sipas nenit 59, pika 3, të ligjit nr. 7703/1993 dhe ka vendosur se kërkuesi përfiton masën e pensionit maksimal të pleqërisë në shkallë vendi në vlerën 20,552 lekë, duke përfituar njëkohësisht edhe pensionin suplementar të pleqërisë sipas ligjit nr. 10142/2009 në masën 50% të pensionit të pleqërisë. Për rrjedhojë, kërkuesi deklaron se ka përfituar 30,828 lekë si shumë e të dy lloj pensioneve.

5. Kërkuesi, me pretendimin se DRSSH-ja, Tiranë ka vepruar në kundërshtim me ligjin, ka ngritur padi në gjykatë, me objekt kundërshtimin e masës së pensionit të pleqërisë, pagimin e diferencave nga zbatimi i keq i ligjit prej datës 8.2.2010, si dhe pagimin e pensionit suplementar të pleqërisë sipas ligjit nr. 9210, datë 18.3.2004, "Për statusin e ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*ligji nr. 9210/2004*) dhe ligjit nr. 9418,

datë 20.5.2005, "Për sigurimet shoqërore suplementare të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë". Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 9015, datë 11.11.2011, e ka nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit gjyqësor. Mbi ankimin e veçantë të kërkuesit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 7, datë 10.1.2012, e ka prishur vendimin dhe e ka dërguar çështjen në gjykatën e shkallës së parë për vazhdimin e gjykimit.

6. Në vijim, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 782, datë 24.1.2014, ka deklaruar moskompetencën lëndore dhe ia ka dërguar aktet Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila, me vendimin nr. 1125, datë 20.3.2014, ka vendosur rrëzimin e padisë. Sipas gjykatës, e drejta për të përfituar pension të plotë pleqërie kërkuesit i ka lindur në datën 8.2.2010, ndaj në rastin e tij zbatohej ligji nr. 10142/2009, efektet e të cilit kanë nisur të zbatohen në datën 1.7.2009. Për rrjedhojë, kërkuesi nuk mund të pretendojë përllogaritjen e pensioneve sipas nenit 11 të ligjit nr. 8087, datë 13.3.1996, "Për sigurimet shoqërore suplementare të Ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë" (*ligji nr. 8087/1996*), të ndryshuar me ligjin nr. 8521, datë 30.7.1999 (*ligji nr. 8521/1999*) dhe nenit 48 të ligjit nr. 9210/2004, të cilat zbatimin dhe efektet e tyre ligjore i shtrinin deri në datën 30.6.2009.

7. Ndonëse kërkuesi ka paraqitur ankim, vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. 965, datë 12.5.2015, por me arsyetim të ndryshëm. Ajo gjykatë ka vënë në dukje se është i pabazuar në ligj shkaku i ngritur në ankim prej kërkuesit se pensioni i pleqërisë nuk duhej llogaritur sipas ligjit nr. 7703/1993. Të gjitha llojet e pensioneve të pleqërisë llogariten sipas skemave të parashikuara në këtë ligj, ndërsa ish-ushtarakët trajtohen edhe me pension suplementar të llogaritur mbi atë të pleqërisë, sipas skemave të parashikuara në legjislacionin e posaçëm për këtë qëllim. Sipas gjykatës, kërkuesi nga data 8.2.2010 përfiton pension maksimal pleqërie në shkallë vendi në vlerën 20,552 lekë, duke përfituar njëkohësisht, sipas ligjit, edhe pensionin suplementar të pleqërisë në masën maksimale të gjysmës së pensionit të pleqërisë.

8. Në vijim, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (*Gjykata e Lartë*), me vendimin nr. 00-2022-738, datë 26.4.2022, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, duke vlerësuar se ai nuk përmbante shkaqet e parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*). Gjykata e Lartë ka evidentuar në vendim se të gjitha shkaqeve të parashtruara në rekurs, iu është dhënë përgjigje në mënyrë shteruese nga ana e Gjykatës Administrative të Apelit, e cila ka analizuar në mënyrë të hollësishme ligjet nr. 7703/1993 dhe nr. 10142/2009, në përputhje edhe me jurisprudencën e Gjykatës së Lartë.

9. Në datën 29.8.2022 kërkuesi ka paraqitur ankim në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*) për shfuqizimin e vendimeve të dhëna nga gjykatat e të tria niveleve, si të papajtueshme me Kushtetutën, si dhe pagesën e pensionit të pleqërisë dhe pensionit suplementar si ushtarak në përputhje me ligjin material të kohës. Kolegji i Gjykatës në datën 2.11.2022, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II
Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. *Kërkuesi*, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se vendimet e kundërshtuara kanë cenuar:

10.1 *Të drejtën për një proces të rregullt ligjor,* të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

10.1.1 *Parimit të sigurisë juridike*, pasi gjykatat ishin para detyrimit të zbatimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë për pagën referuese prej 74,743 lekësh, mbi të cilën duhej llogaritur pensioni i pleqërisë. Paga referuese është një e drejtë e fituar gjyqësisht prej kërkuesit dhe nuk mund të preket. Të drejtat financiare të ushtarakëve kanë qenë objekt gjykimi nga Gjykata, e cila ka theksuar se skema e sigurimeve shoqërore bazë nuk duhet të pësojë ndryshime përkeqësuese për individin. Gjykata e Lartë ka dalë edhe kundër vendimeve të saj të mëparshme, duke vepruar me dy standarde. Për

rrjedhojë, janë cenuar edhe *parimet e pritshmërisë së ligjshme, barazisë në të drejta* dhe *gjësë së gjykuar.*

10.1.2 *Gjykimit të drejtë,* pasi shqyrtimi i çështjes duhej të bëhej në bazë të provave që ekzistonin në datën 8.2.2010, me pagë referuese 74,743 lekë, me të cilën kërkuesi ka dalë në rezervë. Gjykatat nuk kanë zbatuar vendimin unifikues nr. 3, datë 6.12.2013, të Gjykatës së Lartë dhe nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, pasi nuk janë shprehur për mosrespektimin e ligjit nga DRSSH-ja, Tiranë.

10.1.3 *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi gjykatat kanë pranuar pretendimet e DRSSH-së, Tiranë pa ballafaquar kërkesat e ligjit me provat. Vendimet gjyqësore të dhëna për kërkuesin janë kontradiktore dhe të paplota.

10.1.4 *Së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm,* pasi procesi gjyqësor ka zgjatur 11 vjet e 13 ditë, prandaj, në zbatim të nenit 71/ç të ligjit nr. 8577/2000 i takon dhënia e dëmshpërblimit të drejtë.

10.2 *Parimit të barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit,* të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi gjykatat kanë mohuar në mënyrë arbitrare të gjitha përfitimet që i njeh ligji si ushtarak, sikurse përfitojnë të gjithë ushtarakët e tjerë për natyrën e veçantë të shërbimit.

10.3 *Së drejtës së pensionit,* të garantuar nga neni 52 i Kushtetutës, pasi gjykatat nuk kanë respektuar formulat e parashikuara nga ligji dhe vendimmarrjet e Gjykatës. Cenimi i pensionit të pleqërisë ka cenuar edhe pensionin suplementar, i cili llogaritet në masën 50% të pensionit të pleqërisë. Vendimet e kundërshtuara cenojnë parimin e hierarkisë së normave në kuptimin e ligjit të zbatueshëm. Po kështu, është cenuar edhe e drejta për të jetuar, pasi kërkuesi është dëmtuar, denigruar dhe lënë në pozita të vështira jetese.

11. *Subjektet e interesuara,* ISSH-ja dhe DRSSH-ja, Tiranë nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim, edhe pse janë njoftuar rregullisht.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

12. Çështja e legjitimimit të subjekteve *(locus standi)* që mund t'i drejtohen Gjykatës është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

13. Gjykata çmon se kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pikat 1, shkronja "i" dhe 2, të Kushtetutës. Ai ka qenë palë në procesin gjyqësor, në të cilin është vendosur për të drejtën dhe masën e pensionit të pleqërisë së tij, ndaj ka interes të drejtpërdrejtë për çështjen e parashtruar.

14. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka funksion përfundimtar dhe, si e tillë, mund të aplikohet vetëm në lidhje me vendime për të cilat kanë përfunduar procedurat gjyqësore. Kontrolli kushtetues ka natyrë subsidiare, që do të thotë se individi duhet t'i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore (*shih vendimet nr. 14, datë 21.6.2022; nr. 14, datë 11.3.2021; nr. 17, datë 16.5.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Në thelb, ky rregull synon t'u japë organeve publike dhe, në veçanti, gjykatave të juridiksionit të zakonshëm mundësinë të parandalojnë ose korrigjojnë në substancë shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese të individit. Ana tjetër e rregullit të shterimit të mjeteve juridike përfshin detyrimin e vetë individit që të tregojë kujdesin dhe vëmendjen e duhur për të paraqitur kërkesa, kundërshtime ose ankime te organet publike dhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për rrethanat që mbështesin pretendimet për cenimin e të drejtave

kushtetuese (*shih vendimin nr. 25, datë 13.10.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në çështjen konkrete, Gjykata konstaton se kërkuesi ka pretenduar, ndër të tjera, se i është cenuar e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, për shkak se procesi gjyqësor ka zgjatur 11 vjet e 13 ditë. Kështu, gjykimi në gjykatën e shkallës së parë ka zgjatur 2 vjet, 11 muaj e 14 ditë, gjykimi në apel ka zgjatur 1 vit, 2 muaj e 18 ditë dhe gjykimi i rekursit ka zgjatur 7 vjet, 2 muaj e 16 ditë, prandaj, në zbatim të nenit 71/ç të ligjit nr. 8577/2000 i takon dhënia e dëmshpërblimit të drejtë.

16. Në datën 8.3.2022, kërkuesi ka paraqitur kërkesë me shkrim në Gjykatën e Lartë për "*afrimin e gjykimit të çështjes për masën e pensionit të pleqërisë*". Në datën 29.3.2022, Gjykata e Lartë, në zbatim të nenit 482, pika 4, të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*), ka urdhëruar përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes jo më vonë se muaji prill i vitit 2022. Në vijim, relatori i çështjes ka caktuar datën 26.4.2022 për shqyrtimin e rekursit në dhomë këshillimi, datë në të cilën Gjykata e Lartë ka disponuar vendimin e kundërshtuar në ankimin kushtetues.

17. Gjykata evidenton se me ndryshimet që i janë bërë KPC-së me ligjin nr. 38/2017, hyrë në fuqi më 5.11.2017, është përcaktuar, ndër të tjera, se cilat konsiderohen afate të arsyeshme (*neni 399/2*), cili konsiderohet shpërblim i drejtë (*neni 399/3*), cila është gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes dhe përshpejtimin e procedurave (*nenet 399/4 dhe 399/6*), përfshirë rregullat për gjykimin e kërkesës (*neni 399/7*). Në këtë mënyrë, ligji procedural ka parashikuar mjete ligjore/instrumente efektive për t'i garantuar individit mbrojtjen e së drejtës për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm, të cilat sipas jurisprudencës së kësaj Gjykate, në parim, janë efektive, ndërsa në praktikë efektiviteti i tyre duhet shqyrtuar nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret *(shih vendimet nr. 3, datë 17.2.2022; nr. 2, datë 17.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese).*

18. Në rastin në shqyrtim, kërkuesi nuk i ka përdorur këto mjete ligjore të parashikuara nga nenet 399/1 e vijuese të KPC-së për të mbrojtur të drejtën kushtetuese të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm dhe për të kërkuar shpërblim dëmi, ndaj ky pretendim i tij nuk mund të merret në shqyrtim. Për më tepër, kërkesa e tij për "afrimin" e datës së shqyrtimit të rekursit ka rezultuar efektive, pasi Gjykata e Lartë është vënë në lëvizje dhe ka disponuar me vendim përfundimtar. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se kërkimi për shpërblim të drejtë, i mbështetur në nenin 71/ç të ligjit nr. 8577/2000, është i pabazuar, pasi kjo dispozitë ligjore lidhet me procesin e gjykimit kushtetues dhe tejzgjatjen e tij.

19. Për sa u takon pretendimeve të tjera, në kushtet kur kërkuesi i ka parashtruar ato përpara gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, Gjykata çmon se është plotësuar kriteri i shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion.

20. Kërkuesi legjitimohet *ratione temporis*, pasi ankimi kushtetues individual është dërguar nëpërmjet shërbimit postar në datën 26.8.2022, pra brenda afatit 4-mujor nga dhënia e vendimit të Gjykatës së Lartë në datën 26.4.2022, sipas përcaktimit të nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 8577/2000.

21. Në drejtim të kriterit të legjitimimit *ratione materiae*, kërkuesi kundërshton masën e pensionit të pleqërisë të caktuar nga DRSSH-ja, Tiranë nga e cila varet edhe masa e pensionit suplementar të pleqërisë. Sipas tij, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm i kanë cenuar të drejtën kushtetuese të pensionit, të garantuar nga neni 52 i Kushtetutës, pasi gjykimi nuk ishte i drejtë. Në funksion të këtij pretendimi, kërkuesi argumenton se gjykatat kanë cenuar parimet dhe të drejtat kushtetuese që lidhen me procesin e rregullt ligjor në aspektet e sigurisë juridike, pritshmërive të ligjshme, barazisë në të drejta, gjësë së gjykuar, gjykimit të drejtë dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, si dhe me barazinë para ligjit dhe mosdiskriminimit, të garantuar respektivisht nga nenet 42 dhe 18 të Kushtetutës.

22. Lidhur me pretendimin për cenimin e parimit të barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit, të garantuar nga neni 18 i Kushtetutës, kërkuesi ka argumentuar se, në ndryshim nga ushtarakët e tjerë, në rastin e tij gjykatat, me vendimet gjyqësore të kundërshtuara, kanë mohuar në mënyrë arbitrare të gjitha përfitimet e statusit të ushtarakut që atij ia njeh ligji. Gjykata konstaton se në procesin gjyqësor të kundërshtuar prej kërkuesit gjykatat e

juridiksionit të zakonshëm kanë zgjidhur mosmarrëveshjen për pensionin e pleqërisë së tij, pa i mohuar ose pakësuar masën e ndonjë përfitimi të statusit të ushtarakut. Ndonëse kërkuesi ka kundërshtuar krahas masës së pensionit të pleqërisë, edhe atë të pensionit suplementar, si pjesë e përfitimeve të statusit të ushtarakut, gjykatat janë shprehur për këtë të fundit se ai llogaritet sipas legjislacionit përkatës për këtë qëllim. Në këtë situatë, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk ka parashtruar argumente kushtetuese konkrete dhe të mjaftueshme që të mbështesin pretendimin për cenimin e parimit të barazisë para ligjit dhe mosdiskriminimit, ndaj ai nuk është ngritur në nivel kushtetues dhe nuk mund të merret në shqyrtim.

23. Ndërsa për sa u takon pretendimeve të tjera, në kushtet kur thelbi i argumenteve ka të bëjë me mënyrën se si gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë arsyetuar vendimmarrjen e tyre pa marrë në konsideratë rrethanat e rastit konkret, Gjykata do t'i trajtojë ato në këndvështrim të parimit të sigurisë juridike të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, si dhe të së drejtës substanciale për pension pleqërie. Në këtë drejtim, Gjykata çmon se këto pretendime hyjnë në juridiksionin dhe kompetencën e Gjykatës, ndaj në vijim do të analizohet bazueshmëria e tyre në themel.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e parimit të sigurisë juridike të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

24. Kërkuesi pretendon se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm me arsyetimin e tyre kanë cenuar parimin e sigurisë juridike, në aspektin e gjësë së gjykuar, pasi e kanë përllogaritur masën e pensionit të pleqërisë mbi bazën e një page referuese të ndryshme nga ajo prej 74,743 lekësh e përcaktuar me vendimin gjyqësor përfundimtar të vitit 2008, ndaj paga referuese përbënte të drejtë të fituar. Ndonëse kërkuesit i takonte të merrte pension pleqërie në masën 43,195 lekë dhe pension suplementar të pleqërisë në masën 21,597.5 lekë, gjykatat lanë në fuqi llogaritjet e DRSSH-së, Tiranë respektivisht në vlerat 20,552 lekë dhe 10,276 lekë. Për rrjedhojë, kërkuesi përfiton pension pleqërie dhe suplementar të pleqërisë, gjithsej 30,828 lekë, që bie në kontradiktë dhe është më e ulët sesa masa e pensionit të parakohshëm prej 57,593 lekësh të përfituar prej tij. Paga bazë mbi të cilën u përllogarit pensioni i pleqërisë ishte e ndryshme edhe nga paga bruto edhe nga paga neto në periudhën që kërkuesi ka shërbyer në Forcat e Armatosura.

25. Gjithashtu, ai pretendon se është cenuar parimi i sigurisë juridike në aspektin e mosrespektimit të vendimeve të kësaj Gjykate, e cila në vendimet nr. 9, datë 26.2.2007 dhe nr. 33, datë 24.6.2010 ka kontrolluar kushtetutshmërinë e ligjeve që trajtojnë përfitimet suplementare të ushtarakëve dhe ka theksuar se skema e sigurimeve shoqërore nuk duhet të ndryshojë për të përkeqësuar ndjeshëm jetesën e shtetasve që përfitojnë këtë sigurim. Parimi i sigurisë juridike është cenuar edhe për shkak të mosrespektimit të qëndrimit të mbajtur nga Gjykata në vendimet nr. 24, datë 12.11.2008 dhe nr. 21, datë 16.4.2015, në të cilat është pohuar se mosrespektimi i vendimeve përfundimtare gjyqësore cenon parimin e gjësë së gjykuar, gjë e cila sjell edhe cenimin e vetë sigurisë juridike. Sipas tij, Gjykata e Lartë ka arsyetuar në të kundërt me vendimet e mëparshme që u përkisnin palëve të tjera ndërgjyqëse. Po kështu, kërkuesi ka pretenduar se vendimet gjyqësore, objekt kundërshtimi në këtë ankim kushtetues, janë kontradiktore dhe të paplota.

26. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar vazhdimisht rëndësinë e parimit të sigurisë juridike, si një nga aspektet themelore të shtetit të së drejtës, duke e parë të lidhur me parimin *res judicata*, sipas të cilit vendimi gjyqësor i formës së prerë është shprehje dhe konkretizim i së drejtës mbi marrëdhënien juridike dhe ka qëllim t'i japë jo vetëm qartësi, por edhe siguri kësaj marrëdhënieje. Cenimi i parimit të gjësë së gjykuar do të çonte në cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues e ligjorë të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, pra në cenim të vetë sigurisë juridike (*shih vendimet nr. 22, datë 29.9.2022; nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 50, datë 3.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Vendimi gjyqësor i formës së prerë është i detyrueshëm për palët, trashëgimtarët e tyre, për personat që tërheqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin, si dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Sipas Gjykatës, parimi i gjësë së gjykuar është element themelor i gjykimit të

drejtë (*shih vendimet nr. 81, datë 18.12.2017; nr. 10, datë 13.2.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Për sa u përket të drejtave të fituara si element i parimit të sigurisë juridike, Gjykata është shprehur se çdo proces ku vihen në dyshim të drejtat e fituara, nuk mund të konsiderohet se qëndron jashtë nocionit të "procesit të rregullt", përderisa diskutohet e vendoset lidhur me këto të drejta të fituara. Ky parim është i detyrueshëm të respektohet në të gjitha fazat e një procesi ku pretendohet cenimi i të drejtave të fituara dhe siguria juridike që rrjedh prej tyre (*shih vendimet nr. 22, datë 29.9.2022; nr. 10, datë 13.2.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Lidhur me detyrueshmërinë e jurisprudencës kushtetuese, Gjykata ka theksuar se nenet 124 dhe 132 të Kushtetutës shprehen qartësisht për forcën detyruese që vendimet e saj kanë mbi të gjitha organet kushtetuese, autoritetet publike, duke përfshirë edhe gjykatat. Zbatimi i vendimeve të Gjykatës është detyrim kushtetues. Ato kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Si të tilla, përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe, për rrjedhojë, kanë efektet e forcës së ligjit. Ky efekt detyrues ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit. Efekti detyrues shtrihet tek argumentet thelbësore të vendimit, që përbëjnë edhe *ratio decidendi*, eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë (*shih vendimet nr. 33, datë 14.11.2022; nr. 17, datë 30.3.2021; nr. 10, datë 4.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Ndërsa për të drejtën e një vendimi gjyqësor të arsyetuar, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës, Gjykata ka theksuar se është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre *(shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 3, datë 20.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Po kështu, Gjykata ka pohuar se vendimet e mospranimit të rekursit të Gjykatës së Lartë mund të arsyetohen në mënyrë të kufizuar, me kusht që në pjesën hyrëse të listohen shkaqet e rekursit. Ky arsyetim i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa, në thelb, shpreh shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjeve të saj gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit *(shih vendimet nr. 2, datë 11.2.2021; nr. 21, datë 16.4.2015; nr. 37, datë 19.9.2011, të Gjykatës Kushtetuese).*

30. Në çështjen konkrete, Gjykata vëren se kërkuesi në datën 8.2.2010 ka mbushur moshën 63 vjeç dhe i është caktuar pension pleqërie i plotë për periudhën e sigurimit prej 37 vjetësh e 8 muajsh, në masën 20,189 lekë, kategoria e dytë si ushtarak. Masa e pensionit është rillogaritur me koeficientet e vitit 2010 dhe përfundimisht, kërkuesit i është caktuar pensioni maksimal i pleqërisë në shkallë vendi në masën 20,552 lekë. Përllogaritja e pensionit nga DRSSH-ja Tiranë është kontrolluar në rrugë gjyqësore dhe është vlerësuar në përputhje me ligjin. Konkretisht, Gjykata Administrative e Apelit ka ndryshuar arsyetimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe ka argumentuar se pensioni i pleqërisë llogaritet mbi bazën e skemave ligjore të parashikuara në ligjin nr. 7703/1993, ndaj ligjet e veçanta për përfitimet suplementare të statusit të ushtarakut nuk janë të zbatueshme për këtë lloj pensioni. Gjykata e Lartë në vendimin e mospranimit të rekursit është shprehur se Gjykata Administrative e Apelit ka analizuar në mënyrë të hollësishme dispozitat e ligjeve nr. 7703/1993 dhe nr. 10142/2009.

31. Gjykata konstaton se kërkuesit i është njohur e drejta e përfitimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi me vendim gjyqësor përfundimtar të vitit 2008 dhe si rezultat i ekzekutimit të tij, atij i është caktuar masa e pensionit të parakohshëm 57,593 lekë, e llogaritur mbi pagën referuese 74,743 lekë. Vendimi gjyqësor i vitit 2008 ka pasur në objekt të drejtën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, që përbën një prej përfitimeve suplementare të ushtarakëve. Në këtë mënyrë, në dhënien e vendimit përfundimtar të vitit 2008, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë përcaktuar faktin se kërkuesi kishte qenë ushtarak dhe kishte dalë në pension të parakohshëm në datën 1.8.2005 dhe e kanë

zgjidhur mosmarrëveshjen, duke zbatuar dhe interpretuar ligjin nr. 8087/1996 (*sipas ndryshimeve në kohën e përfitimit të së drejtës*) dhe ligjin nr. 9210/2004 (*për statusin e ushtarakut*).

32. Duke iu referuar përmbajtjes së ligjit nr. 8087/1996 në vitin 2005, Gjykata vëren se ushtaraku që dilte në rezervë ose lirim pas datës 3.7.1991, gëzonte të drejtën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi deri në plotësimin e kushteve për pension të plotë pleqërie. Kjo e drejtë varej nga vitet e vjetërsisë së shërbimit si ushtarak (sipas gjinisë), ndërsa masa caktohej: (a) 50 për qind të pagës referuese mbi të cilën ishte derdhur kontributi; (b) për çdo vit tjetër të vjetërsisë së shërbimit, masa e pensionit shtohej me 2 për qind të pagës referuese (*neni 11*). Sipas këtij ligji, "paga referuese" është paga bazë për funksionin dhe shpërblimi për gradën ushtarake në kohën e daljes në rezervë ose lirim. Në rastin e kërkuesit, si ushtarak që ka dalë në rezervë pas hyrjes në fuqi të ligjit ndryshues nr. 8521/1999, paga bazë ishte ajo e kohës së lindjes së të drejtës së përfitimit (*neni 7*). Në të njëjtën linjë, ligji nr. 9210/2004 (*për statusin e ushtarakut*), parashikonte të drejtën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi për ushtarakët me vjetërsi shërbimi të paktën 15 vjet për burrat dhe 12 vjet për gratë, si pjesë të statusit të ushtarakut, në masën 50 për qind të pagës mujore deri në plotësimin e kushteve për përfitimin e pensionit të pleqërisë, duke përcaktuar se për çdo vit tjetër shërbimi mbi kufirin e vjetërsisë, jepej një shtesë pensioni në masën 2 për qind të pagës mujore (*neni 35*).

33. Ndërkohë, në procesin gjyqësor të përfunduar në vitin 2022, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm me vendimet e kundërshtuara në ankimin kushtetues kanë zgjidhur mosmarrëveshjen për masën e pensionit të pleqërisë, bazuar në ligjin nr. 7703/1993, sikundër edhe për masën e pensionit suplementar të pleqërisë bazuar në ligjin nr. 10142/2009. Ligji nr. 7703/1993, në kohën e daljes në pension pleqërie të kërkuesit, parashikonte se personat e siguruar kanë të drejtë për pension pleqërie të plotë me mbushjen e një moshe të caktuar dhe plotësimin e viteve të duhura të sigurimit (*nenet 31 dhe 92*). Pensioni mujor i pleqërisë përbëhet nga: i. shuma bazë, e cila duhet të sigurojë standardin minimal të jetesës; ii. dhe shtesa 1 për qind për vit sigurimi, e përllogaritur mbi bazën mesatare të vlerësueshme nëpërmjet kontributeve dhe e indeksueshme çdo vit (*neni 32*). Ndërkohë, baza e vlerësuar për llogaritjen e pensioneve llogaritet si raport i shumës së pagave, për të cilat janë paguar kontributet, me periudhën që njihet si periudhë sigurimi. Ligji përcakton detajet e llogaritjes së bazës së vlerësuar në varësi të periudhave të sigurimit: i. para datës 1.1.1994; ii. pas datës 1.1.1994; iii. para dhe pas datës 1.1.1994 (*neni 59*).

34. Gjykata thekson se pensioni i pleqërisë garantohet nga neni 52 i Kushtetutës, si pjesë e së drejtës kushtetuese për sigurime shoqërore, sipas një sistemi të caktuar me ligj. Konkretisht sistemi i sigurimeve shoqërore është caktuar me ligjin nr. 7703/1993, i cili rregullon marrëdhëniet në fushën e sigurimeve shoqërore dhe u siguron të punësuarve, ndër të tjera, edhe të ardhura për periudhën e pleqërisë. Kjo do të thotë se pavarësisht statusit specifik që individi ka për shkak të detyrës së ushtruar, përfitimi i pensionit të pleqërisë i nënshtrohet sistemit të përcaktuar nga ligji nr. 7703/1993.

35. Për sa më lart, pensioni i pleqërisë është i ndryshëm nga përfitimet suplementare të ushtarakut, në të cilat përfshihet edhe pensioni i parakohshëm për vjetërsi shërbimi. Ndryshimi midis tyre lidhet jo vetëm sepse ato përfitohen nga ligje të veçanta, por edhe skema ligjore e përllogaritjes së secilës prej tyre, që siç u shpjegua më lart, është e ndryshme, sidomos në drejtim të referencës, mbi të cilën përllogaritet lloji i pensionit – mesatares së pagave të elementit "shtesë" për pensionin e pleqërisë dhe pagës referuese (pagës bazë në momentin e lindjes të së drejtës së përfitimit) për pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi.

36. Fragmentarizimi ligjor dhe skemat e ndryshme duket se janë shkaku i rezultatit të ndryshëm për kërkuesin, sipas të cilit ai ka përfituar pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi në masë më të lartë se sa shuma e pensionit të pleqërisë dhe pensionit suplementar të pleqërisë së bashku. Në këtë drejtim, Gjykata evidenton se skemat e sigurimeve shoqërore dhe ato të përfitimeve të statusit të zyrtarëve të ndryshëm janë pjesë e politikave shtetërore, për të cilat ligjvënësi ka diskrecion. Megjithatë, vlerësimi i përputhshmërisë së skemave nuk është objekt i këtij gjykimi kushtetues dhe nuk

është kundërshtuar as nga kërkuesi. Për sa i takon këtij të fundit, Gjykata vë në dukje se në ankimin kushtetues individual ai nuk ka ngritur ndonjë pretendim kushtetues për përmbajtjen e nenit 16 të ligjit nr. 10142/2009, sipas të cilit pensioni suplementar i pleqërisë nuk mund të jetë më i lartë se 50% i pensionit të pleqërisë.

37. Për sa më lart, Gjykata konstaton se vendimi gjyqësor përfundimtar i vitit 2008 nuk përbën "gjë të gjykuar" për pensionin e pleqërisë dhe pensionin suplementar të pleqërisë së kërkuesit, pasi ai ka vendosur për një mosmarrëveshje tjetër gjyqësore, me objekt "të drejtën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi" dhe shkak ligjor "veprimet e parregullta të DRSSH-së, Tiranë në llogaritjen e tij sipas ligjit nr. 8087/1996, i ndryshuar". Me fjalë të tjera, "paga referuese" prej 74,743 lekësh që është përcaktuar në zbatim të këtij vendimi gjyqësor përfundimtar është element i skemës së llogaritjes së pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi sipas ligjit nr. 8087/1996, i zbatueshëm në kohën e lindjes së kësaj të drejte. Nga ana tjetër, kjo "pagë referuese" nuk është element i skemës ligjore të llogaritjes së pensionit të pleqërisë sipas ligjit nr. 7703/1993. Po kështu, kjo "pagë referuese" nuk është e njëjtë as me përcaktimin e saj dhe skemën ligjore të llogaritjes së pensionit suplementar të pleqërisë sipas ligjit nr. 10142/2009, për më tepër kur, sipas këtij ligji, ky pension suplementar nuk mund të jetë më shumë se 50% e pensionit të pleqërisë, që përfituesi gëzon në çastin e lindjes të së drejtës për pension suplementar. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm me vendimet e kundërshtuara kanë cenuar parimin e sigurisë juridike në aspektin e "gjësë së gjykuar" dhe së drejtës së fituar është i pabazuar.

38. Në vijim, Gjykata vëren se vendimet e saj të mëparshme nr. 9, datë 26.2.2007, nr. 33, datë 24.6.2010 dhe nr. 81, datë 18.12.2017, të cilat janë referuar nga kërkuesi, kanë pasur në objektin e tyre vlerësimin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të akteve të nxjerra nga organet publike (ligje dhe vendime gjyqësore), të cilat rregullonin përfitimet suplementare të ushtarakut për shkak të statusit të veçantë të tij të rregulluar me ligj, por nuk kanë rregulluar në mënyrë specifike të drejtën për pension pleqërie. Në këtë situatë, Gjykata, me të njëjtin arsyetim si më lart, çmon se edhe ky pretendim i kërkuesit është i pabazuar, pasi kjo jurisprudencë kushtetuese nuk lidhet drejtpërdrejt me skemat e pensionit të pleqërisë dhe pensionit suplementar të pleqërisë.

39. Për sa i përket pretendimit të kërkuesit se vendimet gjyqësore të kundërshtuara janë të paplota dhe kontradiktore, pasi nuk përputhen me provat e shqyrtuara, fillimisht duhet evidentuar se gjykata e apelit ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, por me arsyetim të ndryshëm, ndaj Gjykata do të analizojë respektimin e standardit të arsyetimit nga gjykata e apelit dhe Gjykata e Lartë. Nën këtë analizë, Gjykata vëren se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë marrë në shqyrtim dhe kanë disponuar nëpërmjet vendimmarrjes vlerësimin e tyre lidhur me pretendimet e kërkuesit të paraqitura në ankim dhe rekurs, përfshirë edhe atë që lidhet me vendimin gjyqësor përfundimtar të vitit 2008. Gjykata e apelit ka vënë në dukje se kërkuesi ka përmbushur kriteret për përfitimin e pensionit të plotë të pleqërisë në datën 8.2.2010 dhe se masa e pensioneve të pleqërisë dhe suplementar të pleqërisë janë bazuar respektivisht në skemat e ligjit për sigurimet shoqërore dhe ligjit për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve. Ndërsa, Gjykata e Lartë është shprehur se të gjitha shkaqeve të parashtruara në rekurs, iu është dhënë përgjigje në mënyrë shteruese nga ana e gjykatës së apelit, e cila ka analizuar në mënyrë të hollësishme dispozitat e ligjit nr. 7703/1993 dhe ligjit nr. 10142/2009 dhe se ky qëndrim bazohet edhe në jurisprudencën e vetë kësaj gjykate.

40. Për sa më lart, Gjykata çmon se vendimi gjyqësor i Gjykatës së Lartë, ndonëse me arsyetim të kufizuar, si dhe vendimi gjyqësor i gjykatës së apelit, që ka ndryshuar arsyetimin e asaj të shkallës së parë, paraqiten të rregullta në formë, të qarta, koherente, të plota dhe pa kundërthënie, duke mos cenuar standardin kushtetues të arsyetimit.

41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të sigurisë juridike të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar.

B.2. Për cenimin e së drejtës për pension pleqërie

42. Kërkuesi pretendon se i është cenuar e drejta për pension, e garantuar nga neni 52 i Kushtetutës, pasi gjykatat nuk kanë respektuar formulat e parashikuara nga ligji dhe vendimmarrjet e Gjykatës. Sipas tij, cenimi i pensionit të pleqërisë i ka cenuar edhe pensionin suplementar, pasi ky i fundit, sipas ligjit, llogaritet në masën 50 % të pensionit të pleqërisë. Vendimet e kundërshtuara cenojnë parimin e hierarkisë së normave në kuptimin e ligjit të zbatueshëm. Gjithashtu, kërkuesi parashtron se cenimi i së drejtës së pensionit i ka cenuar edhe të drejtën për të jetuar, pasi është dëmtuar, denigruar dhe lënë në pozita të vështira jetese.

43. Kushtetuta, në nenin 52, pika 1, të saj, ka parashikuar se kushdo ka të drejtën e sigurimeve shoqërore në pleqëri ose kur është i paaftë për punë, sipas një sistemi të caktuar me ligj.

44. Jurisprudenca kushtetuese ka pohuar se e drejta e pensionit përfshihet në grupin e të drejtave ekonomike sociale, të cilat për nga natyra e tyre janë të drejta pozitive. Prandaj, përmbajtja e tyre duhet interpretuar në lidhje të ngushtë me detyrimin e shtetit për t'u bërë aktiv e për t'u garantuar shtetasve sigurimin e mjeteve të përshtatshme për nevojat jetësore në rastet e fatkeqësive, të sëmundjeve, invaliditetit, pleqërisë dhe papunësisë së padëshiruar *(shih vendimet nr. 33, datë 24.6.2010; nr. 9, datë 26.2.2007, të Gjykatës Kushtetuese*).

45. Gjykata evidenton se neni 52 i Kushtetutës ka parashikuar të drejtën themelore për sigurime shoqërore në pleqëri të kujtdo, duke marrë në mbrojtje individin për t'i siguruar atij mjete jetese në formën e mbështetjes ekonomike nga shteti, kur ai është në moshën e pleqërisë ose kur është i paaftë për punë. Këto situata vulnerabiliteti të individit, në thelb, nuk varen prej vullnetit të tij. Kjo do të thotë se shteti, në mënyrë të detyrueshme, nëpërmjet politikave të tij sociale, aktivizohet për të marrë masa që t'i garantojë individit mbrojtje pozitive, në formën e përfitimeve financiare, ku bën pjesë edhe pensioni i pleqërisë. Masat e ndërmarra nga shteti, si pjesë e politikave sociale të tij, duhet të ofrohen në mënyrë vazhduese, me qëllim gëzimin e pandërprerë të tyre nga individët dhe ruajtjen e një standardi të caktuar të mjeteve të jetesës.

46. Duke iu kthyer çështjes në shqyrtim, Gjykata vëren se pretendimi për cenimin e së drejtës për pension bazohet në vendimmarrjen e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, ndaj është i ndërvarur nga pretendimi për cenimin e parimit të sigurisë juridike të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit. Në kushtet kur ky pretendim i fundit u vlerësua i pabazuar (*shih paragrafin 41 të vendimit*), Gjykata çmon se edhe pretendimi për cenimin e së drejtës për pension nuk qëndron.

47. Në përfundim, Gjykata vlerëson se kërkesa e kërkuesit, sipas arsyetimit të mësipërm, duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 7.3.2023.
Shpallur më 5.4.2023.

Kryesuese: Marsida Xhaferllari
Anëtarë: Elsa Toska, Fiona Papajorgji, Ilir Toska, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Marjana Semini, Genti Ibrahimi

VENDIM
Nr. 3, datë 6.4.2023

BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË DEKLASIFIKUAR NË AIDSSH

Mbështetur në nenin 44, pika 4, të ligjit nr. 45/2015, "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", i ndryshuar, të kreut I, nenit 22 pika 4, të ligjin nr.

10/2023, "Për informacionin e klasifikuar", i ndryshuar, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, "Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar 'Sekret shtetëror'", Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "Sekret shtetëror", në AIDSSH, i ngritur me urdhër urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023, të kryetarit të Autoritetit "Për krijimin e Komisionit të Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "sekret shtetëror" në AIDSSH", i ndryshuar, me urdhrin nr. 56, datë 23.3.2023 "Për një ndryshim në urdhrin nr. 21, datë 6.2.2023 "Për krijimin e komisionit të deklasifikimit dhe zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar "Sekret shtetëror" në AIDSSH", ka bërë deklasifikimin e informacionit të klasifikuar "Sekret shtetëror", me vendimin nr. 3, datë 6.4.2023 si më poshtë:

I. Deklasifikoi plotësisht informacionet e mëposhtme:

1. **Dosje nr. 300**, "Raport i MPB-së mbi drejtimet kryesore të veprimtarisë armiqësore gjatë viteve 1969–1972", me 27 (njëzet e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret". Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, Shtabi, viti 1972. Kutia 6.

2. **Dosje nr. 301**, "Analizë vjetore e Drejtorisë së Parë të Sigurimit", me 37 (tridhjetë e shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret". Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, Shtabi, viti 1972. Kutia 6.

3. **Dosje nr. 303**, "Relacione dërguar udhëheqjes mbi komentet e ambasadorit grek etj.", me 24 (njëzet e katër) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret". Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, Shtabi, viti 1972. Kutia 6.

4. **Dosje nr. 304,** "Relacione dërguar udhëheqjes së PPSH-së mbi komentet armiqësore të elementit armik", me 12 (dymbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret". Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, Shtabi, viti 1972. Kutia 6.

5. **Dosje nr. 305**, "Relacione mbi veprime të paligjshme në ekonomi", me 9 (nëntë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret". Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, Shtabi, viti 1972. Kutia 6.

6. **Dosje nr. 306, "**Relacione dërguar H. K. mbi disa procese politike gjyqësore", me 6 (gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret". Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, Shtabi, viti 1972. Kutia 6.

7. **Dosje nr. 308**, "Udhëzim mbi vërtetimin biografik", me 7 (shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret". Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, Shtabi, viti 1972. Kutia 6.

8. **Dosje nr. 309**, "Udhëzim mbi bashkëpunëtorët anëtar ose kandidatë partie", me 15 (pesëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret". Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, Shtabi, viti 1972. Kutia 6.

9. **Dosje nr. 310**, "Udhëzime mbi drejtimin e punëve të Degës së Parë dhe mbi krijimin e Degës së Naftës", me 4 (katër) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret". Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, Shtabi, viti 1972. Kutia 6.

10. **Dosje nr. 311**, "Udhëzim mbi personat që dërgohen jashtë shtetit", me 6 (gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret". Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, Shtabi, viti 1972. Kutia 6.

11. **Dosje nr. 312**, "Njoftim dërguar MPB-së mbi disa veprime të gabuara të ish zëvendëskryetarit të DPB Tropojë Preng Zefi", me 3 (tri) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret". Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, Shtabi, viti 1972. Kutia 6.

12. **Dosje nr. 313**, "Studim i Nusret Dautajt mbi metodën e punës së Sigurimit", me 24 (njëzet e katër) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret". Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, Shtabi, viti 1972. Kutia 6.

13. **Dosje nr. 315**, "Përgjithësime mbi punën e sektorit të kërkimit për ndjekjen e njerëzve në drejtim të paditur", me 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret". Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, Shtabi, viti 1972. Kutia 6.

14. **Dosje nr. 316**, "Detyrat e seksioneve të kundërzbulimit", me 23 (njëzet e tre) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret". Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, Shtabi, viti 1972. Kutia 6.

15. **Dosje nr. 316/1,** "Urdhër i ministrit mbi kategorizimin e të dënuarve në kohë lufte, SRV, gjendet vetëm origjinal", me 2 (dy) fletë + 3 (tri) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret S.R.V". Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, Shtabi, viti 1972. Kutia 6.

16. **Dosje nr. 316/2,** "Dinamika në stërvitjen "Peza", SRV, gjendet vetëm origjinal", me 83 (tetëdhjetë e tre) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret S.R.V". Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, Shtabi, viti 1972. Kutia 6.

17. **Dosje nr. 317**, "Relacion për zbulimin e veprimtarisë antikomuniste së rrethet Durrës, Tiranë dhe Berat", me 10 (dhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret". Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, Shtabi, viti 1973. Kutia 6.

18. **Dosje nr. 318**, "Relacion mbi grupin e Peshkopisë dhe shënime të M. Sh.", me 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret". Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, Shtabi, viti 1973. Kutia 6.

19. **Dosje nr. 319**, "Relacione dërguar H. K. mbi ushtarët që dërgohen në repartet e MPb-së", me 4 (katër) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret". Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, Shtabi, viti 1973. Kutia 6.

20. **Dosje nr. 320**, "Relacion mbi hetimin e të pandehurit E. J. dhe mbi proceset e rëndësishme që ndjek hetuesia", me 23 (njëzet e tre) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret". Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, Shtabi, viti 1973. Kutia 6.

21. **Dosje nr. 321,** "Relacion dërguar KQ të PPSH-së mbi veprimtarinë e zbulimit grek me rastin e vendosjes së marrëdhënieve diplomatike midis dy vendeve", me 14 (katërmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret". Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, Shtabi, viti 1973. Kutia 6.

22. **Dosje nr. 322,** "Relacione mbi komentet e elementit antiparti", me 16 (gjashtëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret". Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, Shtabi, viti 1973. Kutia 6.

23. **Dosje nr. 323**, "Relacion mbi përmbajtjen e korrespondencës që zhvillojnë qytetarët me Greqinë", me 11 (njëmbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret". Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, Shtabi, viti 1973. Kutia 6.

24. **Dosje nr. 324**, "Relacion mbi vjedhjet që i bëhen ekonomisë socialiste", me 86 (tetëdhjetë e gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret". Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, Shtabi, viti 1973. Kutia 6.

25. **Dosje nr. 325**, "Përgjithësim mbi metodat e elementit keqbërës", me 12 (dymbëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret". Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, Shtabi, viti 1973. Kutia 6.

26. **Dosje nr. 326**, "Përgjithësime mbi shkeljet e ligjshmërisë në degët e Peshkopisë, Kukësit e Shkodrës", me 10 (dhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret". Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, Shtabi, viti 1973. Kutia 6.

27. **Dosje nr. 327**, "Përgjithësim mbi të metat e vërejtura në rrethet kufitare për tendencat e arratisjes", me 4 (katër) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret". Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, Shtabi, viti 1973. Kutia 6.

28. **Dosje nr. 330**, "Letër e ministrit mbi bashkëpunëtorët që dorëzojnë letra nëpërmjet kanalit postar", me 4 (katër) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret". Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, Shtabi, viti 1973. Kutia 6.

29. **Dosje nr. 331,** "Urdhër i ministrit për ngjarjet e jashtëzakonshme", me 8 (tetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret". Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, Shtabi, viti 1973. Kutia 6.

30. **Dosje nr. 332**, "Udhëzim dërguar degëve mbi arratisjen në Jugosllavi të A. D.", me 7 (shtatë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret". Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, Shtabi, viti 1973. Kutia 6.

31. **Dosje nr. 334,** "Rregullore për mbrojtjen e sekretit", me 6 (gjashtë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret". Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, Shtabi, viti 1973. Kutia 6.

32. **Dosje nr. 336,** "Informacione mbi personat që shkojnë me shërbim jashtë vendit me shërbim", me 13 (trembëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret". Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, Shtabi, viti 1973. Kutia 6.

33. **Dosje nr. 335/1**, "Urdhër nr. 01-25, datë 13.6.1973 mbi ndryshimet që duhen bërë në listat nr. 1 e nr. 2, SRV, gjendet vetëm origjinal", me 2 (dy) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret SRV". Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, Shtabi, viti 1973. Kutia 6.

34. **Dosje nr. 335/2,** "Udhëzim nr. 01-44, datë 28.8,1973 mbi agjenturën e konservuar, SRV, gjendet vetëm origjinal", me 2 (dy) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret SRV". Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, Shtabi, viti 1973. Kutia 6.

35. **Dosje nr. 335/3**, "Metodika e Sigurimit në stërvitjen komplekse të zhvilluar në Skrapar më 23 – 26.1.1973, SRV, gjendet vetëm origjinal", me 22 (njëzet e dy) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret SRV". Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, Shtabi, viti 1973. Kutia 6.

36. **Dosje nr. 335/4**, "Metodika e Sigurimit me temë sulmin e befasishëm armik dhe masat e marra, SRV, gjendet vetëm origjinal", me 30 (tridhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret SRV". Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, Shtabi, viti 1973. Kutia 6.

37. **Dosje nr. 335/5**, "Metodika e stërvitjes "Kaptina", Dibër–Mat–Librazhd, shtator 1973, SRV, gjendet vetëm origjinal", me 80 (tetëdhjetë) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret SRV". Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, Shtabi, viti 1973. Kutia 6.

38. **Dosje nr. 336/6**, "Metodika e stërvitjes së Sigurimit në Lushnjë, Fier, Vlorë, në korrik 1973, SRV, gjendet vetëm origjinal", me 43 (dyzet e tre) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret SRV". Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, Shtabi, viti 1973. Kutia 6.

39. **Dosje nr. 336/7**, "Informacion mbi zbatimin e dekretit për ndalimin e vlerave monetare që sjellin të arratisurit", me 5 (pesë) fletë, ruhet vetëm origjinal". Niveli i klasifikimit "Sekret". Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, Shtabi, viti 1973. Kutia 6.

40. **Dosje nr. 336/8**, "Material në lidhje me kontrollin punëtor në Sigurimin e shtetit", ruhet vetëm origjinal me 31 (tridhjetë e një) fletë. Niveli i klasifikimit "Sekret". Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, Shtabi, viti 1973. Kutia 6.

41. **Dosje nr. 336/11**, "Shkresë drejtuar MPJ-së mbi disa sjellje rrugaçërie (vjedhje) në drejtim të përfaqësive të huaja diplomatike në Tiranë", me 4 (katër) fletë, ruhet vetëm origjinal. Niveli i klasifikimit "Sekret". Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, Shtabi, viti 1973. Kutia 6.

42. **Dosje nr. 336/12**, "Informacion mbi disa probleme prostitucioni në Tiranë", me 4 (katër) fletë, ruhet vetëm origjinal. Niveli i klasifikimit "Sekret". Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, Shtabi, viti 1973. Kutia 6.

43. **Dosje nr. 336/14,** "Evidentimi i problemeve që kanë dalë në analizat e degëve", me 12 (dymbëdhjetë) fletë, ruhet vetëm origjinal. Niveli i klasifikimit "Sekret". Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, Shtabi, viti 1973. Kutia 6.

44. **Dosje nr. 336/15**, "Korrespondencë me DPB Lezhë në lidhje me aktet normative që i mungojnë asaj dege", me 4 (katër) fletë, ruhet vetëm origjinal. Niveli i klasifikimit "Sekret". Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, Shtabi, viti 1973. Kutia 6.

45. **Dosje nr. 336/16**, "Orientim i ministrit në lidhje me detyrat që i dalin MPB-së nga fjala e E. H. më 15.3.1973", me 13 (trembëdhjetë) fletë ruhet vetëm origjinal. Niveli i klasifikimit "Sekret". Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, Shtabi, viti 1973. Kutia 6.

46. **Dosje nr. 336/17**, "Informacion mbi disa vjedhje të rinisë në ndërtimin e hekurudhës Elbasan – Përrenjas", me 4 (katër) fletë, ruhet vetëm origjinal. Niveli i klasifikimit "Sekret". Fondi Drejtoria e Parë e Sigurimit të Shtetit, Shtabi, viti 1973. Kutia 6.

